



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM INDUSTRIAL DHE MBËSHTETJE TË BIZNESIT 2030

(“POLITIKA INDUSTRIALE”)

Prishtinë, Kosovë
Prill, 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

AKRONIMET	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	6
2. METODOLOGJIA	8
3. SFONDI	9
3.1. Analiza e Performancës Industriale	9
3.1.1. Dimensioni ekonomik	10
3.1.2. Dimensioni social	17
3.1.3. Dimensioni Mjedisor	19
3.1.4. Burimet e Brendshme Natyrore	21
3.2. Përmbledhje e analizës së problemit	22
4. PËRAFRIMI I SKZH-SË DHE VIZIONI I POLITIKËS INDUSTRIALE	24
4.1. Përafrimi me SKZH dhe Kontributi në Qëllimet Strategjike	24
4.2. Përmbledhje mbi përafrimin me SKZH-në	26
4.3. Vizioni dhe Misioni	27
5. OBJEKTIVAT DHE NËN-OBJEKTIVAT E POLITIKËS INDUSTRIALE	27
5.1. Objektivat e Politikës	27
5.1.1. Objektivi 1: Zgjerimi (shtrirja) e Prodhimit Industrial	28
5.1.2. Objektivi 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial	28
5.1.3. Objektivi 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës	29
5.1.4. Objektivi 4: Lehtësimi i industrisë së gjelbër	30
5.1.5. Objektivi 5: Maksimizimi i rritjes të vlerës së brendshme	31
5.1.6. Shkëmbimet/kompromiset ndërmjet objektivave	32
5.1.7. Synimet dhe treguesit për objektivat	32
5.2. Nën-objektivat	33
5.2.1. Nën-objektivat dhe logjika e përgjithshme e ndërhyrjes	34
5.2.2. Nën-objektivat sipas Objektivit 1: Zgjerimi i Prodhimit Industrial	35
5.2.2.1. Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor	35
5.2.2.2. Rritja e Investimeve në Prodhim	36
5.2.2.3. Përsheptimi i dixhitalizimit në prodhim	38
5.2.2.4. Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht	38
5.2.3. Nën-objektivat sipas objektivit 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial	39
5.2.3.1. Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit	39
5.2.3.2. Diversifikimi i tregjeve të eksportit	40
5.2.3.3. Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendor dhe promovimin e produkteve vendore	41

5.2.4.	Nën-objektivat sipas objektivit 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës.....	42
5.2.4.1.	Ngritja e kualifikimit dhe certifikimit të fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të kompanive.....	43
5.2.4.2.	Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri	44
5.2.4.3.	Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës	45
5.2.5.	Nën-objektivat sipas objektivit 4: Lehtësimi i industrisë së gjelbër	46
5.2.5.1.	Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim ..	46
5.2.5.2.	Mbështetja e prodhimit dhe konsumit të produkteve të gjelbra	47
5.2.5.3.	Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve.....	48
5.2.6.	Nën-objektivat sipas objektivit 5: Maksimizimi i rritjes së vlerës së brendshme	49
5.2.6.1.	Rritja e përqindjes së inputeve vendore në prodhim	50
5.2.6.2.	Përmirësimi i inovacionit të produktit drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar	51
5.2.6.3.	Forcimi i lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendase të lidhura me industrinë	52
5.2.7.	Treguesit dhe objektivat/caqet për nën-objektivat	53
6.	SEKTORËT ME PRIORITET	56
7.	VEPRIMET E POLITIKAVE PRIORITARE TË POLITIKËS INDUSTRIALE	58
8.	MARRËVESHJET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	62
9.	NDIKIMI BUXHETOR	63
10.	SHTOJCAT	68

AKRONIMET

B2B	Biznes-me-Biznes
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
CO2	Dioksidi i karbonit
NjIE	Njësia e Inteligjencës Ekonomike
RrCPI	Rritja e Cilësisë së Politikave Industriale
RrEPS	Rrjeti Evropian i Politikave Sociale
BE	Bashkimi Evropian
IHD	Investimet e Huaja Direkte
BPV	Bruto Produkti Vendor
FBKF	Formimi Bruto i Kapitalit Fiks
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
QK	Qeveria e Kosovës
Ha	Hektarë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
PI	Politika Industriale
DPI	Të drejtat e pronësisë industriale
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
BZhK	Banka Zhvillimore e Kosovës
KSDW	Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KTOE	Kilotonë ekuivalent të naftës
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
M	Milion
MI	Ministria përgjegjëse për Industrinë
VShP	Vlera e Shtuar e Prodhimit
OKZh	Objektivat Kombëtare të Zhvillimit
SKZh	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit
IKP	Inventari Kombëtar i Pyjeve
NOx	Oksidi i azotit
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
ZKM	Zyra e Kryeministrit
PFB	Pariteti i Fuqisë Blerëse
R&D	Kërkim dhe Zhvillim
OZhQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SZIMB	Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit
SO2	Oksidi i squfurit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
BB	Banka Botërore
BP6	Ballkani Perëndimor 6
WITS	Zgjidhjet e Tregtisë së Integruar Botërore (World Integrated Trade Solutions)
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit (SZhIMB) 2030 (në tekstin e mëtejshëm “Politika Industriale”) është përgatitur nga Qeveria e Kosovës (QK) për të ofruar një kornizë strategjike të politikave për nxitjen e zhvillimit industrial. Hartimi i këtij dokumenti strategjik shpreh rëndësinë që QK i kushton sektorit të prodhimit në arritjen e një transformimi strukturor të ekonomisë së Kosovës. Vizioni i Politikës Industriale të Kosovës është që, “Deri në vitin 2030, industria e Kosovës do të jetë transformuar në një industri më të integruar globalisht e cila është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të shtuar të lartë dhe të ofrojë punësim të denjë”.

Politika Industriale është hartuar duke përdorur një metodologji të njohur *Ngritja e Cilësisë së Politikave Industriale*, e cila është krijuar për të mbështetur vendet në zhvillimin e politikave industriale gjithëpërfshirëse të bazuara në diagnostikime të fuqishme. Logjika e ndërhyrjes së Politikës Industriale është zhvilluar, së pari, duke përcaktuar objektivat strategjike përkatëse të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH 2030), të cilat do të ndikoheshin pozitivisht nga një bazë industriale në rritje. Së dyti, bazuar në këto përafrime me SKZH-në, u formuluan objektivat konkrete të Politikës Industriale. Së treti, duke kuptuar mungesat themelore në strukturën e kapaciteteve industriale në Kosovë, mund të identifikohen ndryshime specifike (në tekstin e mëtejshëm “nën-objektiva”), që kërkojnë për të arritur objektivat e politikës industriale. Së katërti, nën-objektivat e identifikuar siguruan bazën për të zhvilluar veprimet kryesore të politikës industriale dhe planin e përgjithshëm të veprimit.

Objektivat dhe nën-objektivat e Politikës Industriale janë identifikuar, bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të performancës ekonomike, sociale dhe mjedisore të sektorit të prodhimit. Ndonëse shkalla e rritjes së BPV-së për kokë banori tejkalon vendet e rajonit, Kosova ende ka BPV-në më të ulët për kokë banori, krahasuar me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6). Sektori i prodhimit në Kosovë ka një peshë pak më të madhe në përbërjen e strukturës së ekonomisë, në krahasim me vendet e rajonit, mirëpo nuk është bërë shtytës i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Kosova ka një bazë të vogël industriale të përqendruar në aktivitetet, me vlerë të shtuar të ulët me konkurrencë të kufizuar të eksportit dhe të përqendruar në pak produkte dhe tregje të eksportit. Ndërmjet viteve 2015 – 2020, sektori i prodhimit ka krijuar rreth 5,700 vende të reja të punës. Pavarësisht rritjes, punësimi në këtë sektor mbetet ende i ulët, duke zënë vetëm mbi një të dhjetën e punësimit total. Megjithatë, ky sektor është ende larg shpalosjes së potencialit të tij për krijimin e shumë vendeve të denja të punës. Tregu i punës në prodhimtari në Kosovë karakterizohet me paga të ulëta, informalitet të lartë dhe pjesëmarrje më të ulët të grave prej 16% krahasuar me mesataren e BP6 që është 37%. I pasas analizës industria e Kosovës ka përmirësuar efikasitetin e saj energjetik, por me një ritëm më të ngadaltë se sa vendet e rajonit, ndërsa intensiteti i emtimit të CO2 në prodhim, është duke u zvogëluar me një ritëm pak më të ngadaltë se sa mesatarja e BP6 (që nuk përfshin Malin e Zi).

Dhe në fund, sektori i prodhimit nuk është duke i përdorur mjaftueshëm burimet e natyrore të Kosovës.

Për të lehtësuar shpalosjen e potencialit zhvillimor të sektorit të prodhimit në Kosovë dhe për të kontribuar në arritjen e qëllimeve strategjike të SKZH 2030, Politika Industriale do të ndjekë pesë objektiva politikash: 1) zgjerimin/shtrirjen e prodhimit industrial; 2) zvogëlimin e deficitit tregtar industrial; 3) krijimin e punësimit të denjë dhe gjithëpërfshirës; 4) mbështetjen e rritjes së një industrie të gjelbër; dhe 5) maksimizimin e rritjes së përfitimit të brendshëm. Arritja e këtyre objektivave të politikës varet nga ndryshimet e rëndësishme që duhen bërë në 16 nën-objektiva të ndryshëm, duke filluar nga përmirësimi i qasjes në financa dhe inovacioni i produktit, tek mbështetja e prodhuesve për t'u shtrirë në tregjet e eksportit, pajisja e fuqisë punëtore me aftësi të rëndësishme për industrinë, përmirësimin e industrisë së gjelbër dhe rritjen e peshës së inputeve vendore në prodhim.

Janë zhvilluar dhjetë veprime prioritare të politikave, për të siguruar që vizioni i krijimit të një industrie të integruar globalisht e cila është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe të ofrojë punësim të denjë do të materializohet dhe duke e bërë këtë, do të ndihmojë në kthimin e sektorit të prodhimit në një shtytës të zhvillimit për vendin. Këto veprime prioritare përfshijnë mbështetjen e krijimit të parqeve industriale moderne me karakteristika eko-miqësore për të tërhequr investime dhe për të lehtësuar bashkëpunimin horizontal dhe vertikal ndërmjet bizneseve; themelimin e një entiteti kombëtar për certifikimin e produkteve për të përsheptuar depërtimin në tregun ndërkombëtar, duke përfshirë organet mbështetëse të vlerësimit të konformitetit; rritjen e Mjetit Financiar të Eksportit të Fondit Kosovar për Garanci të Kredive (FKGK) për të përmirësuar qasjen në financim për prodhuesit e orientuar drejt eksportit; përmirësimin e regjimit tarifor të importit për mallrat e përzgjedhura të prodhimit për të reduktuar varësinë e lartë nga furnitorët dhe inputet e huaja; zbatimin e një programi të prodhimit të punës që kombinon subvencionimin e pagave dhe praktikën në kompani për të adresuar nivelin e lartë të papunësisë midis grupeve të cenueshme; krijimin e një skeme kreditimi të aftësimit për të rritur aftësitë e fuqisë punëtore për më shumë angazhim dhe angazhim më të mirë në prodhim; mbështetjen e rritjes së investimeve në teknologjitë e gjelbra përmes kombinimit të kredive dhe granteve për të përmirësuar efikasitetin dhe dixhitalizimin; përmirësimin e legjislacionit të prokurimit publik për të ofruar stimuj për produktet e prodhimit vendor dhe ato të gjelbra; dhe ofrimin e stimujve tatimorë për investimet në inovacionin e produktit, për të inkurajuar inovacion më të madh drejt produkteve me vlerë më të lartë të shtuar.

Në përfundim, efektiviteti i Politikës Industriale do të kërkojë veprime të bashkërenduara, përkushtim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet QK-së, sektorit privat dhe partnerëve zhvillimorë ndërkombëtarë të Kosovës. Zgjidhja për realizimin e vizionit të Politikës Industriale do të jetë një kuptim i përbashkët i sfidave, potencialeve dhe prioritetëve për promovimin e zhvillimit industrial në Kosovë. Ky dokument strategjik ka për qëllim të vendos themelet për këtë bashkëpunim.

1. HYRJE

Politika Industriale 2030 është një dokument strategjik që synon të artikulojë kornizën e përgjithshme për promovimin e zhvillimit industrial në Kosovë.

Historikisht, industrializimi i Kosovës ka filluar në vitin 1960 deri në fund të viteve 1980, me kompanitë kosovare duke u integruar në një zinxhir më të gjerë të vlerës industriale në ish-Jugosllavi. Prodhimtaria fitoi një terren në Kosovë përmes prodhimit, ndër të tjera, të pjesëve të automobilave, prodhimit të baterive dhe përpunimit të metaleve. Shpërbërja e ish-federatës jugosllave vazhdoi paralelisht me një periudhë të de-industrializimit të shpejtë. Në periudhën e pasluftës, Kosova përjetoi vetëm zhvillim të ulët industrial dhe i mungonte një politikë industriale strategjike për të udhëhequr rimëkëmbjen e sektorit të prodhimit të Kosovës.

Për herë të parë në periudhën e pas-pavarësisë, Qeveria e Kosovës (QK) ka zhvilluar një politikë të veçantë industriale. Vendimi u nxit nga të kuptuarit se zhvillimi industrial është kritik për transformimin gradual të Kosovës në një ekonomi me të ardhura më të larta dhe përmirësimin e mirëqenies socio-ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Ndoshta më shumë se shumica e sektorëve, prodhimi ka një potencial të lartë për të krijuar produktivitet të konsiderueshëm dhe fitime shtesë në vlerë duke tërhequr teknologjitë e reja dhe inovacionin. Zhvillimi industrial mund të ketë gjithashtu implikime të shumta pozitive zhvillimore përtej sektorit të prodhimit. Për shkak të lidhjeve të ndryshme me sektorët e tjerë të ekonomisë, zhvillimi industrial mund të stimulojë rritjen dhe zhvillimin në sektorë të tillë si bujqësia dhe minierat në Kosovë dhe në industritë e shërbimeve përkatëse. Duke vepruar kështu, zhvillimi industrial ka potencialin të bëhet një forcë e rëndësishme shtytëse për transformimin e dëshiruar strukturor të Kosovës drejt një ekonomie moderne në rritje e cila është e mirëintegruar në ekonominë globale dhe mund të gjenerojë mirëqenie socio-ekonomike siç përshkruhet në vizionin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2030.

Vendimi i Kosovës për të zhvilluar një politikë moderne industriale përshtatet mirë me një vlerësim të ripërtërirë global të zhvillimit industrial si një mjet efektiv për ekonominë me të ardhura të ulëta dhe të mesme për të kapur hapin me vendet e zhvilluara. Në të njëjtën kohë, politika industriale po rimerr gjithashtu rëndësi në botën e industrializuar për të lehtësuar tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër dhe dixhitale, si dhe për të forcuar zhvillimin e industrive të rëndësishme strategjike në një vend përkatës. Ringjallja globale e politikës industriale bazohet në të kuptuarit se çdo transformim strukturor i dëshiruar kërkon ndërhyrje të rëndësishme dhe të përshtatura mirë të qeverisë, të përqendruara rreth një marrëdhënieje të ngushtë bashkëpunimi me sektorin privat. Si përmbledhje, Politika Industriale 2030 ofron një kornizë strategjike për politikëbërësit dhe partnerët zhvillimorë të Kosovës, se si të lehtësojnë zhvillimin e sektorit të prodhimit të Kosovës. Politika Industriale është e harmonizuar ngushtë me SKZH 2030, si dokument strategjik gjithëpërfshirës për zhvillimin kombëtar të Kosovës, duke pasur parasysh lidhjet e shumta, është e ngulitur brenda një grupi më të gjerë politikash sektoriale të ndërlidhura. Ky dokument strategjik është i organizuar në disa seksione. Seksioni 1 ofron një hyrje të dokumentit strategjik. Seksioni 2 paraqet metodologjinë e përdorur për zhvillimin e dokumentit strategjik. Seksioni 3 paraqet analizën e performancës industriale të Kosovës, duke krahasuar performancën e sektorit të saj prodhues kundrejt vendeve të rajonit dhe vendeve model. Seksioni 4 përshkruan vizionin dhe misionin e politikës industriale, duke

përfshirë harmonizimin me SKZH-në. Seksioni 5 paraqet objektivat dhe nën-objektivat kryesore të politikës, duke përfshirë veprimet kryesore të synuara të politikës. Seksioni 6 përshkruan sektorët prioritarë bazuar në një vlerësim të performancës së tyre në të kaluarën relative. Seksioni 7 renditë veprimet kryesore prioritare të politikës industriale. Seksioni 8 përshkruan zbatimin, monitorimin dhe marrëveshjet e raportimit. Në fund, Seksioni 9 ofron ndikimin buxhetor të zbatimit të politikës industriale.

2. METODOLOGJIA

Politika Industriale është hartuar nën përkujdesin e një grupi punues të mandatuar nga qeveria, i përbërë kryesisht nga përfaqësues të qeverisë, bizneseve, odave të biznesit dhe shoqatave të industrisë. Përgjegjësia kryesore për hartimin e Politikës Industriale i takonte një grupi të nivelit teknik pranë Ministrisë, përgjegjëse për Industrinë (MINT). Për të zhvilluar dokumentin strategjik, ekipi hartues i mbështetur nga ekspertiza e jashtme nga marsi i vitit 2022 deri në dhjetor të vitit 2022 punoi nëpër faza të ndryshme. Zhvillimi i Politikës Industriale është bashkërenduar ngushtë edhe me Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS) të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), ndërsa vetë dokumenti është harmonizuar me Rregulloren e QK-së nr. 07/2018 për *Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit*.

Procesi i hartimit të Politikës Industriale është strukturuar sipas një metodologjie të njohur si *Rritja e Cilësisë së Politikave Industriale* (RrCPI). RrCPI u zhvillua nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) dhe Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim (GIZ) për të mbështetur vendet në hartimin e politikave industriale gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në prova që bazohen në diagnostifikime të mirë-bazuara.

Zhvillimi i logjikës së ndërhyrjes së Politikës Industriale ndjek katër hapa bazë të hartimit të politikave: Së pari, lidh Politikën Industriale me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2030, e cila përfshinte përcaktimin e objektivave të SKZH-së që do të ndikonin më shumë në zhvillimin e një sektori prodhimi. Së dyti, përkthen këto lidhje në objektiva specifike dhe të matshme të politikës industriale. Së treti, identifikon nxitësit/shtytësit më të rëndësishëm industrialë (nën-objektivat) që duhet të përmirësojnë performancën e tyre për të arritur objektivat e politikës industriale. Dhe së katërti, zhvillon një plan veprimi me kosto të ndërhyrjeve qeveritare për të zbatuar vizionin e dëshiruar të politikës industriale.

Gjatë hartimit të Politikës Industriale, ekipi hartues teknik i udhëhequr nga MINT u mbështet në ekspertizën e ministrive dhe subjekteve të ndryshme të specializuara të qeverisë, me të cilat shpesh u konsultuan. Në fazat kyçe të procesit të hartimit, ekipi i MINT, në grupin më të gjerë punues, prezantoi gjetjet kryesore të diagnostikimit të performancës industriale, logjikën e ndërhyrjes, si dhe instrumentet e politikave, ku u morën kontribute aktive nga qeveria, sektori privat dhe donatorët. Për më tepër, ekipi teknik i udhëhequr nga MINT kërkoi gjithashtu përfshirjen aktive të komunitetit të biznesit për të kontekstualizuar më mirë veprimet e politikave të identifikuara.

Çdo hap i procesit të hartimit të politikave është ndërtuar mbi diagnostifikimin gjithëpërfshirës. Analiza e performancës industriale (shih seksionin 3 dhe shtojcën 1), e cila vlerëson

performancën ekonomike, sociale dhe mjedisore të sektorit të prodhimit të Kosovës gjatë 10 viteve të fundit, ishte kritike për përcaktimin e objektivave të politikës industriale, si dhe për mënyrën se si objektivat e tilla do të të sigurojë arritjen e qëllimeve kryesore strategjike të SKZH 2030. Për më tepër, analiza e kapaciteteve industriale (shtojca 2) mundësoi përcaktimin e nën-objektivave. Përveç kësaj, analiza e përzgjedhjes së sektorit (shtojca 4) ndihmoi në identifikimin e atyre industrive prodhuese që kanë potencialin më të lartë për të kontribuar në arritjen e një ose më shumë objektivave të politikës industriale. Diagnostifikimi i përgjithshëm industrial ishte kyç për përcaktimin jo vetëm të hartimit të veprimeve të politikave, por edhe për përshtatjen e tyre për grupe specifike të synuara. Në fund, analiza e përcaktimit të objektivave (shtojca 1) ndihmoi në përcaktimin e objektivave realiste dhe të bazuara në dëshmi për objektivat dhe nën-objektivat e politikës.

Diagnostifikimi i performancës industriale është një pjesë kritike e procesit të hartimit të strategjisë. Ajo bëri krahasimin e performancës industriale të Kosovës kundrejt vendeve krahasuese të BP6 (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) dhe Sllovenisë dhe Estonisë, të përdorura si *modele* aspiruese.

Të dhënat janë marrë nga burime të shumta vendore, duke përfshirë Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), si dhe burime ndërkombëtare si Banka Botërore (BB), UNIDO, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), World Integrated Trade Solutions (WITS). Duke pasur parasysh disponueshmërinë dhe cilësinë e kufizuar të të dhënave kombëtare në Kosovë, diagnostifikimi pjesërisht nuk mund të përfshinte analiza më të thella. Është bërë gjithashtu një rishikim i plotë i strategjive të tjera përkatëse kombëtare dhe të tjera në nivel sektorial dhe nënsektorial për të eksploruar sinergjitë horizontale dhe për të siguruar një përafrim dhe koherencë të përgjithshme të politikave.

3. SFONDI


3.1. Analiza e Performancës Industriale

Studime të shumta kanë nxjerrë në pah rolin qendror të prodhimit për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Të kesh një sektor prodhimi të zhvilluar mirë, është jetik për arritjen e standardeve të larta dhe të qëndrueshme të jetesës. Një lidhje empirike është e vendosur mirë midis shkallës së industrializimit dhe niveleve të të ardhurave për kokë banori, ku prodhimi është një nxitës i rritjes së produktivitetit, që është një shenjë dalluese e një ekonomie të përparuar. Përtej efekteve ekonomike dhe sociale, sektori i prodhimit gjithashtu mund të ndikojë ndjeshëm në mjedis. Ky seksion i shërben një qëllimi kryesor: ofron një analizë të problemit mbi performancën e sektorit prodhues të Kosovës në tri dimensione kryesore, që nga ana tjetër ofron udhëzime të rëndësishme se si të orientohet strategjikisht politika industriale e Kosovës. Ai ofron një vlerësim të shkurtër të performancës së sektorit të prodhimit të Kosovës në dimensionet ekonomike, sociale dhe mjedisore gjatë dekadës së kaluar, krahasuar me vendet krahasuese të lartpërmendur.

3.1.1. Dimensioi ekonomik

Në mënyrë krahasuese, Kosova paraqet performancën më të ulët ekonomike të përgjithshme në BP6: BPV / kokë banori prej €3,500 për vitin 2020, është larg nën mesataren e BP6 prej €4,660. Pavarësisht mungesës, duke filluar nga një bazë e ulët, Kosova ishte duke u rritur me një ritëm më të shpejtë se sa vendet e BP6: shkalla e rritjes së BPV -së/ kokë banori prej 5.1% gjatë periudhës 2011-2020 e tejkaloi rajonin me më shumë se një përqind (mesatarja e BP6: 3.9%). Megjithatë, shkalla ekzistuese e rritjes duhet të përshpejtohet për të siguruar arritjen më të shpejtë me vendet e rajonit.

Figura 1: Performanca e BPV-së/ kokë banori e Kosovës krahasuar me vendet krahasuese




Burimi: Treguesit Botëror të Zhvillimit

Për më tepër, ndërmjet viteve 2011 dhe 2020, Kosova ka shfaqur pak ndryshime strukturore në përbërjen e ekonomisë së saj. Pjesa e vlerës së shtuar të prodhimit (VShP), si pjesë e BPV -së, mbeti e qëndrueshme në 13%, po ashtu edhe sektori ishërbimeve u rrit në mënyrë graduale me 48%) 2020, por ende përbën pjesën më të madhe të BPV –së. (

Pesha e vlerës së shtuar në miniera duke e përfshi ndërtimtarinë, përbënte mesatarisht 14% të BPV -së gjatë së njëjtës periudhë. Mungesa e një politike strategjike kuptimplote për të udhëhequr zhvillimin industrial mund të ketë ndikuar në rolin e kufizuar të industrisë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.


Figura 2: Transformimit strukturor në Kosovë, vlerën e shtuar të sektorëve si % e BPV-së



Burimi: Treguesit Botëror të Zhvillimit

Në vitin 2020, niveli i industrializimit i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VShP në BPV, e tejkaloi (13.6%) mesataren e BP6 (10.7%), me përjashtim të Serbisë (14.2%). Megjithatë, me të njëjtin tregues dhe për të njëjtin vit, Kosova kishte performancë të konsiderueshme më të ulët në krahasim me Slloveninë (22%), por ishte pak më e lartë se Estonia (13.2%).


Figura 3: Pjesëmarrja e VShP në BPV-së, në %, për Kosovën dhe vendet krahasuese



Burimi: WITS dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Kapaciteti prodhues i një vendi matet me vlerën e shtuar të gjeneruar në sektorin e prodhimit për kokë banori. Sipas kësaj, në vitin 2020 Kosova kishte €338/kokë banori, nën mesataren e BP6 prej €365/kokë banori në të njëjtin vit, me kapacitet më të ulët janë Shqipëria me (€182/kokë banori) dhe Malin e Zi me (€242/kokë banori). Ndërsa kapaciteti prodhues për kokë banori i Sllovenisë ishte mbi 10 herë më i lartë se ai i Kosovës, në vitin 2020.

Figura 4: Kapaciteti prodhues (VShP/për kokë banori), Kosova kundrejt vendeve krahasuese




Burimi: Treguesit Botëror të Zhvillimit

Kosova paraqet një nivel të lartë të investimeve në asete fikse, siç matet me pjesëmarrjen e formimit bruto të kapitalit fiks (FBKF) në BPV -së. Përqindja e FBKF në BPV prej 30% në vitin 2020 tejkalon mesataren e BP6 (24%), duke përfshirë Slloveninë (19%), me përjashtim të Estonisë (31%). Sllovenia ka treguar norma të larta të FBKF gjatë periudhës nga viti 1990 deri në vitin 2008 midis 26% dhe 32%, të cilat gradualisht u stabilizuan në rreth 20% në vitin 2010 e tutje.

Ndërsa përqindja e lartë e FBKF e Kosovës në BPV reflekton investime të larta në shpenzimet infrastrukturore, të cilat mund të ndihmojnë zhvillimin industrial, gjithashtu duket se kap investime të reja të rëndësishme në makineri dhe pajisje të reja nga ana e bizneseve (edhe pse nuk ka të dhëna të ndara për ta vërtetuar këtë).


Figura 5: Formimi Bruto i Kapitalit Fiks, si % e BPV-së, Kosova kundrejt vendeve krahasuese,



Burimi: Treguesit Botëror të Zhvillimit

Integrimi i tregtisë ndërkombëtare është shumë i rëndësishëm, veçanërisht për ekonomitë e vogla me një treg të brendshëm të kufizuar. Depërtimi në tregun e eksportit mund të gjenerojë kërkesën e nevojshme për një kalim gjithnjë e më të madh drejt prodhimit serik, i cili nga ana tjetër mund të përmirësojë konkurrencën nëpërmjet ekonomive të shkallës. Mirëpo deri më tani Kosova nuk ka arritur të përfitojë nga mundësitë e tregut të eksportit, kjo siç mund të shihet nga bilanci i saj negativ tregtar vazhdimisht i lartë. Për çdo një euro eksport, Kosova importon shtatë euro, duke arritur në një deficit tregtar prej 2.8 miliardë euro në vitin 2020. Kjo reflektohet edhe në përqindjen më të ulët të eksporteve në BPV-së që ka Kosova në rajon. Siç paraqitet figurën 6, në vitin 2020 eksportet e Kosovës përbënin vetëm 22% të BPV-së krahasuar me mesataren e BP6 prej 35%. Kjo tregon qartë integrimin e kufizuar të Kosovës në tregtinë ndërkombëtare dhe përfitimet e kufizuara që nxjerr ekonomia e Kosovës nga shfrytëzimi i tregjeve të eksportit.

Figura 6: Integrimi i tregut global (eksportet si % e BPV-së)



Burimi: Treguesit Botëror të Zhvillimit

Shporta e eksportit e ekonomive të zhvilluara zakonisht udhëhiqet nga produktet e prodhuara. Prandaj, promovimi i eksportit të prodhimeve është thelbësor për Kosovën për të rritur konkurrencën e përgjithshme të eksporteve dhe për të reduktuar në mënyrë të qëndrueshme deficitin tregtar ekzistues. Në vitin 2020, përqindja e mallrave të prodhuara të eksportuara krahasuar me totalin e eksportit të mallrave ishte rritur në 84%, nga 71% në 2011. Megjithatë, përveç Malit të Zi (73%), të gjitha vendet e tjera të BP6 kishin një përqindje më të lartë të mallrave të prodhuara të eksportuara krahasuar me eksportet (mesatarja e BP6 prej 90% në vitin 2020).

Konkurrueshmëria e kufizuar e Kosovës në eksportet e prodhuara dëshmohet më tej duke ekzaminuar kapacitetin e saj të eksportit të prodhuar, i matur me eksportet e prodhuara për kokë banori. Fqinji jugor i Kosovës, Maqedonia e Veriut, në vitin 2020 kishte një kapacitet të prodhuar të eksportit prej €2,500/kokë banori, që ishte 11 herë më i lartë krahasuar me €221/për kokë banori të Kosovës për të njëjtin vit. Të gjitha vendet e tjera të BP6 kanë kapacitetet eksportuese dukshëm më të larta se Kosova: Serbia (€2,100 /kokë banori); Bosnja (€1,415/kokë banori); Shqipëria (€379/kokë banori). Në përgjithësi, kapaciteti i ulët eksportues i Kosovës

prej €221/kokë banori është shumë i ulët në krahasim me mesataren e BP6 (€1,500/kokë banori), duke nënvizuar sërish potencialin jashtëzakonisht të papërdorur të prodhues për të nxitur prodhimin vendor për eksport, nëse promovohet në mënyrë të balancuar. Për më tepër, performanca relative e Kosovës është edhe më e dobët në krahasim me vendet model si Sllovenia (€14,240/kokë banori) dhe Estonia (€8,220/kokë banori).

Gjithsesi, është me rëndësi të theksohet se krahasimi rajonal, zbulon se eksportet më të larta të mallrave të prodhuara nuk përkthehen automatikisht në një vlerë shtesë më të lartë për një vend. Maqedonia e Veriut ndjek një politikë të synuar (targeted policy) për të rritur eksportet, gjë e cila ndihmoi në rritjen e eksporteve të përgjithshme të mallrave si pjesë e BPV-së në pothuajse 60%, duke arritur një kapacitet të eksportit të prodhimit që është 11 herë më i lartë se ai i Kosovës. Megjithatë, duke parë lidhjen midis vëllimit të eksporteve dhe efektit të tyre në vlerën e shtuar të gjeneruar në sektorin e prodhimit, mund të vërejmë se eksportet e larta të prodhimtë Maqedonisë së Veriut nuk përkthehen gjithashtu në vlerë të shtuar të lartë, në vitin 2020 VShP-ja për kokë banori ishte vetëm €364, që është vetëm pak më e lartë se VShP/kokë banori e Kosovës prej €338. Me gjasë kjo tregon për një sfidë më të madhe që duket se prek rajonin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor, e cila thekson përdorimin e kufizuar të burimeve vendore nga vendet përkatëse për të nxitur rritjen e tyre të dukshme në kapacitetin eksportues.

Analiza tregon gjithashtu se eksportet e Kosovës janë të përqendruara kryesisht në disa tregje eksporti. Në vitin 2020, Kosova eksportoï kryesisht në Shqipëri (22.8%), Zvicër (9.6%), Gjermani (9.5%), Maqedoninë e Veriut (8.7%) dhe Itali (7%). Në vitin 2020, 42% e eksporteve të Kosovës shkuan në vendet e BP6, dhe 36% në vendet e BE-së. Eksportet jashtë BP6 janë orientuar kryesisht në vendet ku ka një prani të madhe të komunitetit të diasporës.

Një pjesë e sfidës e cila mbështet performancën e dobët të eksporteve industriale, lidhet me flukset hyrëse të kufizuara të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në sektorin e prodhimit. Të dhënat e BQK-së tregojnë se flukset hyrëse neto të IHD-ve në sektorin e prodhimit kanë qenë në rënie përgjatë viteve, nga 47 milionë euro sa ishin në vitin 2011, në një fluks daljeje prej 4,6 milionë euro në vitin 2020. Në vitin 2011, flukset hyrëse të IHD-ve në prodhim përbënin 12% të totalit të hyrjeve të IHD-ve, ndërkohë që në vitin 2020 ka pasur një fluks daljeje neto ekuivalente me 1.3% të totalit të hyrjeve neto të IHD-ve.

Tregtia

Kosova është një ekonomi relativisht e hapur sa i përket tregtisë. Indeksi i Hapjes (Openness Index), i cili tregon raportin e tregtisë ndërkombëtare ndaj BPV-së, e pozicionon Kosovën në mesin e ekonomive tregtare liberale me një mesatare prej rreth 90% gjatë periudhës 2017-2021. Importet dominojnë mbi eksportet, duke çuar në një deficit tregtar prej rreth 35% në të njëjtën periudhë – dy herë më i lartë se mesatarja e BP6.

Niveli i lartë i importit të mallrave, duke regjistruar një raport mbulimi prej rreth 13% në pesë vitet e fundit, është përgjegjës për bilancin e përgjithshëm negativ tregtar. Eksportet e mallrave, përveçse janë të vogla në raport me importet, janë mjaft të përqendruara (si në nivel produkti ashtu edhe në nivel gjeografik), kanë mungesë stabiliteti dhe kanë një shkallë të ulët mbijetese në tregjet ndërkombëtare. Metalet bazë, mineralet dhe së fundmi dyshekët përbëjnë pjesën më të madhe të eksporteve, ndërsa vetëm dhjetë vende, kryesisht ato pjesë e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe anëtarëve të Bashkimit Evropian (BE), përbëjnë mbi 80% të të gjithë partnerëve eksportues të Kosovës. Për sa i përket stabilitetit, 44.2% e 4,609 **bizneseve** të angazhuara në eksportet e mallrave gjatë periudhës 2008-2018 nuk mund të mbijetonin më shumë se një vit në tregjet e eksportit, ndërsa vetëm 2.1% kanë pasur eksporte të pandërprera. Kjo performancë e zymtë e eksportit është kryesisht një reflektim i kufizimeve të shumta nga ana e ofertës (sfidat brenda kufirit) si qasja e kufizuar në financa, konkurrenca jo lojale, kapacitetet e vogla për inovacion dhe punëtorët e pakualifikuar. Këto kufizime përbëjnë po ashtu edhe faktorët e rrjedhës masive të importeve.

Ndryshe nga rasti i mallrave, Kosova qëndron shumë më mirë në tregtinë e shërbimeve. Sasia mesatare e eksportit të shërbimeve është rreth dyfishi i importeve për periudhën 2017-2021. Ky suficit ka kontribuar në kompensimin e deficitit të qëndrueshëm tregtar në mallra. Megjithatë, kjo është e pamjaftueshme pasi tregtia e shërbimeve përbën vetëm rreth 1/3 e tregtisë së përgjithshme. Pavarësisht performancës më të mirë, si në rastin e mallrave, eksportet e shërbimeve nuk janë as të diversifikuara mirë. Për periudhën në shqyrtim, vetëm udhëtimet përbëjnë pjesën më të madhe të eksportit të shërbimeve me më shumë se 80%. Përveçse niveli i lartë i përqendrimit të eksportit të shërbimeve është problem më vete, edhe vetë struktura e sektorit të udhëtimit, me turizmin e diasporës si shtytës kryesor, është një çështje tjetër, e cila e bën performancën aktuale të eksporteve në masë të madhe të paqëndrueshme, duke marrë parasysh në afat të gjatë perspektivat për "lodhjen e diasporës".

Tabela 1: Evoluimi i tregtisë (mil. €)

Tregtia	2017	2018	2019	2020	2021
Eksporti i mallrave	378.0	367.5	383.5	474.9	749.7
Importi i mallrave	3,047.0	3,347.0	3,496.9	3,296.0	4,652.7
Eksporti i shërbimeve	1,358.8	1,561.6	1,675.1	994.9	1,954.4
Importi i shërbimeve	531.5	705.8	749.1	603.3	870.7

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Një studim i vendeve të CEFTA-s i kryer nga Economist Intelligence Unit (EIU) gjithashtu tregon se Kosova performon nën potencialin e saj eksportues. Sipas këtij studimi, Kosova shfrytëzon vetëm rreth 38% të potencialit të saj të eksportit në mallra dhe shërbime bazuar në shtytësit kryesorë të potencialit tregtar: d.m.th, nivelin e zhvillimit të Kosovës, madhësinë e saj dhe distancën nga tregjet kryesore. Në këtë drejtim, Kosova është me performancën më të dobët krahasuar me e vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shumë larg 11 vendeve anëtare postkomuniste të BE-së, ku eksportet aktuale janë vetëm 2 pikë përqindje më pak se potenciali i vlerësuar i tyre.

Politika e tregtisë ndërkombëtare të Kosovës është formësuar nga disa marrëveshje tregtare preferenciale, si Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), Zona e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Kosovës me Turqinë dhe Partneriteti, Tregtia dhe Bashkëpunimi MB-Kosovë. Aktualisht, Kosova është duke negociuar një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me shtetet e EFTA-s. Gjithashtu vlen të theksohet se Kosova përfiton nga skemat e Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave (GSP) me SHBA-në, Norvegjinë, Zvicrën dhe Japoninë, të cilat ofrojnë trajtim preferencial të njëanshëm (më mirë se MFN) për produktet me origjinë nga Kosova.

Një industri e zhvilluar mirë është shpesh nxitësi kryesor i performancës së mirë të eksporteve në ekonominë në zhvillim. Me qëllim të zgjerimit të prodhimit industrial, Politika Industriale krijon bazën që Kosova të rrisë performancën e saj të eksportit dhe rrjedhimisht të përmirësojë bilancin tregtar. Politika Industriale gjithashtu trajton drejtpërdrejt çështjen e tregtisë duke synuar uljen e deficitit tregtar industrial përmes mbështetjes së ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialet e eksportit dhe arritjen e diversifikimit, nga njëra anë, dhe duke reduktuar mbështetjen e tepërt në produktet e huaja të ndërmjetme dhe finale, nga ana tjetër. Ndërsa (nën) objektivat e parashikuara të politikës industriale të lidhura me tregtinë janë thelbësore dhe ka të ngjarë të kenë efekte të tjera në sektorët joindustrialë, ato ende zënë vetëm një pjesë të politikës tregtare të vendit. Për të trajtuar tregtinë në mënyrë më gjithëpërfshirëse, Qeveria është e vendosur të hartojë një **dokument të veçantë të Politikës Tregtare**. Përveç aspekteve të tjera të mbetura të tregtisë industriale, Politika Tregtare do të mbulojë tërësisht shërbimet dhe tregtinë bujqësore. Qasja në treg dhe barrierat e funksionimit të natyrës rregullatore në rastin e shërbimeve dhe tendencat më të larta proteksioniste në rastin e bujqësisë, ndër të tjera, do të jenë çështje që do të kenë vëmendje të veçantë.

Promovimi i Investimeve

Gjatë dekadës së kaluar, investimet në Kosovë ishin në rreth 30% të BPV-së, duke tejkaluar mesataren e BP6, pavarësisht se kjo është relativisht e lartë, pjesa më e madhe e këtij investimi nuk ka kontribuar në rritjen e bazës së prodhimit vendor apo aktiviteteve të tregtueshme. Investimet kanë shkuar kryesisht në shitje me shumicë dhe pakicë, ndërtim, transport dhe shërbime financiare. Krahas sektorit të fundit, pjesa tjetër e sektorëve mbështesin konsumin e brendshëm dhe kanë një ndikim të vogël në rritjen e kapaciteteve prodhuese. Gjatë tre viteve të fundit, nga të gjitha investimet, vlerësohet se vetëm 17% shkuan për blerjen e aseteve fizike për proceset e prodhimit (d.m.th. makineri, pajisje dhe mjete të tjera).

Investimet e Huaja Direkte (IHD), të cilat zakonisht japin një shtysë për një përmirësim të qëndrueshëm të ekonomisë, si % e BPV-së, mbeten nën mesataren e BP6 me 1.9 %, duke mbetur në 3.9%. Ngjashëm me investimet e përgjithshme, pjesa më e madhe e IHD-ve shkoi në sektorë me efekte të vogla të rritjes. Pasuritë e paluajtshme dhe ndërtimet kanë tërhequr gati 60% të të gjitha IHD-ve që kanë ardhur në vend në dekadën e fundit. Nga ana tjetër, në të njëjtën periudhë, dy sektorë me potencial të konsiderueshëm rritjeje, prodhimi dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), përbënin vetëm 1.3% të totalit të IHD-ve. Përveç sfidave strukturore, duke përfshirë qasjen e kufizuar në financa, boshllëqet e infrastrukturës dhe konkurrencën e jo lojale, performanca e dobët e Kosovës në tërheqjen e IHD-ve të cilat përmirësojnë rritjen, i atribuohet regjimit të pafavorshëm të stimulimit, i cili kryesisht mbështetet në marrëveshjet për mbrojtjen e investimeve dhe disa veprime të lehtësimit fiskal. Përderisa Kosovës i mungojnë stimujt financiarë për IHD-të, disa vende fqinje (d.m.th., Serbia dhe Maqedonia e Veriut) ofrojnë subvencione lidhur me punësimin, subvencione për të mbuluar kostot e investimeve, stimuj për Kërkim dhe Zhvillim, dhe pako të tjera stimuluese dhe si rezultat i kësaj arrijnë të tërheqin më shumë IHD.

Perspektiva e fundit e Konkurrencës e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) zbulon se performanca e Kosovës në investime u përkeqësua pak, duke u ulur nga rezultati 2.6 në 2018 në 2.0 në 2021 (në një shkallë nga 0 në 5), kryesisht për shkak të promovimit të dobët të investimeve dhe performancës lehtësuese. Duke e ditur performancën e pakënaqshme të investimeve, Qeveria e Kosovës është zotuar për hartimin e një Programi për Promovimin e Investimeve, i cili pritet të artikulojë zgjidhjet konkrete dhe gjithëpërfshirëse të vendit për më shumë investime, veçanërisht me orientim eksporti. Politika Industriale do të luajë rolin e saj në përpjekjet e Qeverisë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të investimeve të Kosovës, në veçanti në prodhim.

Të drejtat e pronësisë industriale

Kosova ka krijuar një sistem ligjor relativisht të qëndrueshëm sa i përket të Drejtave të Pronësisë Industriale (DPI) në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e pronësisë industriale dhe pjesërisht të përafëruar me ligjin përkatës të pronësisë industriale në Bashkimin Evropian. Pavarësisht kësaj, ajo ende nuk ka arritur të krijojë instrumentet e nevojshme për të nxitur gjenerimin dhe komercializimin e pronës industriale nga shpikës individualë, biznese, industri, universitete dhe institucione kërkimore.

Zbatimi i të drejtave të pronësisë industriale mbetet një pikë e dobët e sistemit. Gjykatat kanë kapacitete të kufizuara dhe ekspertizë të pamjaftueshme për të trajtuar mosmarrëveshjet në lidhje me pronësinë industriale. Po kështu, koordinimi ndërmjet autoriteteve përmbarimore është relativisht i dobët dhe për këtë arsye pengon zbatimin efektiv të DPI. Për më tepër, ndërgjegjësimi i publikut dhe edukimi i konsumatorëve për çështjet që kanë të bëjnë me DPI nuk janë në nivelin e dëshirueshëm, duke paraqitur një sfidë tjetër për një sistem efektiv të mbrojtjes së DPI.

3.1.2. Dimensioni social¹

Kosova përballlet me sfida thelbësore sociale, të manifestuara në varfëri të lartë dhe papunësi. Tetëmbëdhjetë përqind (18%) e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 5.1% që jetojnë në varfëri ekstreme (raporti i BB dhe ASK, 2019). Për më tepër, çdo i gjashti kosovar i punësuar konsiderohet i varfër në punë (Rrjeti Evropian i Politikave Sociale, RrEPS, raport, 2019). Ndërsa përqindja kombëtare e papunësisë është në një nivel të konsiderueshëm prej 26%, grupet e cënueshme si gratë janë veçanërisht të prekura (me 32.3% të papuna), ndërsa çdo i dyti i ri i moshës 15-19 vjeç është pa punë për më shumë se një vit (Anketa e Fuqisë Punëtore, AFP, 2020).

Spektori i prodhimit mund të japë kontribut të rëndësishëm për të zbutur këto sfida duke ofruar mundësi punësimi gjithëpërfshirëse dhe paga të mira. Megjithatë, sektori i prodhimit ofron mundësi relativisht të kufizuara punësimi, duke punësuar aktualisht vetëm 12% të fuqisë punëtore në vitin 2020, nga 13% në vitin 2015. Analiza tregon gjithashtu se ndërmjet viteve 2015 dhe 2020, përderisa sektori i prodhimit të Kosovës u rrit çdo vit me një normë të përbërë prej 2.5%, punësimi në industri u rrit pak më shumë me 2.8% gjatë së njëjtës periudhë. Kjo


¹ Ndryshe nga dimensionet e tjera, tek ai social diagnostikimi shikon një periudhë më të shkurtër, përkatësisht 2015 – 2020, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme për periudhën e mëparshme.

tregon se krijimi i vendeve të punës në sektorin e prodhimit shkoi paralelisht me rritjen ekonomike të sektorit të prodhimit. Shkurtimisht, rritja e sektorit të prodhimit të Kosovës u *udhëhoq nga punësimi*.

Ndërmjet viteve 2015 dhe 2020, 5,700 vende të reja pune u krijuan në prodhim. Ky numër nuk përfshin vendet e punës indirekte të krijuara në sektorë të tjerë për shkak të lidhjeve të tyre me industrinë në rritje. Në vendet krahasuese, rritja në sektorin e prodhimit është nxitur edhe nga punësimet, veçanërisht në Shqipëri (3,7% rritje vjetore e VShP, shoqëruar me një rritje prej 4,7% në punësimin në prodhim); Bosnja (1,7% norma e rritjes vjetore të VShP dhe 2% rritje e punësimit në prodhim); Mali i Zi (0,6% norma e rritjes vjetore të VShP dhe 2,4% rritje e punësimit); Maqedonia e Veriut (një normë negative e rritjes vjetore të VShP prej 0.5%, e lidhur me 0.9% rritje në punësimin në prodhim) dhe Serbia (1.5% norma e rritjes vjetore VShP, shoqëruar me një rritje prej 5% në punësimin në prodhim). Në shumë nga këto raste, rritja në prodhim ishte si rezultat i punës intensive, veçanërisht në Serbi, Shqipëri dhe Bosnje. Në Slloveni, rritja e produktivitetit ishte kritike (një rritje vjetore prej 3.6% në VShP, por vetëm 2% rritje në punësim).

Ndërmjet viteve 2015 dhe 2020, pagat e sektorit të prodhimit u rritën mesatarisht me 11%. Rritja e fitimeve për punëtorët konfirmohet edhe nga studimi i intensitetit relativ të pagës, i matur si përqindje e pagave të prodhimit si pjesë e VShP-së. Ky tregues mat pjesën e VShP-së që u shkon punëtorëve të sektorit të prodhimit në formë të pagave. Figura 7 më poshtë tregon se intensiteti relativ i pagave në Kosovë është rritur nga 21% (2015) në 35% (2020). Shkurtimisht, me një sektor prodhimi në rritje, fatura totale e pagave të prodhimit është rritur. Megjithatë, ajo rezulton ende në intensitetin më të ulët të pagave relative në rajon. Të gjitha vendet krahasuese zënë mbi 40% të peshës së pagave në VShP.

Figura 7. Intensiteti relativ i pagave të industrisë



Burimi: Indikatorët e Shteteve

Sa i përket punësimit gjithëpërfshirës, analiza zbuloi se Kosova ka pjesëmarrjen më të ulët të grave në fuqinë punëtore të përgjithshme, ashtu edhe në punësimin në sektorin e prodhimit. Përqindja e grave në punësimin total ishte vetëm 25% në vitin 2020, nga 22.5% në vitin 2015, ndërsa mesatarja e BP6 mbeti në 40% në 2020, me shumë vende tjera krahasuese të BP6 që ishin mbi 40%, ndërsa vendet model Estonia me 48% dhe Sllovenia në 46%. Përqindja e grave në punësimin në prodhim është njësoj e ulët për Kosovën në krahasim me vendet tjera krahasuese: ndonëse përqindja e grave u rrit nga viti 2015 (10%) në 2020 (16%), ajo mbeti largë nën mesataren e BP6 prej 37% në vitin 2020, me Shqipërinë me afro 60% të pjesëmarrjes, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me afro 50%.

3.1.3. Dimensioni Mjedisor²


Konsumi final i energjisë nga industria në Kosovë ka qenë në rënie që nga viti 2011 (308 kiloton ekuivalent naftë, ose thjesht “KTOE”) deri në vitin 2019 (300 KTOE). Megjithatë, përveç Bosnjës, e cila përjetoi rritje vjetore prej 1.2% të konsumit të energjisë në industri gjatë viteve 2011–2019, Kosova kishte ritmin më të moderuar të reduktimit vjetor të konsumit të energjisë nga industria me 0.13%, krahasuar me Malin e Zi me shkallën më të lartë të reduktimit vjetor prej 2.6%, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 1.8% dhe Serbia me 1.2%.

E ndarë sipas sektorëve në Kosovë, përqindja e industrisë në konsumin final të energjisë në vitin 2020 doli e treta me 20.1%, pas sektorit të amvisërisë me 40.1% dhe sektorit të transportit me 27%. Në kuadër të sektorit industrial, industritë e qelqit, qeramikës dhe materialeve të ndërtimit, konsumuan përqindjen më të madhe të energjisë (36%), e ndjekur nga industria e hekurit dhe çelikut (23%) dhe industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit me 15.5%. Produktet e naftës ishin burimi më i madh i energjisë në sektorin e industrisë, duke përbërë 63% të totalit të burimeve të energjisë të konsumuara në vitin 2020, pasuar nga energjia elektrike (27%), biomasa (5.7%) dhe qymyri (4.8%).

Sa i përket përdorimit të efikasitetit të energjisë në sektorin e prodhimit, në vitin 2019, Kosova gjeneroi një vlerë ekonomike prej €2.1 milion për njësi të KTOE, duke tejkaluar shumicën e vendeve të BP6 (mesatarisht €1.8 milion për njësi KTOE), përveç Serbisë, e cila në të njëjtën viti gjeneroi një vlerë ekonomike prej €2.3 milion për njësi KTOE (shih Figurën 8 më poshtë). Krahasuar me vendet model, Sllovenia dhe Estonia, gjeneruan më shumë se dyfishin e vlerës ekonomike të Kosovës për njësi të konsumit të KTOE. Ndërkohë, gjatë periudhës 2011–2019, norma vjetore e rritjes së Kosovës në përdorimin e efikasitetit të energjisë është rritur për 3%, krahasuar me mesataren e BP6 prej 4%.

² Ju lutemi vini re se të dhënat nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA) mbulojnë vetëm periudhën deri në vitin 2019.

Figura 8: Eficienca e energjisë në sektorin e prodhimit, Kosova kundrejt vendeve krahasuese,



Burimi: Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës


Për sa i përket intensitetit të CO₂, i matur me kt CO₂ që emetohen për €1 milion VShP të gjeneruara, Kosova shënoi një reduktim vjetor prej 6% gjatë periudhës 2011–2019, krahasuar me mesataren e BP6³ prej 8% reduktim gjatë të njëjtës periudhë, ku veçohet Serbia me një reduktim vjetor prej 11%. Sektori i prodhimit të Kosovës emetoi 1.17 kt CO₂ për 1 milion euro në VShP në vitin 2019, krahasuar me 0.52 kt në Serbi, 0.87 kt në Maqedoninë e Veriut, 0.81 kt në Bosnje dhe 1.31 kt në Shqipëri.

Sllovenia dhe Estonia (përkatësisht 0.21 kt dhe 0.29kt) performuan dukshëm më mirë: ato tashmë kishin një efikasitet shumë më të lartë të energjisë, por megjithatë arritën të përmirësoheshin ndjeshëm duke fituar rreth 2.5 herë vlerë të shtuar më të lartë për KTOE të inputit të energjisë.

Si përmbledhje, Kosova e zvogëloi intensitetin e saj të CO₂ me një normë të ngjashme vjetore me vendet e tjera të BP6, por me Bosnjën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë që i reduktuan ato me një ritëm pak më të shpejtë, ndërsa në vitin 2020 ende emeton dy herë më shumë se Serbia, dhe gati tre herë më shumë se Estonia dhe mbi 5 herë më shumë se niveli i Sllovenisë.

³ Nuk u gjetën të dhëna për Malin e Zi.

Figura 9: Intensiteti i CO2 për €1 milion të VShP të gjeneruar



Burimi: Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë dhe Treguesit Botëror të Zhvillimit

Së fundi, Raporti Vjetor i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në vitin 2020 zbuloi se sektori i prodhimit i Kosovës është një ndotës i konsiderueshëm. Në vitin 2020, sektori i prodhimit ishte emetuesi më i madh i ndotësit kryesorë të dioksidit të squfurit SO₂ me 96% të emetimeve totale të SO₂ dhe ishte përgjegjës për më shumë se gjysmën (57%) e ndotjes së oksidit të azotit NO_x.

3.1.4. Burimet e Brendshme Natyrore

Burimet natyrore, të ripërtrishme dhe jo të ripërtrishme, ofrojnë inpute të domosdoshme për prodhimin dhe industrinë. Qasja e brendshme në burimet natyrore shihet shpesh si një avantazh për zhvillimin industrial. Që një vend të përfitojë nga burimet natyrore në afat të gjatë, është thelbësore të menaxhojë dhe përdorë burimet dhe materialet e tij natyrore me mençuri, efikasitet dhe në mënyrë të qëndrueshme.

Kosova është e pasur me një shumëllojshmëri të vendburimeve minerale të shfrytëzueshme. Përveç që zë vendin e 5-të në botë me rezervat e qymyrit të linjitit, ajo gjithashtu ka depozita të bollshme të mineraleve të ndryshme metalike, si plumbi, zinku, nikeli, kromi, dhe është e pasur me minerale jometalike, duke përfshirë gëlqerorët, argjilën dhe merlat. Deri më sot, përdoret vetëm një pjesë e potencialit të disponueshëm, ndërsa pjesë të mëdha të rezervave minerale mbeten të papërdorura, pak të shfrytëzuara dhe pamjaftueshëm të eksploruara. Shumica e mineraleve të nxjerra, veçanërisht ato metalike, janë eksportuar në formë të papërpunuar ose me pak përpunim.

Kosova ka tokë të mjaftueshme bujqësore të cilësisë së lartë, që përbën rreth 39% (420,210 ha) të sipërfaqes së përgjithshme të tokës. Livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e zakonshme) dhe tokat e punueshme zënë pjesën më të madhe të tokës bujqësore të shfrytëzuar, me përkatësisht 52% dhe 43%, ndërsa perimet, kopshtet, plantacionet e pemëve dhe plantacionet e vreshtave përbëjnë vetëm 5%. Vlera e produkteve bujqësore në pesë vitet e fundit ishin mesatarisht €781.2 milionë. Të lashtat, veçanërisht drithërat, bimët foragjere, perimet dhe frutat, përbënin pjesën më të madhe të prodhimit. Gjedhët dhe qumështi ishin produktet dominuese në kategorinë e kafshëve dhe produkteve të tyre. Pavarësisht potencialit të saj, Kosova mbështetet shumë në importet e produkteve bujqësore. Për më tepër, lidhjet e fermerëve vendas me industrinë përpunuese janë të kufizuara.

Pylltaria është një resurs tjetër që ka Kosova. Pyjet e vendit shtrihen mbi 481,000 ha, 44,7% e sipërfaqes totale të tokës. Mbulimi pyjor në Kosovë është më i lartë se në pjesën tjetër të BP6 (Shqipëri 28%, Maqedoni 39%, Mali i Zi 40% dhe Serbi 31%). Drurët gjethegjere dominojnë pyjet e Kosovës me 93% (449,400 ha). Rezerva totale në rritje është 40.5 milionë m³ dhe ka një trend të qëndrueshëm. Rreth 45% milionë m³ e rezervave në rritje qëndron në pyjet e Ahut, më pas vijnë pyjet e Dushkut me mbi 22%. Rezerva mesatare e rritjes për hektar është 84 m³, më e ulët se mesatarja evropiane prej 104 m³/ha. Sa i përket pronësisë, 62% e pyjeve janë në pronësi të shtetit, ndërsa pronarët privatë zotërojnë pjesën e mbetur. Bazuar në Inventarin Kombëtar të Pyjeve (IKP), vjelja e qëndrueshme bruto vjetore arrin në 1.45 milion m³ me rreth 630,000 m³ në cilësi të lartë dhe 815,000 m³ me cilësi të ulët të cungishteve. Përveç rolit të tyre vendimtar në shëndetin e njeriut, ruajtjen e biodiversitetit dhe parandalimin e degradimit të tokës, pyjet mund të japin edhe një kontribut ekonomik. Kontributi aktual i sektorit të pylltarisë në BPV-në e Kosovës vlerësohet të jetë i parëndësishëm, duke lëvizur rreth 1%.

Në kushte të qëndrueshme, të gjitha këto burime mund të jenë të nevojshme për industrinë. Mineralet metalike mund të ndihmojnë zhvillimin e industrisë së metaleve, ndërsa metalet jometalike (p.sh., bentoniti) mund të plotësojnë nevojat e industrisë kimike. Burimet e bujqësisë mund të përdoren më shumë në zinxhirin ushqimor, ndërsa pylltaria mund të përdoret më mirë si input për industrinë e drurit.

3.2. Përmbledhje e analizës së problemit

Edhe pse shkalla e rritjes së BPV-së po tejkalon vendet e rajonit, Kosova ka ende BPV-në më të ulët për kokë banori në mesin e BP6-së dhe si rrjedhim, është ‘drita e fundit (tail-light) e zhvillimit ekonomik në rajon. Sektori i prodhimit i Kosovës ka një peshë pak më të lartë në përbërjen e strukturës ekonomike, krahasuar me vendet e BP6. Megjithatë, sektori i prodhimit nuk është bërë shtytës i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, pasi përqindja e tij në BPV ka mbetur e qëndrueshme gjatë 10 viteve të fundit. Vlera e shtuar e prodhimit u rrit me 2.5%, që është rritje e moderuar në vit, duke rezultuar në një kapacitet prodhimi prej €338 VShP/kokë banori, që është më e ulët se mesatarja e BP6 prej €365 VShP/kokë banori dhe dukshëm më e ulët se Sllovenia (€3,530 VShP/kokë banori) dhe Estonia (€1,855 VShP/kokë banori).

Mungesa e performancës së prodhimit të Kosovës mund të lidhet, së pari, me vlerën e kufizuar që e shton prodhimi vendor në procesin e prodhimit. Kjo është për arsye të ndryshme: (i) pjesa e prodhimit të teknologjisë së mesme dhe të lartë është vetëm 5.6% e vlerës së shtuar bruto, pasi pjesa më e madhe e prodhimit bazohet në teknologjinë e ulët, e cila shkon së bashku me produkte me vlerë më të ulët të shtuar; (ii) burimet ekzistuese natyrore (d.m.th. metalet) shpesh eksportohen si lëndë të para ose vetëm si mallra me përpunim të kufizuar, kështu që shtimi kryesor i vlerës në këto zinxhirë vlerash ndodh jashtë Kosovës; (iii) zinxhirët e dobët të vlerës së brendshme mund të gjenden gjithashtu në industritë përpunuese (p.sh. industria e drurit dhe e mobiljeve) që importojnë shumicën e inputeve të tyre (materiale dhe shërbime), në vend që t'i sigurojnë ato në vend. Rrjedhimisht, zinxhirët e dobët të vlerës së brendshme dhe përdorimi joefikas i burimeve ekzistuese natyrore çojnë në rrjedhje të ndryshme të vlerës.

Së dyti, mungesa e performancës së prodhimit të Kosovës mund të lidhet edhe me integrimin e ulët në tregun global të industrive të Kosovës. Duke pasur parasysh tregun e vogël vendor, eksportimi i mallrave jashtë vendit është një mjet jetik për të nxitur prodhimin dhe për të arritur efekte ekonomike në shkallë. Kosova arriti të rrisë përqindjen e mallrave të prodhuara në totalin e eksporteve në 84% (që është ende vlera më e ulët në BP6), megjithatë eksportet mbeten vazhdimisht të ulëta me 22% pjesëmarrje ndaj BPV-së krahasuar me mesataren e BP6 prej 35%, dhe më shumë se 70% në Estoni ose Slloveni. Pavarësisht rritjes së eksporteve të prodhuara, varësia nga mallrat e përpunuara të importuara është rritur edhe më shumë, duke arritur në raportin 1:7 të eksporteve të përpunuara kundrejt importeve. Së fundi, eksportet e prodhuara janë të përqendruara në disa produkte dhe në një numër të kufizuar të tregjeve rajonale dhe të BE-së, duke e komplikuar më tej pozitën e dobët të Kosovës në konkurrencën e jashtme.

Kosova përballlet me sfida thelbësore sociale, të manifestuara në varfëri të lartë dhe papunësi prej 26% dhe norma dukshëm më të larta tek gratë dhe të rinjtë. Sektori i prodhimit midis viteve 2015 dhe 2020 krijoi rreth 5,700 vende të reja pune. Rritja e prodhimit u përkthye në një rritje pak më të shpejtë të punësimit në prodhim (rritje e udhëhequr nga punësimi). Megjithatë, sektori është ende larg shpalosjes së potencialit të tij për krijimin e shumë vendeve të denja të punës. Tregu i punës në prodhimtari në Kosovë karakterizohet me paga të ulëta, informalitet të lartë dhe pjesëmarrje më të ulët të grave prej 16% krahasuar me mesataren e BP6 prej 37%.

Sa i përket ndikimit mjedisor, aktivitetet prodhuese në Kosovë, gjenerojnë ndotje të konsiderueshme, ku industria është fajtori kryesor për emetimin e substancave helmuese si SO₂ dhe NO_x. Industria është konsumatori i tretë më i madh i energjisë, pas sektorit të amvisërisë dhe transportit. Industria e Kosovës performon më mirë se shumica e vendeve të rajonit në efikasitetin e energjisë, megjithatë, Sllovenia dhe Estonia gjenerojnë 2.5 – 3 herë më shumë vlerë shtesë për KTOE. Përderisa konsumi i energjisë i industrisë ka qenë në rënie gjatë dekadës së fundit, duke treguar efikasitet më të lartë të energjisë për shkak të rritjes së njëkohshme të VShP-së gjatë së njëjtës periudhë, megjithatë Kosova ende kishte ritmin më të ulët të reduktimit vjetor të konsumit të energjisë krahasuar me vendet krahasuese të BP6. Përveç kësaj, Kosova gjithashtu ka reduktuar intensitetin e prodhimit të CO₂ me një ritëm vjetor prej 6%, që është më e ulët se mesatarja e BP6 prej 8% (pa Malin e Zi), por shumë më e ngadaltë se reduktimi i

Serbisë me 11% ose ai i Sllovenisë dhe Estonisë. Sa i përket intensitetit të CO₂, Kosova renditet vetëm në një pozitë mesatare në BP6.

Analiza e Performancës Industriale zbulon se gjatë dekadës së kaluar, sektori i prodhimit ka dështuar të kthehet në një shtytës të zhvillimit social, ekonomik dhe mjedisor të Kosovës. Kjo politikë, pra, është e përkushtuar për të mbështetur sektorin e prodhimit për të shpalosur potencialin e tij dhe për të kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të vendit në mënyrë më efektive.

4. PËRAFRIMI I SKZH-SË DHE VIZIONI I POLITIKËS INDUSTRIALE

4.1. Përafrimi me SKZH dhe Kontributi në Qëllimet Strategjike

Çdo politikë, për të qenë efektive, duhet të integrohet me një kornizë strategjike kombëtare gjithëpërfshirëse dhe të kontribuojë në arritjen e objektivave të zhvillimit kombëtar të vendit (OKZh). Sigurimi i orientimit të përgjithshëm strategjik të Politikës Industriale kërkon të kuptuarit se cilat OKZh mund të arrihen më së miri nëpërmjet zhvillimit industrial, dhe për këtë arsye duhet të ndiqen nga politika industriale.

Objektivat zhvillimore kombëtare të Kosovës janë të përshkruara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2030, të publikuar në vitin 2022. SKZH 2030 artikulon vizionin afatgjatë të zhvillimit të Kosovës duke përcaktuar prioritetet kryesore të zhvillimit, objektivat strategjike dhe rezultatet e pritura. SKZH është hartuar bazuar në një vlerësim dhe analizë gjithëpërfshirëse të kushteve sociale dhe ekonomike të Kosovës dhe identifikon nevojat dhe sfidat kryesore që duhet të adresohen deri në vitin 2030. SKZH 2030 përbën dokumentin strategjik më të rëndësishëm të Kosovës, duke përforcuar nevojën kritike për të pasur një kornizë të përgjithshme të planifikimit strategjik në Kosovë. SKZH 2030 organizohet në katër shtylla kryesore zhvillimore, përkatësisht: Shtylla 1: Rritja e qëndrueshme ekonomike; Shtylla 2: Zhvillimi i barabartë njerëzor; Shtylla 3: Siguria dhe sundimi i ligjit; dhe Shtylla 4: Qeverisja e Mirë. Në çdo shtyllë zhvillimi, SKZH 2030 përcakton disa objektiva strategjike, të cilët zbërthehen më tej sipas objektivave specifike dhe veprimeve konkrete.

SKZH 2030 ishte kritike për procesin e hartimit të orientimit të përgjithshëm strategjik të Politikës Industriale të Kosovës. Politika Industriale është më së shumti e lidhur me shtyllën 1 (Rritja e qëndrueshme ekonomike) dhe shtyllën 2 (Zhvillimi i barabartë njerëzor). Brenda këtyre dy shtyllave, objektivat strategjike të mëposhtëm janë OKZh-të në të cilat Politika Industriale mund të ketë ndikim më të madh:

OKZh1: Ekonomi dixhitale, rrethore/qarkore dhe konkurruese

OKZh1 kërkon të zhvillojë një ekonomi të integruar ndërkombëtarisht, konkurruese, rrethore/qarkore, të përqendruar rreth inovacionit dhe dixhitalizimit. Aktualisht, performanca ekonomike e Kosovës është e kufizuar (€3,772/kokë banori), jokonkurruese (eksportet përbëjnë vetëm 21.6% të BPV-së), me intensitet përgjithësisht të lartë të CO2 (0.47 kg CO2 për njësi të PFB të përshtatur me BPV), me vlerë të ulët të shtuar bruto si pjesë e BPV-së në sektorët që lidhen me ekonominë rrethore (0.8% e BPV-së) dhe me marrje/pranim të kufizuar të dixhitalizimit (me një rezultat intensiteti 35.7, që është gjysma e mesatares së BE-së).

Zhvillimi industrial është kritik për dixhitalizimin dhe inovacionin, përmirësimin e qarkullimit të materialit dhe konkurrencën e jashtme. Së pari, sektori industrial është në gjendje, ndoshta më shumë se shumica e sektorëve, të gjenerojë përfitime produktiviteti përmes përmirësimit teknologjik, inovacionit si dhe dixhitalizimit. Inovacioni dhe zhvillimi i teknologjisë janë në qendër të zhvillimit industrial që sjell vazhdimisht produkte të reja dhe procese të përmirësuara të prodhimit, duke u përkthyer në shtim të vlerës më të lartë. Duke vepruar kështu, sektori i prodhimit ka potencial për të dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në krijimin e një ekonomie inovative dhe digjitale në Kosovë. Së dyti, sektori industrial është në të njëjtën kohë konsumatori më i rëndësishëm i inputeve materiale, duke i përpunuar ato në mallra përfundimtare. Prandaj, përmirësimi i efikasitetit material dhe qarkullimit të sektorit industrial është një nga komponentët më të rëndësishëm drejt krijimit të një ekonomie rrethore në vend. Së treti, shumica e mallrave të tregtuara në ekonominë e zhvilluara janë mallra të prodhuara. Në mënyrë që Kosova, të bëhet një ekonomi më e integruar globalisht dhe konkurruese ndërkombëtare, zhvillimi industrial dhe prodhimi i mallrave të kërkuara globalisht janë të domosdoshëm.

Në të tri dimensionet, sektori i prodhimit të Kosovës është duke performuar dobët. Deri më tani, aktivitetet prodhuese të Kosovës karakterizohen nga një nivel i ulët i inovacionit dhe dixhitalizimit, një industri e gjelbër e kufizuar, pasi mungojnë edhe proceset bazë të riciklimit dhe një performancë e kufizuar eksporti. Politika Industriale i dedikohet aktivizimit të potencialit të industrive për të avancuar qëllimin për të pasur një ekonomi më dixhitale, rrethore të gjelbër dhe konkurruese.

OKZh2: Treg Gjithëpërfshirës i Punës, Punësim më i Madh dhe Dinjitoz

OKZh2 kërkon të zgjerojë punësimin, të rrisë pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe të përmirësojë kushtet e punës. Kosova vazhdon të shfaqë një shkallë të lartë të papunësisë (26%), shkallë të lartë të informalitetit të punës (35%), ndërsa papunësia tek gratë dhe të rinjtë është veçanërisht shqetësuese.

Sektori industrial dhe, rrjedhimisht, politika industriale, kanë potencial për të kontribuar në krijimin e vendeve të punës në mënyra të ndryshme. Industritë intensive të punës mund të krijojnë shpejt shumë vende të reja dhe të thjeshta të punës që ofrojnë të ardhura për shumë familje. Më shumë industri me teknologji dhe kapital intensiv, që kërkojnë një fuqi punëtore të aftë, prirjen të krijojnë vende pune më të qëndrueshme të cilat shkojnë së bashku me paga më të larta, më shumë përfitime sociale dhe kushte të përmirësuara dhe më të mira të punës.

Rritja e prodhimit në Kosovë është përkthyer në më shumë punësim. Megjithatë, shumë punë në sektorin privat vazhdojnë të mbeten joformale, me mundësi të kufizuara për punë të denjë. Një politikë industriale e balancuar dhe e ndjeshme shoqërore ka mundësinë të krijojë vende pune më të denja në prodhim dhe të kontribuojë në një përfshirje më të madhe sociale duke promovuar punësimin e grave dhe të rinjve në industri.

OKZh3: Mjedis i pastër dhe shfrytëzim i qëndrueshëm i burimeve natyrore

OKZh3 synon të mbajë një mjedis të pastër dhe të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të Kosovës. Aktualisht, praktikat e këqija vazhdojnë që dëmtojnë mjedisin dhe të ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës. Tani, Kosova emeton 9.6 milion ton CO₂ ekuivalente në gazra serrë. Për më tepër, vlerësohet se 2,458 vite jetë të humbura për 100,000 banorë i atribuohen ekspozimit ndaj grimcave të imta PM_{2.5}.

Në mënyrë që Kosova të krijojë një mjedis të pastër dhe të përdor më mirë burimet natyrore, prodhimi luan një rol kyç. Si zakonisht ai është një nga ndotësit kryesorë dhe përgjegjës për forma të ndryshme të emetimeve si CO₂, si dhe mbetjet e ngurta dhe ujërat e zeza, prandaj përmirësimet në performancën mjedisore të industrive mund të japin një kontribut të rëndësishëm në arritjen e këtij objekti strategjik të SKZH-së.

Në Kosovë industritë janë një nga ndotësit dhe konsumatorët kryesorë të burimeve natyrore. Rezervat pak të shfrytëzuara metalike dhe jometalike, si dhe potencialet e bujqësisë dhe pylltarisë mund të nxisin një mori industrish. Shfrytëzimi i këtyre burimeve natyrore në mënyrë të kujdesshme duke reduktuar efektet e dëmshme në mjedis kërkon një politikë industriale të përshtatur e cila bën zgjedhje strategjike, se cilat burime duhet të shfrytëzohen dhe cilat jo, që promovon përmirësimin e teknologjive të pastra për të garantuar efikasitet dhe qarkullim të energjisë dhe materialeve, si dhe një menaxhim të mbetjeve të ngurta industriale.

4.2. Përmbledhje mbi përafrimin me SKZH-në

Përafrimi i Politikës Industriale të Kosovës me SKZH 2030 ofron një arsyetim të qartë se pse Kosova përpiket të promovojë zhvillimin industrial në vend. Kjo përmirëson jo vetëm transparencën dhe legjitimitetin e përgjithshëm të qeverisë, por ndihmon politikëbërësit të zhvillojnë një vizion bindës dhe kuptimplotë të politikës industriale që mund të gjenerojë mbështetjen sociale dhe politike të nevojshme për zbatimin efektiv të politikës industriale. Së fundi, kjo siguron hartimin e një pakoje të politikave industriale të përshtatshme për kontekstin, e cila është në përputhje me prioritetet kombëtare të Kosovës.

4.3. Vizioni dhe Misioni

Vizioni i politikës industriale përfaqëson një deklaratë e cila përcakton drejtimin afatgjatë të transformimit industrial që Kosova përpiqet të arrijë. Duke pasur parasysh orientimin e gjerë strategjik të politikës (shih lidhjet me objektivat strategjike më lart), vizioni përfaqëson thelbin e politikës që është e favorshme si për priorizimin e veprimeve të politikave ashtu edhe për komunikimin me palët e interesit. Në poshtë paraqitet vizioni i Kosovës për politikën industriale deri në vitin 2030, bazuar në konsultimet e gjera dhe të vërtetuara nga palët kryesore të interesit:

Deri në vitin 2030, industria e Kosovës do të transformohet në një industri më të integruar globalisht që është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe të ofrojë punësim të denjë.

Misioni i politikës industriale ofron më shumë detaje mbi qasjen e synuar për të ndihmuar në arritjen e vizionit të politikës industriale të Kosovës. Më poshtë paraqetet misioni i politikës industriale në Kosovë, bazuar në konsultimet e gjera me palët kryesore të interesit:

Kosova përpiqet të arrijë këtë transformim industrial përmes thellimit të zinxhirit të vlerës vendore, rritjes dhe diversifikimit të eksporteve të prodhuara, rritjes së kualifikimit të fuqisë punëtore, dixhitalizimit të përsheptuar të prodhimit dhe teknologjisë së avancuar për prodhimin e gjelbër, si dhe përdorimit më të mirë të burimeve natyrore vendore dhe materialeve të ricikluara.

5. OBJEKTIVAT DHE NËN-OBJEKTIVAT E POLITIKËS INDUSTRIALE

5.1. Objektivat e Politikës

Objektivat e politikës industriale janë qëllime konkrete dhe të matshme të cilat shprehin pse Kosova ndjek një politikë industriale dhe cilat ndryshime saktësisht përpiqet të arrijë QK në sektorin e prodhimit. Objektivat e politikës industriale i përkasin nivelit të ndikimit të logjikës së ndërhyrjes. Suksesi i politikës do të matet në këtë nivel. Prandaj, është i domosdoshëm një formulim i qartë i objektivave të politikës dhe përcaktimi i treguesve dhe objektivave përkatës.

Formulimi dhe priorizimi i objektivave të politikës është njoftuar nga dy burime: së pari, nga orientimi i përgjithshëm strategjik i politikës (p.sh., lidhjet me SKZH 2030), dhe së dyti, nga gjetjet e analizës së performancës industriale. Pyetja udhëzuese për identifikimin e objektivave kryesore të politikës industriale ishte: cilat ndryshime të dëshiruara në performancën e sektorit të prodhimit mund të identifikohen që do të kontribuojnë më shumë në arritjen e tre VShP-ve?

5.1.1. Objektivi 1: Zgjerimi (shtrirja) e Prodhimit Industrial

Objektivi i parë i politikës është zgjerimi/shtrirja e prodhimit industrial dhe rritja e bazës industriale të Kosovës, duke rezultuar në një rritje të prodhimit industrial.

Performanca aktuale: Prodhimi industrial në Kosovë është ende shumë i kufizuar. Edhe pse pjesa e VShP-së në BPV (13.6%) është më e lartë se mesatarja e BP6 (10.7%), Kosova ka një nga kapacitetet më të vogla prodhuese (VShP prej 338 €/kokë banori) në mesin e vendeve krahasuesve të BP6 (VShP prej €365). Duke u fokusuar në zgjerimin industrial, Politika Industriale synon ta bëjë sektorin industrial një forcë shtytëse për zhvillimin e ardhshëm ekonomik në vend dhe që t'i japë rëndësi prodhimit si pjesë e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik.

Shtytësitë industriale: Ndër shtytësit kryesorë për zgjerimin e prodhimit industrial që duhet të adresohen nga kjo politikë, janë qasja e kufizuar në financa dhe investimet e ulëta në prodhim, përvetësimi i kufizuar i dixhitalizimit, prodhimi i produkteve me vlerë të shtuar të ulët, dhe mungesa e cilësisë së produktit.

Lidhja me SKZh: Zgjerimi i prodhimit industrial është thelbësor për realizimin e OKZh 1, veçanërisht pasi një sektor prodhimi me performancë më të mirë dhe konkurrues është kritik për zhvillimin e një ekonomie konkurruese ndërkombëtarisht. Ky objektivi i politikës është gjithashtu kritik për arritjen e OKZh 2, pasi që zgjerimi industrial pritet të vazhdojë të shtrijë kërkesën për vende të reja pune.

Lidhja me OZhQ-të: Përmbushja e këtij objektivi deri në vitin 2030 do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), veçanërisht OZhQ1 (eliminimi i varfërisë), OZhQ8 (punë e denjë dhe rritje ekonomike) dhe OZhQ9 (rritja e industrisë dhe inovacionit).

Treguesit: Progresi në arritjen e këtij objektivi do të matet me dy tregues: a) *vlerën e shtuar të prodhimit për kokë banori*, që mat kapacitetin prodhues të prodhimit; dhe b) *peshën e VShP-së ndaj BPV-së*, e cila mat rëndësinë relative të prodhimit në raport me ekonominë e përgjithshme.

5.1.2. Objektivi 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial

Objektivi i dytë i politikës fokusohet në uljen e deficitit tregtar industrial. Kjo përfshin si eksportimin e më shumë mallrave të prodhuara nga Kosova në tregjet e huaja, por edhe zëvendësimin e importeve të mallrave me prodhim vendor.

Performanca aktuale: Bilanci i përgjithshëm tregtar industrial i Kosovës është dukshëm negativ dhe në rritje, me importet industriale që tejkalojnë eksportet me një raport prej 7:1. Integrimi global i sektorit prodhues të Kosovës është i kufizuar: përqindja e eksporteve në BPV është

vetëm 22% krahasuar me mesataren e BP6 prej 35%, ndërsa përqindja e mallrave prodhuese të eksportuara në totalin e eksporteve të mallrave dhe kapaciteti i eksportit të prodhuar (eksportet e prodhuara për kokë banori) mbeten nga më të ulëtat në BP6 (84% krahasuar me mesataren e BP6 prej 90%). Në të njëjtën kohë, sektori prodhues i Kosovës nuk e plotëson kërkesën e brendshme, duke rezultuar në rritjen e importeve të mallrave të prodhuara nga jashtë.

Shtytësitë industriale: Politika Industriale është e përkushtuar për të ndërruar këtë trend dhe për të ulur deficitin tregtar industrial. Sa i përket eksportit, konkurrenca ndërkombëtare e sektorit të prodhimit të Kosovës duhet të rritet dhe kompanitë të mbështeten për të eksportuar produkte të reja. Në të njëjtën kohë, duhet të depërtohet në tregje të reja të eksportit për të rritur kërkesën ndërkombëtare. Tejkalimi i përqendrimit të lartë të Kosovës në produktet dhe tregjet e eksportit do të kontribuojë gjithashtu në një kërkesë ndërkombëtare më të qëndrueshme dhe më pak të cenueshme. Sa i përket importit, deficitin tregtar duhet të reduktohet nëpërmjet zëvendësimit të importeve me mallra vendase. Kompanitë duhet të mbështeten dhe të stimulohen për të prodhuar mallra në vend të cilat janë importuar deri më tani. Nxitja e eksporteve dhe zëvendësimi i importeve pritet të kenë një ndikim të fuqishëm pozitiv në objektivin 1 të zgjerimit të prodhimit vendas.

Lidhja me SKZh: Kjo politikë është e lidhur me OKZh1 për zhvillimin e një ekonomie konkurruese ndërkombëtare, pasi synon të ndërmarrë hapa për të përmirësuar integrimin e sektorit prodhues të Kosovës në ekonominë globale.

Lidhja me OZhQ-të: Përmbushja e këtij objektivi deri në vitin 2030 do të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e OZhQ1 (eliminimi i varfërisë) dhe OZhQ9 (rritja e industrisë dhe inovacionit).

Treguesit: Progresi në arritjen e këtij objektivi të politikës do të matet nga *bilanci tregtar i prodhimit*, i llogaritur si eksportet e prodhuara minus importet e prodhuara.

5.1.3. Objektivi 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës

Objektivi i tretë i politikës fokusohet në gjenerimin e punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës në prodhim. Kjo do të thotë të mbështetet dhe të përshejtohet potencialisht rritja pozitive e punësimit në industri, por, në të njëjtën kohë, të rritet cilësia e vendeve të punës. Cilësia e punësimit nënkupton krijimin e vendeve të punës që ofrojnë paga më të larta, kushte të qëndrueshme kontraktuale dhe qasje në përfitime të ndryshme sociale.

Performanca aktuale: Punësimi në sektorin e prodhimit u rrit në vitet e fundit me një normë rritjeje prej 2.8% duke absorbuar aktualisht 12% të punësimit total. Pagat në prodhimtari kanë qenë në rritje, por janë ende ndër më të ulëtat në rajon. Kjo reflektohet edhe në rritjen e peshës së pagave që shkojnë për punëtorët (fatura totale e pagave në VShP duke u rritur nga 21% në 2015 në 35% në 2020), e cila është ende nën mesataren e rajonit. Për më tepër, Kosova kishte shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së grave në prodhimtari në BP6 dhe punësimi ende shpesh karakterizohet nga informaliteti dhe kushtet e pafavorshme të punës.

Shtytësitë industriale: Për të mbështetur tendencat pozitive në krijimin e më shumë vendeve të punës dhe dinjitoze, Politika Industriale duhet të adresojë faktorë të ndryshëm kyçë. Sektori i prodhimit i Kosovës karakterizohet nga mangësia mbizotëruese e aftësive: kërkesa e lartë për teknikë si dhe për menaxherë profesionistë përballet me mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar. Duke trajtuar mospërputhjen e përhapur të aftësive, duhet të shfrytëzohet potenciali i pashfrytëzuar i prodhimit për të mbetur ose për t'u bërë një burim edhe më i rëndësishëm i rritjes së vendeve të punës. Krijimi i vendeve më të mira të punës mund të arrihet pjesërisht përmes përmirësimit të kornizës rregullative. Përveç kësaj, duke mbështetur përmirësimin teknologjik, do të krijohen vende pune që kërkojnë kualifikime dhe aftësi më të mëdha dhe, nga ana tjetër, ofrojnë paga më të larta dhe kushte më të mira pune. Duke pasur parasysh migrimin e punëtorëve të kualifikuar në tregje më tërheqëse të punës jashtë vendit, krijimi i vendeve të punës më të mira është thelbësor për mbajtjen në Kosovë të një fuqie punëtore të talentuar, të kualifikuar dhe produktive. Së fundi, Politika Industriale kërkon përmirësimin e përfshirjes sociale të tregut të punës duke rritur pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve në sektorin e prodhimit.

Lidhja me SKZh: Ky objektivi i politikës mund të mbështesë drejtpërdrejt arritjen e OKZh2 për të pasur një treg pune gjithëpërfshirës dhe punësim më të madh dhe dinjitoz.

Lidhja me OZhQ-të: Përmbushja e këtij objektivi deri në vitin 2030 do të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e OZhQ5 (zbatimi i barazisë gjinore), OZhQ8 (punë e denjë dhe rritje ekonomike) dhe OZhQ10 (ulja e pabarazive).

Treguesit: Progresi në arritjen e këtij objektivi do të matet nga dy tregues: a) *punësimi në prodhim për kokë banori*, i cili do të përcaktojë sa është fuqia punëtore, si përqindje e popullsisë, e angazhuar në prodhim; dhe b) *faturën e pagave të prodhimit si pjesë e VShP*, e cila do të masë të ardhurat totale të punës në prodhim si pjesë e vlerës së shtuar të prodhimit.

5.1.4. Objektivi 4: Lehtësimi i Industrisë së Gjelbër

Objektivi i katërt i politikës është të inkurajojë sektorin e prodhimit të kalojë në prodhim të gjelbër. Krijimi i një industrie të gjelbër synon të shkëputë rritjen ekonomike nga eksternalitetet negative mjedisore duke maksimizuar zbatimin e strategjive rrethore, aplikimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe përdorimin efikas të inputeve.

Kosova është ende në fazën fillestare të krijimit të një industrie të gjelbër. Kjo strategji ofron një orientim të përgjithshëm për veprimet e mëtejshme të politikave të nevojshme për kalimin në prodhimin e gjelbër. Një kërkesë kryesore për hartimin e këtyre veprimeve është siguri i të dhënave për performancën mjedisore të industrive.

Performanca aktuale: Qarkullimi dhe riciklimi në prodhimin e Kosovës është ende shumë i kufizuar, ndërsa mbeturinat industriale dhe ndotja janë të konsiderueshme. Efikasiteti energjetik dhe intensiv i CO2 i sektorit të prodhimit të Kosovës është përmirësuar, por ende

mbetet prapa vendeve krahasuese të BP6, gjë që kjo ndodh për shkak të gjenerimit të ulët të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. .

Shtytësit industrialë: Kalimi në prodhimin e energjisë së gjelbër trajtohet nga Strategjia për Energjinë dhe menaxhimi i mbeturinave nga ana e Ministrisë së Mjedisit. Politika Industriale fokusohet në nivel të ndërmarrjes për rritjen e cirkularitetit dhe riciklimit të materialeve në sektorin e prodhimit, prodhimin dhe konsumin e produkteve të gjelbra me karbon të ulët si dhe përmirësimin teknologjik të orientuar drejt efijencës së energjisë.

Lidhja me SKZh: Ky objektivi kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e OKZh3 për të pasur një mjedis të pastër dhe përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe OKZh1 për të pasur një ekonomi rrethore dhe konkurruese.

Lidhja me OZhQ-të: Përmbushja e këtij objektivi deri në vitin 2030 do të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e OZhQ3 (shëndet i mirë dhe mirëqenie), OZhQ6 (ujë i pastër dhe kanalizime), OZhQ7 (energji e përballueshme dhe e pastër), OZhQ12 (konsum dhe prodhim i përgjegjshëm) dhe OZhQ13 (veprim ndaj klimës).

Treguesit: Progresi në arritjen e këtij objektivi të politikës do të matet me dy tregues: a) *Emetimet e CO2 për njësi VShP*, që mat reduktimet në intensitetin e CO2 të aktivitetit prodhues; dhe b) *një tregues riciklimi/cirkulimi*.

5.1.5. Objektivi 5: Maksimizimi i rritjes të vlerës së brendshme

Objektivi i pestë siguron që Kosova të përfitojë nga zhvillimi industrial në mënyrë gjithëpërfshirëse duke maksimizuar shtimin e vlerës së brendshme, brenda procesit të prodhimit dhe më gjerë.

Performanca aktuale: Prodhimi i Kosovës karakterizohet me zinxhirë të vlerës të dobët vendore dhe shfrytëzim joefikas të burimeve ekzistuese natyrore gjë e cila rezulton në humbje të ndryshme të vlerës. Ndër të tjera, kjo është për shkak të prodhimit me teknologji të ulët, përpunimit të kufizuar të burimeve natyrore ekzistuese dhe inputeve të importuara (materiale dhe shërbime) për prodhim në vend që t'i sigurojë ato në vend.

Shtytësitë industrialë: Në këtë objektivi, Politika Industriale synon të thellojë zinxhirin e brendshëm të vlerës duke forcuar lidhjet e prapme dhe përparme (d.m.th., inputet nga sektori i bujqësisë dhe shërbimeve). Ai gjithashtu mbështet lëvizjen drejt prodhimit të produkteve me vlerë më të lartë të shtuar. Po ashtu, do të mbështesë rritjen e nivelit të përpunimit të burimeve ekzistuese natyrore për shfrytëzimin më të mirë të strukturës së ndihmës së dhënë të vendit. Duke vepruar kështu, ky objektivi maksimizon shtimin e vlerës së brendshme në procesin e prodhimit dhe siguron cilësinë e zhvillimit industrial.

Lidhja me SKZh: Ky objektiv kontribuon në OKZh1 për krijimin e një ekonomie dixhitale, rrethore dhe konkurruese dhe OKZh3 për përdorimin më të mirë të burimeve natyrore.

Lidhja me OZhQ-të: Përmbushja e këtij objektivi deri në vitin 2030 do të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e OZhQ1 (ulja e varfërisë) dhe OZhQ9 (rritja e industrisë dhe inovacionit).

Treguesit: Progresi në arritjen e këtij objektivi do të matet nga *VShP si një pjesë e produktit të prodhimit*, i cili kap masën deri në të cilën shtimi i vlerës lokale do të mbështetet në burimet e brendshme.

5.1.6. Shkëmbimet/kompromiset ndërmjet objektivave

Pesë objektivat kryesore të politikës industriale, kanë sinergji të qarta ndërmjet tyre. Megjithatë, ekzistojnë edhe disa shkëmbime/kompromise që mund të ndodhin dhe duhet të merren parasysh gjatë hartimit të veprimeve të politikave dhe monitorimit për të minimizuar ndikimet negative.

Zgjerimi i prodhimit industrial (objektivi 1) dhe maksimizimi i përdorimit të burimeve natyrore vendore dhe rritja e vlerës (objektivi 5) mund të ndikojë negativisht në mjedis, të rrisë konsumin e përgjithshëm të energjisë, materialeve dhe emetimet e CO₂, duke e bërë këtë, të minojë objektivin 4. Një rritje e nxjerrjes së burimeve natyrore mund të kundërshtojë objektivin e një industrie të gjelbër të bazuar në rritjen e cirkularitetit të materialit.

Një rritje në prodhimin industrial mund të mos përkthehet automatikisht në krijimin e vendeve të reja të punës (d.m.th. mund të ketë rritje në prodhim pa shtim të vendeve të punës) në varësi të nën-sektorëve përkatës (shih seksionin 6). Rritja e prodhimit industrial mund të mos krijojë automatikisht vende pune të denja, prandaj duhet të ndërmerren hapa për të kompensuar efektet e mundshme negative në kushtet e punës për fuqinë punëtore.

Reduktimi i deficitit tregtar industrial (objektivi 2), veçanërisht duke nxitur eksportet, mund të mos çojë gjithashtu në një rritje të vlerës së shtuar të brendshme (objektivi 5) nëse politika industriale nuk merr parasysh dhe nuk i trajton rrjedhjet e ndryshme të vlerës.

5.1.7. Synimet dhe treguesit për objektivat

Treguesit për të matur progresin drejt arritjes së objektivave të politikës industriale, nevojiten për të monitoruar ndikimin e Politikës Industriale 2030. Treguesit, ndër të tjera, do të përfshihen në monitorimin vjetor të progresit. Tabela e mëposhtme jep gjithashtu vlerat bazë për të gjithë treguesit, si dhe vlerat e synuara për të gjitha objektivat që do të arrihen deri në vitin 2030. Llogaritja e vlerave të synuara është bazuar në një metodologji të bazuar në dëshmi,

detajet e së cilës, duke përfshirë një listë të detajuar të vlerave të synuara për çdo vit, mund të gjenden në shtojcën 3.

Tabela 1: Treguesit kryesorë të nivelit objektiv, duke përfshirë vlerat bazë dhe objektive

Objektivat e Politikës	Treguesit	Baza 2020	Synimet 2026	Synimet 2030
1. Zgjerimi i Prodhimit Industrial	VShP për kokë banori (EUR)	541.54 (2020)	702.15	809.22
	Pjesëmarrja e VShP në BPV (%)	13.6% (2020)	15.3%	16.5%
2. Reduktimi i Deficitit Tregtar Industrial	Bilanci tregtar i prodhimit (EUR)	-2,327,593,338 (2020)	-2,037,671,294	-1,844,389,930
3. Gjenerimi i Punësimit më të Mirë dhe Gjithëpërfshirës	Punësimi në prodhim për kokë banori	0.0234 (2020)	0.0369	0.0459
	Totali i pagave të prodhimit në VShP (%)	34.51% (2020)	51.55%	62.91%
4. Lehtësimi i Industrisë së Gjelbër	Emetimet e CO2 për njësi të VShP (kt për barazinë e fuqisë blerëse (PFB) USD 2015).	1.1682 (2019)	0.6000	0.2749
5. Maksimizimi i Rritjes të Vlerës së Brendshme	VShP/prodakti i prodhimit	n/a	n/a	n/a

5.2. Nën-objektivat

Pjesa e mëparshme e seksionit 5 mbi objektivat e politikave parashtron arsyet pse Kosova është duke u fokusuar në rritjen industriale, bilancin tregtar industrial, punësimin cilësor, industrinë e gjelbër dhe maksimizimin e përfitimeve vendore. Pesë objektivat e politikës dhe lidhjet e tyre me qëllimet e zhvillimit kombëtar në SKZH-në ofrojnë orientimin e përgjithshëm strategjik të Politikës Industriale.

Kjo pjesë në vazhdim trajton çështjen *se si* do të *arrihen* objektivat e politikës industriale. Duke identifikuar *ndryshimet konkrete* në ekonomi dhe strukturën e kapaciteteve industriale të Kosovës që duhet të ndodhin për të arritur objektivat e politikës, mund të formulohen nën-objektiva më të ngushta të Politikës Industriale. Duke identifikuar nën-objektivat më të

rëndësishme dhe grupet e synuara më efektive (d.m.th. sektorët prioritarë), ky seksion do të krijojë një bazë solide për zhvillimin e një plani veprimi të përshtatur dhe të qëndrueshëm.


5.2.1. Nën-objektivat dhe logjika e përgjithshme e ndërhyrjes

Zhvillimi i veprimeve të duhura të politikave bazuar vetëm në objektivat e politikës është sfidues. Pesë objektivat e politikave industriale të Kosovës të definuara gjerësisht janë ende abstrakte nga natyra dhe nuk ofrojnë udhëzime të mjaftueshme se si mund të arrihen këto objektiva të politikës. Në këtë mënyrë, Politika Industriale prezanton nën-objektivat, si një nivel shtesë që lidh objektivat e politikës me veprimet e politikës në logjikën e ndërhyrjes. Nën-objektivat mund të konsiderohen si *parakushte* ose shtytës për arritjen e një objektivi të caktuar të politikës industriale.

Identifikimi i nën-objektivave është bazuar në vlerësimin e kapaciteteve industriale të Kosovës, i cili përfshin faktorë të ndryshëm, si infrastruktura, financat dhe niveli i aftësive të punëtorëve, të cilët përcaktojnë aftësinë e Kosovës për të prodhuar mallra, për të krijuar vende pune. Përzgjedhja e nën-objektivave më të rëndësishme është bazuar në vlerësimin e aftësive industriale dhe është vërtetuar me një grup më të gjerë të palëve të interesit. Duke qenë se nën-objektivat i referohen karakteristikave të përgjithshme të ekonomisë, ato mund të lidhen dhe të ndikojnë në më shumë se një objektiv politikë në të njëjtën kohë.

Figura më poshtë paraqet logjikën e përgjithshme të ndërhyrjes së Politikës Industriale në të gjitha nivelet. Ajo tregon se cilat objektiva strategjike të SKZH 2030 i lidh më së shumti Politika Industriale e Kosovës, e ndjekur nga objektivat e politikës industriale që rrjedhin nga lidhja me SKZH-në. Ajo gjithashtu paraqet nën-objektivat e ndryshëm, të cilët njoftojnë hartimin e veprimeve konkrete, dhe lidhjet e tyre me objektivat e politikës (të paraqitura në fund të figurës). Vlen të theksohet se nën-objektivat, kutitë e jashtme të të cilave janë të theksuara me të kuqe në figurë, tregojnë se ato vijnë nga SKZH-ja (të përfaqësuara në SKZH si "qëllime specifike").

Figura 10: Logjika e ndërhyrjes së politikës industriale



Burimi: Ekipi hartues i MI, i vërtetuar nga palët kryesore të interesit

Nënseksionet e mëposhtme do të shpjegojnë më në detaje nën-objektivat e identifikuar, lidhjen e tyre me objektivat e politikës, si dhe kufizimet themelore që duhen adresuar nga veprimet e politikave.

5.2.2. Nën-objektivat sipas Objektivit 1: Zgjerimi i Prodhimit Industrial

Ndryshimet kryesore që Kosova duhet të arrijë për të zgjeruar/ritur prodhimin industrial janë: (i) lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor; (ii) rritja e investimeve në prodhim; (iii) përsheptimi i transformimit dixhital; dhe (iv) rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve.

Një nën-objektiv tjetër përkatës për objektivin 1 është përmirësimi teknologjik me fokus në efikasitetin e energjisë dhe materialit, i cili do të diskutohet në objektivin 4.

5.2.2.1. Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor

Qasja në financa në formën e huave dhe kredive nga bankat komerciale, por edhe obligacionet e korporatave dhe instrumentet e tjera alternative të financimit është thelbësore pasi kapitali shtesë i lejon prodhuesit të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese për të konkurruar si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Performanca aktuale: Tregu financiar në Kosovë është mjaft dobët i zhvilluar për prodhuesit. Banka Botërore vlerëson se gati 70% e kompanive kosovare financojnë asetet fikse përmes burimeve të brendshme, me vetëm 11% që mbështeten në financimin bankar. Kredia e brendshme e Kosovës për sektorin privat, si përqindje e BPV-së, është 51% (që është e njëjtë për mesataren e BP6) por është shumë nën mesataren e OECD (160%). Për më tepër, përqindja e kredisë në sektorin prodhues/përpunues ndaj totalit të kredive tregtare përbënte vetëm 17.3% në vitin 2021.

Lidhja me objektivat e politikës: Lehtësimi i qasjes në financa mund të çojë përpara objektivin 1 duke u mundësuar prodhuesve të marrin kapitalin e nevojshëm për të zgjeruar kapacitetet e prodhimit, për të investuar në inovacionin e produktit dhe cilësinë e produktit dhe për të përshpejtuar dixhitalizimin. Nën-objektivi është gjithashtu i lidhur me objektivin 2 pasi kushtet më të lehta të financimit mund t'i mbështesin prodhuesit që të jenë më konkurrues në tregjet e eksportit duke u larguar nga porositë me shkallë të vogël/ulët (kryesisht duke synuar tregjet e diasporës) drejt porosive në shkallë më të gjerë, të bazuara në prodhim serik që mund të përmirësojnë konkurrencën e çmimeve (duke synuar tregjet jo të diasporës).

Kufizimet themelore: Kufizimet kryesore që nxisin qasjen e kufizuar në financa përfshijnë koston relativisht të lartë të financave, kërkesat e larta për kolateral, mungesën e financimit të përshtatur për të mbështetur rritjen e prodhuesve, faktin që sektori financiar është kryesisht i bazuar në banka me instrumente të kufizuara alternative të investimeve, instrumentet jo-ekzistuese të borxhit të korporatave (d.m.th. obligacionet e korporatave), vazhdimësia e informacionit të papërsosur me të cilin përballen bizneset në lidhje me qasjen në mundësi financimi, roli dhe burimet e kufizuara aktuale të FKGK-së për të mbështetur më shumë kompani, dhe praktikat e kufizuara të qeverisjes korporative që ndikojnë në sigurimin e financimit përmes bankave.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të eliminojnë rrezikun e huadhënies për prodhuesit që vendosin kërkesa të larta kolaterali, duke përfshirë diversifikimin e opsioneve të financimit për prodhuesit dhe rritjen e qasjes së përgjithshme tek informacioni për mundësitë e financimit.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me dy tregues: (i) *kredia e brendshme nga bankat për sektorin privat (% e BPV-së)*; dhe (ii) *përqindja/pjesa e prodhimit në totalin e huave komerciale*.

5.2.2.2. Rritja e Investimeve në Prodhim

Ndërsa nën-objektivi i parë synon të nxisë sigurimin e kapitalit për prodhuesit vendor, ky nën-objektiv synon të rrisë fluksin hyrës të kapitalit prodhues veçanërisht në formën e investimeve të huaja por edhe zgjerimin e investimeve të brendshme private. Investimi adekuat në kapacitetet prodhuese është thelbësor për të siguruar që sektori i prodhimit të grumbullojë asete fikse të mjaftueshme. Një investim i tillë do të përmirësojë kapacitetet e furnizimit të

kompanive prodhuese dhe do të lehtësojë transferimin thelbësor të njohurive që vjen me adoptimin e teknologjisë.

Performanca aktuale: Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se hyrjet neto të IHD-ve në sektorin e prodhimit kanë qenë në rënie nga 47 milionë euro në vitin 2011 në 4.6 milionë euro në vitin 2020. Në vitin 2011, hyrjet e IHD-ve në prodhim përbënin 12% të totalit të hyrjeve të IHD-ve, ndërsa në vitin 2020 ka pasur një dalje neto ekuivalente me 1.3% të totalit të hyrjeve neto të IHD-ve. Pjesa më e madhe e IHD-ve shkojnë në sektorë që kanë pak efekte të përhapjes/shtrirjes (spillover effect), me sektorët e pasurive të paluajtshme dhe të ndërtimit që kanë tërhequr gati 60% të të gjitha IHD-ve që rrjedhin në vend në dekadën e fundit. Sa i përket investimeve, edhe pse Kosova ka pjesën më të madhe të formimit të kapitalit fiks bruto ndaj BPV-së në BP6, nuk është e mundur që të zërthehet shkalla deri në të cilën arrijnë kjo për shkak të investimeve në makineri dhe pajisje. Përdorimi i kufizuar i teknologjisë vërtetohet gjithashtu nga përqindja e mallrave kapitale të importuara ndaj VShP që është vetëm 41.6%.

Lidhja me objektivat e politikës: Kapitali është kritik, por i kufizuar brenda vendit në vendet si Kosova. Investimet e huaja janë, pra, një burim i rëndësishëm shtesë për të zgjeruar prodhimin (objektivi 1). Investitorët e huaj vijnë me informacion më të mirë për tregun e huaj dhe kanale shitjesh të vendosura dhe janë të orientuar nga eksporti (kontributi në objektivin 2).

Kufizimet themelore: Mungesa e hyrjeve të IHD-ve ndikohet nga njohja e kufizuar ndërkombëtare, duke përfshirë çështjet që lidhen me transportin dhe logjistikën me të cilat përballen eksportuesit kosovarë, duke paraqitur kështu pengesa operationale për investitorët që janë të interesuar për investimet e orientuara drejt eksportit. Për më tepër, mungesa e ofertës së një fuqie punëtore të kualifikuar dhe një treg i vogël vendor kontribuojnë gjithashtu në interesin e kufizuar të investimeve të huaja. Ndërkohë, ajo që dëmton akumulimin më të madh të investimeve të huaja vendore ndikohet edhe nga dështimet e politikave të cilat nuk kanë arritur të përdorin mjete të tilla si zonat ekonomike dhe parqet industriale. Ndryshe nga vendet krahasuese, investimet strategjike nuk janë stimuluar mjaftueshëm me mjete fiskale në formën e pushimeve tatimore. Kufizime të tjera përfshijnë pasigurinë aktuale të lidhur me energjinë dhe pandeminë.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të përmirësojnë investimet vendore dhe të huaja përmes promovimit të parqeve industriale të cilat janë miqësore me mjedisin, duke përfshirë ofrimin e stimuljeve adekuat fiskalë dhe të tjerë të ngjashëm për investitorët strategjikë. Për të rritur iniciativat e investimeve, do të krijohet një agjenci e specializuar nën kujdesin e Zyrës së Kryeministrit.

Treguesit: Arritja e në-nobjektivit do të matet me dy tregues: (i) *përqindja e IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve (%)*; dhe (ii) *përqindja/pjesa e mallrave kapitale të importuara në VShP*.

5.2.2.3. Përshpejtimi i dixhitalizimit në prodhim

Dixhitalizimi i sektorit të prodhimit është një trend i rëndësishëm global në rritje, që nënkupton aplikimin e mjeteve dixhitale për rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit në menaxhim dhe prodhim, si dhe lëvizjen drejt automatizimit të drejtuar nga të dhënat.

Performanca aktuale: Niveli i dixhitalizimit të sektorit të prodhimit të Kosovës është shumë i ulët. Vetëm një e pesta e bizneseve të anketuara aplikojnë mjete dixhitale në proceset e prodhimit. Për më tepër, optimizimi i prodhimit është i pjesshëm për shkak të njohjes së kufizuar nga prodhuesit për mjetet që mund të përdorin, si p.sh. prodhimi i cili priret për të reduktuar mbeturinat dhe për të rritur efikasitetin.

Lidhja me objektivat e politikës: Dixhitalizimi i prodhimit është i lidhur me objektivin 1, pasi rritja e dixhitalizimit në prodhim mund të krijojë kushtet për përmirësimin e efikasitetit të prodhimit dhe nxitjen e optimizimit të procesit. Kjo nga ana tjetër mund t'i mbështesë prodhuesit kosovarë që të përmirësojnë cilësinë e produkteve, të prodhojnë produkte më të personalizuar dhe të bëhen më konkurrues, gjë që mund të rrisë prodhimin industrial.

Kufizimet themelore: Një prej arsyeve pse pranimi i dixhitalizimit është i kufizuar është për shkak të lidhjeve të pazhvilluara ndërmjet sektorit të TIK-ut të Kosovës dhe sektorëve të prodhimit. Zhvillimi i mjeteve dixhitale nga ofruesit e shërbimeve të TIK-ut i kushton vëmendje kryesisht tregjeve të huaja, për shkak të kërkesës së kufizuar të brendshme nga prodhuesit. Si kufizime të tjera janë ndërgjegjësimi i kufizuar i prodhuesve për përfitimet e dixhitalizimit; dhe ndërgjegjësim i kufizuar për efikasitetin e prodhimit dhe mjetet e optimizimit të procesit, të cilat nga ana tjetër mund të dixhitalizohen.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të stimulojnë transformimin dixhital nga prodhuesit, duke përfshirë bashkëpunimin ndërsektorial midis ofruesve të shërbimeve të TIK dhe prodhuesve.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) *përdorimi i mjeteve të dixhitalizimit në proceset e përgjithshme të prodhimit/punës në prodhim (%)*.

5.2.2.4. Rritja e cilësisë dhe certifikimit të produkteve të njohura ndërkombëtarisht

Për krijimin e besimit dhe kërkesës për produktet e prodhuara në Kosovë është e domosdoshme cilësia adekuatë e produktit. Në varësi të produktit, cilësia e produktit përfshin specifika të ndryshme si siguria, qëndrueshmëria ose pajtueshmëria me normat e përcaktuara të produktit dhe që mund të vërtetohet me një certifikatë përkatëse.

Performanca aktuale: Nuk ka të dhëna për numrin e produkteve të Kosovës që janë të certifikuar. Cilësia e produkteve vendore konsiderohet përgjithësisht si një çështje e rëndësishme, siç dëshmohet pjesërisht, nga paaftësia e prodhuesve vendor për të zëvendësuar nivelet e larta të importeve në një sërë produktesh. Është vlerësuar se vetëm 251 produkte industriale me vlerë të paktën 10 mijë euro janë eksportuar në BE – numër i ulët që përforcon më tej cilësinë e dobët të produktit dhe marrjen e kufizuar të certifikimit të produktit.

Lidhja me objektivat e politikës: Përmirësimi i cilësisë së produktit lidhet me objektivin 1, pasi rritja e besimit dhe përvoja pozitive me produktet e prodhimit vendor rrisin kërkesën e brendshme dhe rrjedhimisht, prodhimin industrial. Arritja e cilësisë së produktit përkatës është gjithashtu një parakusht për arritjen e certifikimeve ndërkombëtare, të cilat lidhen me objektivin 2. Për të rritur eksportet, nevojitet cilësi e mjaftueshme e produktit dhe certifikime ndërkombëtare.

Kufizimet themelore: Në përgjithësi, sektori i prodhimit ende mbështetet në teknologjinë e vjetëruar që ndikon në cilësinë e përgjithshme të produktit dhe konkurrencën e jashtme. Kontrollat e cilësisë së produktit në nivel ndërmarrjes kryesisht mungojnë, ndërsa mungesa e laboratorëve vendor të certifikuar për kontrollat e cilësisë së produktit ndikon negativisht edhe në konkurrencën e ndërmarrjeve. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës përgjegjëse për akreditim të laboratorëve dhe trupave certifikues nuk ka arritur të anëtarësohet në organet relevante të BE-së dhe mekanizmat e tjerë relevantë ndërkombëtarë shumëpalësh, duke ndikuar kështu në certifikimin e produkteve apo testimin e tyre në laboratorët testues.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të përmirësojnë qasjen në shërbimet e testimit dhe certifikimit të produkteve vendore dhe përmirësimin e miratimit të certifikatave përkatëse nga prodhuesit.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) *numrin e produkteve industriale të eksportuara në BE* (të paktën €10 mijë në vit).

5.2.3. Nën-objektivat sipas objektivit 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial

Që Kosova të zvogëlojë deficitin tregtar industrial, prodhuesit duhet: (i) të shfrytëzojnë më tej potencialin e tyre të eksportit; (ii) të diversifikojnë tregjet e eksportit; dhe (iii) të zëvendësojnë produktet e ndërmjetme dhe finale të importuara me prodhime vendore dhe të promovojnë më mirë produktet vendore.

Rritja e cilësisë së produktit dhe arritja e certifikimit ndërkombëtar si një nën-objektiv shtesë përkatës për reduktimin e deficitit tregtar industrial është diskutuar në objektivin 1.

5.2.3.1. Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit

Shfrytëzimi i potencialit të eksportit nënkupton që ndërmarrjet në Kosovë që kanë produkte ose posedojnë aftësi për të prodhuar produkte që janë konkurrese ndërkombëtarisht, duhet t'u mundësohet eksportimi apo qasja në tregun e shitjeve jashtë vendit.

Performanca aktuale: Konkurrenca e eksportit, e matur si eksporte të prodhuara për kokë banori, e bën Kosovën (221€/kokë banori) performuesin më të keq në mesin e vendeve të BP6 (1,500€/kokë banori). Në vitin 2021, vetëm 733 kompani prodhuese kosovare raportuan se

kanë eksportuar mbi 10 mijë euro. Një pjesë e rëndësishme e suksesit të eksportit është e lidhur me kërkesën e diasporës, ose me suksesin e fundit të një produkti kryesor eksporti (dyshekët) që ka zënë vend. Kërkesa e diasporës është e shpërndarë, duke gjeneruar kërkesë për porosi kryesisht porosi të vogla, që nga ana tjetër kushtëzon kapacitetet e furnizimit në Kosovë. Nëse prodhimi serik nuk paraqitet në industri të përzgjedhura, udhëheqëse, Kosova do të përballet me një kohë të vështirë për të zhvilluar lidhje të qëndrueshme dhe konkurruese të tregut të eksportit.

Lidhja me objektivat e politikës: Zgjerimi i eksporteve kontribuon drejtpërdrejt në uljen e deficitit tregtar industrial (objektivi 2). Rritja e eksporteve dhe rrjedhimisht rritja e kërkesës së huaj do të kontribuojë gjithashtu në objektivin 1 (zgjerimi i prodhimit industrial), si dhe mund të gjenerojë një vrull pozitiv për përmirësimin e cilësisë së produktit.

Lidhja me objektivat e politikës: Mungesa e anëtarësimit në organizatat kryesore ndërkombëtare, duke përfshirë Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), UNIDO dhe Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), minon integrimin tregtar ndërkombëtar të Kosovës. Prodhuesit kosovarë përballen gjithashtu me kosto më të larta se zakonisht të transportit, për shkak të detyrimit për t'u mbështetur në operatorët e shërbimeve të transportit të vendeve të treta, gjë që rrjedh nga mosmarrëveshjet politike me Serbinë. Në nivel ndërmarrje, kompanive u mungon intelijenca e tregut dhe kanalet e shitjes për të shitur produktet e tyre jashtë vendit. Përveç kësaj, mungesa e instrumenteve të përshtatura për financimin e eksportit dëmtojnë zgjerimin e prodhimit të prodhuesve kosovarë të orientuar drejt eksportit. Disponueshmëria e kufizuar e shërbimeve këshillimore për biznesin për të mbështetur ndërmarrjet me strategji eksporti dhe depërtim në tregjet e eksportit paraqet gjithashtu sfida në vete.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të përmirësojnë financimin për prodhuesit e orientuar nga eksporti, duke përfshirë zgjerimin e qasjes në shërbimet për intelijencën e tregut të eksportit dhe përshtatjen me blerësit e huaj.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) *numri i ndërmarrjeve prodhuese që eksportojnë rregullisht (të paktën 10 mijë euro në vit).*

5.2.3.2. Diversifikimi i tregjeve të eksportit

Eksportimi në një bazë më të madhe të tregjeve të jashtme rrit kërkesën e huaj për produktet e Kosovës dhe gjithashtu siguron zbutjen e goditjeve të mundshme nga luhatjet e tregtisë ndërkombëtare. Ndërsa nën-objektivi i parë në objektivin 2 fokusohet në zgjerimin e eksporteve në përgjithësi, duke përfshirë diversifikimin e produkteve të eksportit, ky nën-objektiv fokusohet në diversifikimin e tregjeve të eksportit.

Performanca aktuale: Deri më tani, eksportet e Kosovës janë të përqendruara në disa tregje të jashtme të zgjedhura. Një përqendrim relativisht i lartë është në vendet ku përfshihen; Shqipëria (22.8%), Zvicra (9.6%), Gjermania (9.5%), Maqedonia e Veriut (8.7%) dhe Italia (7%). Për më

tepër, 42% e eksporteve të Kosovës shkojnë në BP6, ndërsa 36% në BE. Për më tepër, përqendrimi i eksporteve lidhet pozitivisht me tregjet ku ka një prani të konsiderueshme të komunitetit të diasporës.

Lidhja me objektivat e politikës: Lëvizja drejt diversifikimit të tregut të eksporteve është kritike për të rritur kërkesën ndërkombëtare rrjedhimisht, për të rritur eksportet kumund të ndihmojë Kosovën të zvogëlojë deficitin e saj tregtar industrial (objektivi 2). Duke gjeneruar kërkesë më të lartë, diversifikimi i tregut të eksportit mund të kontribuojë gjithashtu në zgjerimin e kapaciteteve të ofertës (objektivi 1).

Kufizimet themelore: Fakti që Kosova ka nënshkruar një numër të kufizuar të marrëveshjeve tregtare shumëpalëshe dhe dypalëshe nënkupton që prodhuesit kosovarë mund të përballen me barriera të kushtueshme tarifore dhe jotarifore, nëse synojnë të diversifikojnë portofolin e tyre të tregut të eksportit. Çertifikimi i produkteve dhe standardet e cilësisë janë gjithashtu të kushtueshme, gjë që pengon prodhuesit kosovarë të zgjerohen në tregjet e eksportit. Përveç kësaj, lidhjet e bazuara në diasporë, të cilët mund të ofrojnë kanale të reja të shitjeve, janë të pashfrytëzuara.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të identifikojnë produkte potencialisht të eksportueshme, duke përfshirë mbështetjen e prodhuesve për të depërtuar në tregje të reja eksporti, përmes markave inovative dhe strategjive të tjera specifike të promovimit të eksportit, dhe ndjekjen e marrëveshjeve të reja tregtare përkatëse me fokus specifik.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) *diversiteti gjeografik i eksporteve (numri i vendeve që zënë 80% të eksporteve të prodhimit).*

5.2.3.3. Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me prodhime vendor dhe promovimin e produkteve vendore

Ky nën-objektiv synon uljen e importit të mallrave të prodhuara. Mallrat e ndërmjetme dhe përfundimtare të importuara, të cilat prodhuesit kosovarë janë në gjendje të prodhojnë, duhet të zëvendësohen gradualisht nga prodhimi vendor.

Performanca aktuale: Kosova mbetet një ekonomi me import të lartë. Çdo euro e eksporteve të prodhuara është e barabartë me 7 euro importe të prodhuara. Vlera e importit të mallrave të ndërmjetme, si pjesë/përqindje e VShP, është në masën marramendëse prej 180%. Ndërmjet viteve 2018-2020, përqindja e sektorëve vendor me potencial zëvendësues të importit në mallrat e ndërmjetme të importuara ishte mesatarisht 64%. Gjithashtu, për të njëjtën periudhë përqindja e sektorëve vendor me potencial zëvendësues të importit në mallrat e konsumit të

importuar ishte 67%. Mallrat vendore përbënin jo më shumë se 33% të tregut vendor. Në nivel të ndërmarrjes, ka vetëm disa shembuj ku prodhuesit kosovarë kanë arritur të kenë qasje në rrjetet e njohura të markave të huaja të shitjes me pakicë në Kosovë, apo ekskluzivitete të markave ndërkombëtare. Për më tepër, pak furnizues të prodhimit kosovar kanë qenë në gjendje të depërtojnë në zinxhirët e shitjes me pakicë që operojnë në vend nën "etiketën private".

Lidhja me objektivat e politikës: Zëvendësimi i mallrave të ndërmjetme dhe përfundimtare nga prodhimi vendor mund të shfrytëzohet me sukses, pasi ka potenciale të konsiderueshme vendore të pashfrytëzuara. Një rol më i spikatur për prodhuesit vendor mund të kontribuojë drejtpërdrejt në uljen e importeve (objektivi 2) dhe zgjerimin e prodhimit industrial (objektivi 1). Zëvendësimi i importeve përmes zgjerimit të prodhimit vendor mund të krijojë edhe efekte pozitive të zinxhirit të vlerës së brendshme në Kosovë (objektivi 5).

Kufizimet themelore: Fakti që jo më shumë se 33% e tregut vendor mbulohet nga mallra të prodhuara në vend, është tregues i cilësisë së produktit dhe konkurrencës së kufizuar. Këmbëngulja e kompanive me madhësi mikro i pengon kompanitë vendore të dalin nga aktivitetet e tyre me vlerë të ulët të shtuar dhe të konkurrojnë me flukse të mëdha importesh. Ekziston gjithashtu një mungesë e analizës strategjike që krahason se cilat produkte të importuara në masë të madhe mund të zëvendësojë Kosova në mënyrë efektive bazuar në avantazhet ekzistuese konkurruese. Prodhuesit vendor gjithashtu mbështeten shumë në burimet e veta për të financuar zgjerimin e tyre, kështu që instrumentet e kufizuara formale të financimit për të mundësuar qasjen në treg, paraqesin gjithashtu sfida. Prodhimi i ndërmjetëm pengohet gjithashtu nga mungesa e certifikatave dhe standardeve të cilësisë, që parandalojnë që produktet vendore të përdoren nga zinxhirët e njohur të shitjes me pakicë dhe ekskluzivitetet e markave nën mekanizmat e "etiketës private". Në një nivel më makro, regjimi liberal ndaj importeve shpesh krijon një fushë loje të anuar, duke minuar shfaqjen e një potenciali konkurrues të brendshëm.

Veprimet e politikave: Veprimet e politikave synojnë të stimulojnë prodhimin e mallrave vendore që mund të zëvendësojnë importet, përmes rritjes së kërkesës së brendshme nëpërmjet prokurimit publik dhe fushatave ndërgjegjësuere, si dhe rregullimit të regjimit tregtar për të barazuar kushtet e lojës për produktet vendore.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me tre tregues: (i) *pjesa e importeve të mallrave të ndërmjetme të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve*; (ii) *pjesa e importeve të mallrave të konsumit të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve* dhe (iii) *përqindja e mallrave vendore në tregun e prodhimit*.

5.2.4. Nën-objektivat sipas objektivit 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës

Që Kosova të gjeneroj punësim më të mirë dhe gjithëpërfshirës në prodhimtari, duhet të arrihen ndryshimet e mëposhtme: (i) fuqia punëtore teknike dhe menaxherët e kompanive duhet të jenë të kualifikuar dhe të certifikuar në mënyrë adekuate; (ii) duhet të promovohet krijimi i vendeve

të denja të punës në industri; dhe (iii) gratë dhe të rinjtë duhet të integrohen më mirë në tregun e punës.

Efektet shtesë të punësimit jashtë sektorit të prodhimit mund të priten nëpërmjet nën-objektivit që fokusohet në forcimin e lidhjeve me ofruesit e shërbimeve të lidhura me industrinë dhe nën-objektivit që kërkon të rrisë inputet e brendshme në prodhim nga bujqësia, pylltaria dhe minierat (të dyjat janë dhënë nën objektivin 5 më poshtë).

5.2.4.1. Ngritja e kualifikimit dhe certifikimit të fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të kompanive

Fuqia punëtore e kualifikuar është një faktor kyç i prodhimit dhe është kritik për të prodhuar mallra që mund të konkurrojnë në bazë të çmimit, cilësisë dhe inovacionit. Në të njëjtën kohë, rritja e bizneseve varet edhe nga menaxherët profesionistë, të cilët mund t'i udhëheqin kompanitë nëpër faza të ndryshme të ciklit të tyre të rritjes.

Performanca aktuale: Tregu i punës i Kosovës karakterizohet nga një mospërputhje të ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore të kualifikuar. Sistemi i arsimit formal mbetet i pamjaftueshëm për të përgatitur punëtorët sipas nevojave të industrisë. Deri në vitin 2021 Kosova arriti të akreditojë 11 ofrues të trajnimit profesional në sektorin e prodhimit. Kjo plotësohet me faktin se ekzistojnë 24 standarde të aprovuara të profesionit në sektorin e prodhimit. Sidoqoftë, përqindja e punonjësve që regjistroheshin në trajnime formale në prodhim ishte vetëm 26.4% në 2019 (krahasuar me 53.6% për vendet me të ardhura të mesme të larta). Përqindja e punëtorëve të kualifikuar nga të gjithë punëtorët e prodhimit ishte 67.3% në 2019 (kundrejt 73.3% për vendet me të ardhura të mesme të larta). Përkundër mungesës së të dhënave në dispozicion, në përgjithësi është e ditur se, kompanitë rriten në kompleks, ato kërkojnë më shumë menaxherë profesionistë të kompanive, oferta e të cilëve në Kosovë është e kufizuar. Janë të pakta, nëse ka, shkolla ose ofrues arsimor të themeluar nga biznesi që lidhen ngushtë me zërat e industrisë për të ofruar trajnime përkatëse profesionale.

Lidhja me objektivat e politikës: Një fuqi punëtore dhe formalisht e kualifikuar ka më shumë mundësi për të fituar punë të denjë me paga më të larta, kushte më të mira pune dhe kontrata pune më të qëndrueshme. Sidomos, duke pasur parasysh mospërputhjen e ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore të kualifikuar, kualifikimet më të larta janë një mjet jetik për të krijuar më shumë vende pune dhe më të mira (objektivi 3). Një faktor thelbësor për të zgjeruar prodhimin, për të inovuar dhe për të siguruar cilësinë e produktit (objektivi 1) është gjithashtu një fuqi punëtore e kualifikuar.

Kufizimet themelore: Mospërputhjet e aftësive të cilat rrjedhin nga programet arsimore të papërshtatshme ndikojnë fuqishëm në rezultatet e punës. Një numër programesh të nivelit universitar konsiderohen të vjetruara për të qenë të rëndësishme për nevojat e një sektori prodhimi në rritje. Kufizimet e kapaciteteve të institucioneve si Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, ngadalësojnë ritmin e miratimit të standardeve të reja të profesionit në lidhje

me prodhimin. Shkollat profesionale në bashkëpunim me bizneset ende nuk e kanë integruar mësimin e bazuar në punë. Ndërkohë, ka një tendencë pozitive të ofruesve të rinj privatë të aftësimit profesional joformal që marrin akreditim dhe ofrojnë grupe më të përshtatshme aftësish. Megjithatë, ato janë të kufizuara në numër dhe disave prej tyre u mungojnë burimet.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të adresojnë boshllëkun mbizotërues të aftësive në sektorin e prodhimit përmes adresimit të mungesës së informacionit dhe krijimit të stimuljeve financiarë për fuqinë punëtore për të fituar trajnime përkatëse.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me katër tregues: (i) *numrin e institucioneve të akredituara të trajnimit në prodhim*; (ii) *numrin e standardeve të miratuara të profesionit në prodhim*; (iii) *përqindjen e punëtorëve që marrin trajnim formal në prodhim (%)*; dhe (iv) *numrin e certifikatave ISO*.

5.2.4.2. Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri

Krijimi i vendeve të punës në prodhim është një komponent i rëndësishëm i objektivit. Krijimi i vendeve të denja të punës është po aq i rëndësishëm për të siguruar që prodhuesit të paguajnë të ardhura të drejta, të sigurojnë punësim të sigurt dhe të përmirësojnë kushtet e përgjithshme të punës.

Performanca aktuale: Në përgjithësi, industritë në Kosovë kanë dështuar të krijojnë punësim të denjë. Pavarësisht se pjesa e VShP-së që u ka shkuar punëtorëve në formën e pagave është rritur nga 21% në 35%, varfëria në punë në procesin e prodhimit mbetet e lartë. Ndërsa në përgjithësi në ekonomi, varfëria në punë në Kosovë është 15%, ajo është edhe më e lartë në sektorin e prodhimit (26.6%). Ndërkohë, Banka Botërore vlerëson se 35% e punonjësve punojnë pa kontrata apo informal. Një e katërta e punëtorëve të prodhimit (25%) nuk ishin deklaruar zyrtarisht në autoritetin kombëtar të taksave. Informaliteti minon kontraktimin formal dhe mbrojtjen e ofruar për punëtorët nga ligji i punës. Siguria në punë është një sfidë e madhe: kushtet e punës për punëtorët mbrenda ndërmarrjes konsiderohen përgjithësisht të këqija dhe të papërshtatshme.

Lidhja me objektivat e politikës: Industritë kanë potencial për të krijuar shumë vende të reja pune. Megjithatë, ato nuk janë automatikisht punë formale, të mira dhe të mirëpaguara. Të kesh një nën-objektiv që promovon punësim më të qëndrueshëm, paga të drejta dhe kushte të mira pune është kritike për të arritur objektivin 3.

Kufizimet themelore: Një kufizim kryesor që minon krijimin e vendeve të denja të punës lidhet me informalitetin e dukshëm të punës në prodhim, me një të katërtën e punonjësve të sektorit të padeklaruar. Kjo kontribuon në kontraktimet informale dhe vazhdimësinë e kushteve të papërshtatshme të punës, e cila nga ana tjetër rrit mundësinë e aksidenteve në punë (vlerësuar në 49 raste në sektor në vitin 2021). Për më tepër, paga e ulët është një kufizim kyç që parandalon krijimin e vendeve të denja të punës, siç vërtetohet nga fakti se varfëria në punë në

procesin e prodhimit ishte 26.6% - mbi 10 pikë më e lartë se shkalla kombëtare e varfërisë në punë. Pagat e ulëta mund të shpjegohen pjesërisht nga përfitimet e kufizuara të produktivitetit të sektorit për shkak të adoptimit të kufizuar të teknologjisë, fuqisë punëtore me aftësi të ulëta dhe transferimit të kufizuar të njohurive përmes IHD-ve.

Veprimet e politikave: Veprimet e planifikuara synojnë të reduktojnë informalitetin e punës duke kuptuar më mirë përhapjen e tij sipas sektorëve, duke nxitur kompanitë prodhuese të aplikojnë paga të mira dhe të ofrojnë kushte më të mira pune.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me tre indikatorë: (i) *punëtorët e prodhimit të deklaruar në ATK/punësimin zyrtar në prodhimtari*; (ii) *varfërinë në punë në procesin e prodhimit*; dhe (iii) *numrin e aksidenteve në punë në procesin e prodhimit*.

5.2.4.3. Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës

Punësimi në industri duhet të bëhet në mënyrë që të arrihet punësim më i gjerë dhe gjithëpërfshirës, i cili krijon përfitime për të gjithë shoqërinë. Gratë dhe të rinjtë, si dhe grupe të tjera të pafavorizuara, në veçanti, duhet të integrohen më mirë në tregun e punës së prodhimit në Kosovë.

Performanca aktuale: Përfshirja e grave dhe të rinjve nga tregu i punës është veçanërisht i theksuar në Kosovë. Çdo i dyti i ri i moshës 15-19 vjeç mbetet pa punë për më shumë se një vit – një recetë/mjet për thellimin e papunësisë strukturore. Analiza e performancës industriale zbuloi se pjesa e grave në punësimin në prodhim është njësoj e ulët për Kosovën në krahasim me vendet krahasuese: megjithëse përqindja e grave u rrit nga viti 2015 (10%) në vitin 2020 (16%), ajo mbeti shumë nën mesataren e BP6 prej 37% në vitin 2020, me Shqipërinë që ia kalon rajonit me një përqindje gati 60%, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me një përqindje gati 50%.

Lidhja me objektivat e politikës: Përmirësimi i përfshirjes së grave dhe të rinjve në tregun e punës është kyç për arritjen e objektivit 3. Në të njëjtën kohë, Kosova humb gjithashtu potencialin intelektual dhe krijues që gratë dhe të rinjtë mund të sjellin në këtë sektor. Nxitja e integritetit të tyre mund të kontribuojë gjithashtu në objektivin 1 të rritjes së sektorit industrial.

Kufizimet themelore: Raporti i Bankës Botërore për Diagnostifikimin e Punës (2017) identifikon "përgjegjësinë familjare" si një faktor kritik që dëmton pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore: mbi gjysma e grave joaktive raportuan se kishin përgjegjësi familjare për të mos kërkuar në mënyrë aktive një punë. Disponueshmëria e kufizuar e kujdesit për fëmijët gjithashtu nxit pasivitetin e fuqisë punëtore tek gratë: Anketa Jeta në Tranzicion zbuloi se kujdesi për fëmijët nën 6 vjeç ofrohet nga anëtarët e familjes në 95% të rasteve. Shërbimet e kujdesit për fëmijët ofrohen kryesisht mbi baza joformale, me vetëm një të katërtën e qendrave të kujdesit për fëmijët, funksionojnë gjatë verës, ndërsa kujdesi institucional për fëmijët është i kufizuar për gratë rurale duke pasur parasysh kostot jashtëzakonisht të larta të transportit. Për

më tepër, zgjatja 9-mujore e përfitimeve të lehonisë ndikon negativisht edhe në pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, e konsideruar nga bizneset si një pengesë për punësimin e grave. Gjithashtu, promovimi i kufizuar i profesioneve prodhuese në shkolla formon perceptimin e të rinjve për zgjedhjet e tyre të karrierës. Ekziston gjithashtu një stigmë domethënëse e përfshirjes së grave në punët e prodhimit (e demonstruar nga më pak se 10% e grave të punësuar që punojnë në prodhim), megjithëse disa industri përfshijnë gratë në mënyrë të konsiderueshme.

Veprimet e politikave: Është përtej fushëveprimit të politikës për të trajtuar shkaqet strukturore për pjesëmarrjen e ulët të grave në tregun e punës. Veprimet e politikave synojnë të përmirësojnë situatën duke ofruar stimuj për aftësitë e grave dhe të rinjve në kompani, duke përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit midis shkollave dhe bizneseve për të kapërcyer boshllëqet e perceptimit mbizotërues për punën në prodhim.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me dy tregues: (i) *përqindjen e të rinjve të punësuar në prodhim në punësimin total të të rinjve*; dhe (ii) *përqindjen e grave punësimin e prodhimit*.

5.2.5. Nën-objektivat sipas objektivit 4: Lehtësimi i industrisë së gjelbër

Që Kosova të nis transformimin drejt krijimit të një industrie të gjelbër, kompanitë prodhuese duhet: (i) të rrisin riciklimin dhe cirkulimin në proceset e tyre të prodhimit; (ii) të prodhojnë produkte të gjelbra; dhe (iii) të përmirësohen me teknologji me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve.

5.2.5.1. Mbështetje për ndërmarrjet për të rritur riciklimin dhe cirkularitetin në prodhim

Cirkulariteti është një qasje sistematike që promovon ndryshimin nga modelet lineare të prodhimit dhe konsumit drejt atyre më cirkulare dhe të qëndrueshme. Ai përfshin tre parime kryesore: (i) eliminimin e mbetjeve dhe ndotjes, (ii) cirkularitetin e produkteve dhe materialeve duke i rifutur ato në ciklin e prodhimit dhe (iii) rigjenerimin e natyrës. Rritja e riciklimit dhe cirkularitetit në proceset e prodhimit është thelbësore për t'i mundësuar sektorit të prodhimit të Kosovës që të maksimizojë efikasitetin në përdorimin e burimeve, të zvogëlojë ndikimet negative mjedisore dhe të zvogëlojë kostot duke siguruar që mbeturinat e rikuperuara të rifuten në prodhim.

Performanca aktuale: Kosova është në një fazë fillestare të aplikimit sistematik të riciklimit dhe cirkulimit në prodhim. Vlera e Shtuar Bruto në sektorë, bazuar në qarkullimin ekonomik është vetëm 0.8% e BPV-së. Nuk ka të dhëna për përqindjen e materialit të ricikluar të përdorur në prodhim. Ekziston një vetëdije e kufizuar për riciklimin dhe cirkulimin në ekonominë e Kosovës. Megjithatë, vetë zinxhiri i vlerës së riciklimit duket se po zgjerohet dhe po gjeneron vlerë ekonomike në rritje. Kompanitë kosovare kryesisht riciklojnë letër, metale, bateri, kanaçe, lëndë organike, gomë dhe plastikë. Ka disa kompani të riciklimit të mbeturinave që riciklojnë mbeturinat në produkte të tregtueshme, disa prej të cilave po eksportohen. Bazuar në të dhënat e ASK-së, janë 175 kompani aktive të angazhuara në zinxhirin e vlerës së riciklimit,

ku përfshihet tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve (22%), grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme (19%), grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme (18%), prodhimi i plastikës në formë parësore (15%), trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme (11%), aktivitetet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave (7%), çmontimi i hekurishteve (6%) dhe trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme (1%).

Lidhja me objektivat e politikës: Rritja e nivelit të riciklimit dhe cirkulimit në sektorin e prodhimit do të reduktojë ndjeshëm inputet e materialit parësor në prodhim dhe do të reduktojë mbeturinat, duke e bërë këtë, do të kontribuojë në krijimin e një industrie të gjelbër dhe rrethore/cirkulare (objektivi 4).

Kufizimet themelore: Ekziston një mungesë e përgjithshme e ndërgjegjësimit midis biznesit, institucioneve publike dhe sektorit të ekonomive familjare për përfitimet e cirkularitetit të materialit dhe produktit. Po ashtu, ekziston një numër i pamjaftueshëm të deponive të ligjshme që bëjnë klasifikimin e mbeturinave. Për më tepër, ka grumbullues joformal të burimeve që angazhohen në grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme në Kosovë, gjë që mund të dëmtojë krijimin e një sektori formal të riciklimit.

Veprimet e politikave: Pasi Kosova është në një fazë shumë fillestare, veprimet kryesore që do të ndiqen nga kjo politikë përfshijnë (i) përmirësimin e ndërgjegjësimit të përgjithshëm midis prodhuesve dhe palëve të tjera të interesit mbi përfitimet e cirkularitetit dhe (ii) krijimi i një tregu të mbetjeve industriale. Ngakrijimi i transparencës për llojin dhe vëllimin e mbetjeve industriale të gjeneruara nga kompanitë, të cilat mund të përdoren si inpute për prodhime të tjera, mund të inicohet krijimi i simbiozave industriale dhe në këtë mënyrë, cirkulariteti i materialit ndërsektorial.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me dy tregues: (i) *vlerën e shtuar bruto në sektorët që lidhen me ekonominë rrethore (% e BPV-së totale)*; dhe (ii) *përdorimin e materialit të ricikluar (%)*.

5.2.5.2. Mbështetja e prodhimit dhe konsumit të produkteve me karbon të ulët dhe të gjelbra

Ekziston një tranzicion i drejtpërdrejtë global në industri, drejt prodhimit dhe konsumit të mallrave të gjelbërta me karbon të ulët dhe eko-miqësore. Krijimi i një industrie të gjelbër përfshin ofrimin e mallrave dhe shërbimeve që reduktojnë më drejtpërdrejt degradimin e mjedisit, shpërndajnë substanca toksike dhe/ose prodhohen në një proces prodhimi neutral ndaj CO₂.

Performanca aktuale: Ndërgjegjësimi në sektorin e prodhimit të Kosovës për produktet e gjelbra është shumë i kufizuar. Nuk ka të dhëna për shkallën në të cilën produktet e prodhuara janë miqësore me mjedisin, dhe as nuk ka të dhëna për tendencat e konsumit vendor drejt produkteve të gjelbra. Që nga viti 2016, nisma e Festivalit të Gjelbër të Kosovës ka kërkuar të promovojë produktet e gjelbra, përdorimin e teknologjive të gjelbra, rritjen e ripërdorimit të

qëndrueshëm të mbeturinave dhe zhvillimin e lidhjeve të tregut ndërmjet bizneseve të gjelbra dhe prodhuesve të tjerë. Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë synon të rrisë ndërgjegjësimin e politikëbërësve dhe pjesëmarrësve të tjerë për trendet e ekonomisë së gjelbër, ndër të cilat ekonomia rrethore dhe prodhimi i gjelbër shkojnë drejt dekarbonizimit.

Lidhja me objektivat e politikës: Krijimi i një industrie të gjelbër dhe cirkulare (objektivi 4) varet drejtpërdrejt nga shkalla në të cilën kompanitë janë të afta të prodhojnë produkte që janë në përputhje me ruajtjen e mjedisit. Duke pasur parasysh rritjen e kërkesës globale për produkte të gjelbra, prodhimi i tyre në Kosovë do të rrisë gjithashtu mundësitë e vendit për eksport. Kjo bëhet veçanërisht e rëndësishme për eksportin në BE dhe tregje të tjera që vendosin gjithnjë e më shumë barrierë tregtare për produktet me intensitet të CO₂ (objektivi 2). Fokusi në produktet e gjelbra që zakonisht shkon së bashku me shtimin e vlerës më të lartë do të kontribuojë gjithashtu në maksimizimin e përfitimeve të brendshme (objektivi 5).

Kufizimet themelore: Ndërgjegjësimi i konsumatorëve në Kosovë për produktet e gjelbra konsiderohet shumë i kufizuar. Stimujt e prodhimit të gjelbër janë shumë të kufizuara, me përjashtim të disa aktiviteteve të mbështetura nga donatorët. Kufizimet rregullatore dhe pengesat për përdorimin e energjisë diellore dhe kapaciteteve të tjera të energjisë së pastër nga kompanitë, gjithashtu demotivojnë prodhuesit për t'u mbështetur në burimet e rinovueshme për reduktimin e shpenzimeve të tyre të energjisë. Gjithashtu, nuk ka asnjë klasifikim të aktiviteteve të gjelbra dhe duhet të përmirësohet kuadri rregullator modern për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për prodhimin dhe konsumimin e produkteve të gjelbra.

Veprimet e politikave: Veprimet kryesore të planifikuara përfshijnë (i) heqja e barrierave rregullatore që pengojnë instalimin e kapaciteteve të prodhimit të energjisë së pastër nga kompanitë, (ii) krijimi i më shumë transparencës mbi gjurmimin e CO₂ të kompanive, (iii) miratimi i një klasifikimi të produkteve dhe shërbimeve të gjelbra, (iv) ndryshimet rregullatore, veçanërisht për të lejuar prokurimin e produkteve dhe shërbimeve të gjelbra, dhe (v) rritjen e ndërgjegjësimit për promovimin e prodhimit dhe konsumit të mallrave të gjelbërta

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me dy tregues: (i) *përqindjen e tregut nga produktet miqësore për mjedisin*; dhe (ii) *përqindjen e qytetarëve që shpesh blejnë produkte miqësore me mjedisin*.

5.2.5.3. Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve

Përmirësimi teknologjik nënkupton procesin e rritjes së aftësive teknologjike të ndërmarrjeve për të modernizuar metodat e prodhimit. Mbështetja e prodhuesve në Kosovë në përmirësimin e teknologjisë së tyre do të vendosë në theks të veçantë rritjen e efikasitetit energjetik dhe materialit të prodhimit.

Performanca aktuale: Të dhënat e Bankës Botërore tregojnë se investimi në asetet fikse që përfshijnë makineri dhe pajisje, si dhe infrastrukturën publike si autostrada, është 30% e BPV-

së, dhe është katër pikë më e lartë se mesatarja e BP6. Megjithatë nuk është në dispozicion asnjë ndarje/zbërthim për të vlerësuar shkallën në të cilën një investim i tillë, i kapur nëpërmjet formimit bruto të kapitalit fiks, drejtohet kryesisht nga investimet në makineri, ka tendenca të dukshme të rritjes së blerjeve teknologjike nga sektori i prodhimit. Megjithatë, adoptimi i teknologjive të reja eko-miqësore në prodhim është ende në një fazë fillestare në Kosovë.

Lidhja me objektivat e politikës: Përmirësimi teknologjik është kyç për zgjerimin e prodhimit industrial, pasi rrit produktivitetin dhe konkurrencën, ndër të tjera, duke ulur kostot, duke rritur cilësinë dhe duke lejuar prodhim serik dhe/ose më të personalizuar (objektivi 1). Përparimi i përshtatjes së teknologjive më miqësore me mjedisin, siguron minimizimin e përdorimit të energjisë, zvogëlimin e CO2 dhe emetimeve të tjera, si dhe redukton mbeturinat, duke e bërë këtë, kontribuon në objektivin 4 të krijimit të një industrie të gjelbër.

Kufizimet themelore: Një pengesë për adaptimin e makinerive të avancuara është mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar që kërkohet për të operuar. Stimujt rregullatorë dhe politikë janë të kufizuar në lidhje me dispozitat për përdorimin e energjisë së rinovueshme përmes makinerive të reja. Si rrjedhojë, pajisjet e vjetruara ende dominojnë një pjesë të konsiderueshme të sektorit të prodhimit. Mungesa e kapaciteteve për mirëmbajtjen e makinerive paraqet gjithashtu sfida për adoptimin e pajisjeve të reja miqësore me mjedisin. Përmirësimi teknologjik kërkon investime të mëdha. Kosovës i mungojnë produktet financiare të përshtatura për nxitjen e sektorit të prodhimit.

Veprimet e politikave: Veprimet kryesore përfshijnë promovimin e investimeve në teknologjitë e gjelbra dhe efikase duke përmirësuar qasjen në financat e bazuara në borxhe dhe forma të tjera të mbështetjes financiare.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: *intensitetin e energjisë në prodhim (Toe/€M).*

5.2.6. Nën-objektivat sipas objektivit 5: Maksimizimi i rritjes së vlerës së brendshme

Qëllimi kryesor i këtij objektivi është sigurimi i cilësisë së rritjes industriale, para së gjithash, duke forcuar shtimin e vlerës së brendshme. Për të maksimizuar shtimin e vlerës së brendshme, Politika Industriale synon: (i) të rrisë përqindjen e inputeve vendore në prodhim; (ii) të përmirësojë inovacionin e produktit drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar; dhe (iii) të forcojë lidhjet me ofruesit e shërbimeve vendore të lidhura me industrinë.

Nën-objektivi i fokusuar në inovacionin e produktit drejt produkteve me vlerë të shtuar më të lartë i diskutuar në objektivin 1 gjithashtu kontribuon në shtimin e vlerës së brendshme më të lartë në vend.

5.2.6.1. Rritja e përqindjes së inputeve vendore në prodhim

Kosova ka burime të konsiderueshme vendore por përdorimi i tyre si inpute në prodhim konsiderohet i kufizuar. Kjo vlen edhe për: (i) prodhimin vendor, ku importohen inputet parësore në vend të burimeve vendore; dhe (ii) burimet e brendshme që nuk janë shfrytëzuar fare ose janë duke u eksportuar në formë të papërpunuar ose të përpunuar minimalisht dhe, për rrjedhojë, me vlerë shtesë të kufizuar.

Performanca aktuale: Kosova ka depozita të konsiderueshme minerale të shfrytëzueshme, duke përfshirë rezervat e thëngjillit të linjtit, mineralet e ndryshme metalike dhe mineralet jometalike, por pjesë të mëdha të burimeve të tilla mbeten koti, të pashfrytëzuara dhe pamjaftueshëm të eksploruara. Edhe mineralet e nxjerra i nënshtrohen pak përpunimit lokal, ku shumica e mineraleve të tilla eksportohen në formë të papërpunuar. Pavarësisht se toka e punueshme përbën 43% të tokës bujqësore të shfrytëzuar, Kosova vazhdon të mbështetet shumë në importet e produkteve bujqësore. Në mënyrë të ngjashme, pyjet e Kosovës shtrihen në mbi 481,000 ha, 44.7% e sipërfaqes totale të tokës. Mbulimi pyjor në Kosovë është më i lartë se në pjesën tjetër të BP6. Pavarësisht nga stoku i disponueshëm i drurit vendor, sektori tashmë në rritje dhe konkurrues për eksportin e përpunimit të drurit për të plotësuar nevojat e veta mbështetet kryesisht në drurin e importuar, kryesisht nga Austria.

Lidhja me objektivat e politikës: Zgjerimi i përdorimit të inputeve të brendshme është thelbësor për të siguruar forcimin e shtimit të vlerës së brendshme (objektivi 5). Kjo vlen në veçanti për prodhimin, ku Kosova posedon burime vendore, por inputet janë duke u importuar në masë të konsiderueshme (d.m.th. druri për industrinë e përpunimit të drurit). Gjithashtu, shfrytëzimi i burimeve të pashfrytëzuara (d.m.th., prodhimet bujqësore për industrinë e përpunimit ushqimor) dhe përpunimi i tyre në produkte finale, si dhe nxitja e përpunimit të mëtejshëm të mallrave të eksportuara të papërpunuara ose të përpunuara minimalisht (d.m.th., industria metalike) do të kontribuojë në këtë objektiv. Duke forcuar lidhjet e tilla të fundme të prodhimit të Kosovës me sektorin e minierave, pylltarisë dhe bujqësisë, mund të krijohen efekte pozitive. Përdorimi i inputeve vendore mund të zvogëlojë gjithashtu nevojën për importe me furnizime të inputeve të papërpunuara dhe mallrave të ndërmjetme nga jashtë, duke kontribuar kështu në zvogëlimin e deficitit tregtar (industrial) (objektivi 2).

Kufizimet themelore: Përdorimi i kufizuar i inputeve vendore lidhet pjesërisht me mungesën e teknologjisë së avancuar në nxjerrjen e burimeve. Mungojnë edhe investimet e huaja në industrinë nxjerrëse. Shfrytëzimi i kufizuar i burimeve vendore ndikohet gjithashtu nga stimujt e papërshtatshëm të politikës bujqësore drejt konsolidimit të tokës (afërsisht 60% e të gjitha fermave kanë më pak se 5 ha sipërfaqe bujqësore të shfrytëzuar) dhe reforma e tokës për të mbështetur rritjen e industrisë së përpunimit të ushqimit. Politikat e lidhura me mjedisin, së bashku me politikat e kufizuara të trajtimit të drurit, parandalojnë përdorimin e drurit të papërpunuar vendor nga përpunuesit e mobiljeve. Për më tepër, për të eksportuar, prodhuesit kosovarë duhet të sigurojnë që produktet e tyre të prodhuara të mobiljeve, bazohen në lëndë drusore me burim të përgjegjshëm, por meqenëse pyjet e Kosovës nuk kanë certifikimin e kërkuar, ose politikat vendore të menaxhimit të pyjeve janë në fuqi duke deklaruar zona të

mëdha si të mbrojtura, kjo nxit mbështetjen në dru të importuar dhe të certifikuar. Sa i përket përpunimit të metaleve, çështjet politike që lidhen me shfrytëzimin e resurseve minerale në sektorin e minierave të Kosovës veriore, duke përfshirë mosinvestimin kronik në kompleksin minierar, gjithashtu e ndërlikojnë mbështetjen në inputet vendore, ose kontribuojnë në shtimin e kufizuar të vlerës së brendshme.

Veprimet e politikave: Veprimet kryesore përfshijnë ndryshime rregullatore dhe nisma bashkëpunimi për të krijuar kushte dhe mundësi për përdorim më të madh, por të qëndrueshëm të burimeve lokale.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) *vlerën e importit të produkteve të ndërmjetme (klasifikimi BEC) si pjesë e VShP.*

5.2.6.2. Përmirësimi i inovacionit të produktit drejt prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar

Produktet me vlerë të lartë të shtuar janë produkte vlera e të cilave përcaktohet më pak nga kostot e inputeve të tyre dhe më shumë nga procesi i prodhimit që shton vlerën e këtyre produkteve. Prodhimi i mallrave të prodhuara më të tregtueshme dhe në veçanti kalimi në produkte me vlerë më të lartë të shtuar do të përmirësojë shtimin e vlerës së brendshme të Kosovës. Inovacioni i produktit është një nga shtytësit kryesorë të këtij transformimi të dëshiruar.

Performanca aktuale: Kosova ka ngecur në aktivitete me vlerë të ulët të shtuar. Përderisa gati gjysma e totalit të eksporteve në BE konsiderohen me intensitet të mesëm dhe të lartë teknologjik (MHT), Kosova ka një nivel të ulët të sofistikimit të eksporteve, ku vetëm plastika dhe goma (që përbëjnë 11% të totalit të eksporteve gjatë 2016-2019) janë disi më të avancuara teknologjikisht. Inovacioni i kufizuar (i produktit) ndikohet nga forca më të mëdha: Banka Botërore vlerëson se shpenzimet publike për Kërkim dhe Zhvillim përbëjnë vetëm 0.1%. Tendencat e dobëta në inovacionin e produkteve reflektojnë gjithashtu platforma të kufizuara bashkëpunimi midis sektorit privat, universiteteve, ofruesve të shërbimeve të specializuara dhe qeverisë. Si rezultat, në vitin 2019 vetëm 27% e kompanive kosovare kanë deklaruar se kanë prezantuar një produkt apo shërbim të ri.

Lidhja me objektivat e politikës: Inovacioni i produktit drejt produkteve me vlerë më të lartë të shtuar është çelësi për rritjen e sektorit industrial. Nën-objektivi është i lidhur edhe me objektivin 2, pasi produktet e reja do të ndihmojnë në zgjerimin e eksportit dhe rritjen e konkurrencës. Produktet e gjelbra, miqësore me mjedisin priren të kenë vlerë shtesë më të lartë, gjë që mund të çojë përpara objektivin 4 të një industrie të gjelbër si dhe të përmirësojë përfitimet vendore (objektivi 5).

Kufizimet themelore: Kufizimet kryesore përfshijnë shpenzimet e kufizuara publike në Kërkim dhe Zhvillim (0.1% e totalit të shpenzimeve publike vjetore), ndërsa, siç u përmend, vetëm

27% e kompanive deklaruan se kanë prezantuar një produkt ose shërbim të ri. Mungojnë gjithashtu programet e inovacionit të produkteve në sektorët e arsimit formal dhe joformal. Pjesë e sfidës është mungesa e platformave të bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat, akademisë dhe qeverisë. Gjithashtu nuk ka entitete të dedikuara të angazhuara në kërkim dhe zhvillim. Investimi i biznesit në inovacionin e produktit konsiderohet shumë i kufizuar.

Veprimet e politikave: Veprimet kryesore përfshijnë ofrimin e stimujve fiskalë dhe financiarë, si dhe njohjen e prodhuesve për t'u angazhuar në inovacion, duke përfshirë mbështetjen e platformave bashkëpunuese për inovacionin e produkteve që përfshijnë bizneset, akademinë dhe sektorin publik.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: *përqindjen (%) e ndërmarrjeve që kanë prezantuar një produkt/shërbim të ri.*

5.2.6.3. Forcimi i lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendase të lidhura me industrinë

Sektori i prodhimit kërkon shërbime të ndryshme në procesin e prodhimit, duke filluar nga dizajni i produktit, mirëmbajtja e makinerive, marketingu, transporti, këshillimi ligjor, apo transporti, për të mbështetur transformimin dixhital dhe të gjelbër të procesit të prodhimit. Forcimi i këtyre lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendore mund të ketë efekte të shumta pozitive punësimi dhe shtimit të vlerës së brendshme përtej sektorit të prodhimit.

Performanca aktuale: Aktualisht, për mirëmbajtjen e makinerive të saj Kosova mbështetet shumë tek teknikët dhe ofruesit e shërbimeve nga jashtë. Edhe furnizuesit vendas të makinerive të huaja kanë kapacitete të kufizuara për mirëmbajtjen e makinerive. Kjo është arsyeja pse gjendja e makinerive në Kosovë është subjekt i prishjeve të vazhdueshme dhe riparimeve të kushtueshme. Kosova gjithashtu nuk ka ofrues shërbimesh që mund t'i ndihmojnë prodhuesit për të optimizuar proceset e brendshme (të njohura si prodhim mbështetës). Kjo shkakton shumë joefikasitet operacional dhe humbje. Për më tepër, megjithëse ofruesit e shërbimeve të TIK ofrojnë zgjidhje dixhitale për prodhuesit, ka pak partneritete ndërsektoriale. Ofruesit e shërbimeve për përputhjen dhe zhvillimin e produkteve janë gjithashtu të kufizuar dhe kompanitë tregojnë gatishmëri të kufizuar për të paguar për angazhimin e tyre, duke kontribuar në dëmtimin e shfaqjes së një grupi më solid ofertuesish. Ofruesit e shërbimeve për qeverisjen e korporatës janë gjithashtu të kufizuar dhe mund të këshillojnë prodhuesit për ndryshimet e menaxhimit gjë që mund të ndikojë gjithashtu në proceset e prodhimit. Kjo lidhet gjithashtu me kuptimin e kufizuar të qeverisjes së korporatës nga bizneset, dhe gatishmërinë e kufizuar për të paguar për shërbime të tilla. Së fundi, laboratorët e kufizuar vendas për testimin e produktit mungojnë në një pjesë të madhe, duke rritur kostot për kompanitë që kërkojnë të eksportojnë.

Lidhja me objektivat e politikës: Forcimi i lidhjeve ndërmjet prodhuesve dhe ofruesve të shërbimeve vendase, minimizon rrjedhjen e vlerës në proceset e prodhimit, me ç'rast shërbimet

për prodhim do të importoheshin më pak nga jashtë (objektivi 5). Kjo krijon gjithashtu kërkesë të brendshme për këto shërbime, me efekte pozitive punësimi, profesionalizimi dhe rritjeje.

Kufizimet themelore: Kapacitetet e kufizuara të ofruesve për një mori shërbimesh të lidhura me prodhimtarinë po pengojnë konkurrencën e sektorit. Numri i kufizuar i teknikëve vendas për mirëmbajtjen e makinerive i ka lëshuar vendin angazhimit të ekspertëve rajonalë që janë të kushtueshëm. Optimizimi i procesit të prodhimit pengohet gjithashtu nga mungesa e specialistëve të prodhimit. Megjithatë sektori i TIK-ut po zhvillon zgjidhje dixhitale, ka partneritete të kufizuara me kompanitë prodhuese për dixhitalizimin. Mungesa e laboratorëve vendor për kontrollet dhe certifikimet e cilësisë së produktit gjithashtu rrit kostot dhe minon inovacionin vendas. Mungesa e shërbimeve të përputhura të cilat synojnë tregjet e eksportit, duke përfshirë ndihmën e biznesit për t'u sofistikuar përbrenda, që përfshin qeverisjen e korporatës, gjithashtu ndikon në konkurrencën e prodhimit.

Veprimet e politikave: Veprimet kryesore synojnë të përmirësojnë disponueshmërinë e shërbimeve vendore për prodhuesit vendas, të fokusuara por pa u kufizuar në dixhitalizimin, mirëmbajtjen e makinerive, testimin e produktit dhe përputhjet e tregut të eksportit.

Treguesit: Arritja e nën-objektivit do të matet me treguesin e mëposhtëm: (i) *shërbimet e brendshme të blera nga industritë.*

5.2.7. Treguesit dhe objektivat/caqet për nën-objektivat

Për të matur progresin drejt arritjes së nën-objektivave të politikës nevojiten treguesit për të monitoruar rezultatin e Politikës Industriale. Treguesit, ndër të tjera, do të përfshihen në monitorimin vjetor të progresit. Tabela më poshtë jep gjithashtu vlerat bazë për të gjithë treguesit, si dhe vlerat e synuara për të gjithë nën-objektivat që duhet të arrihen deri në vitin 2030.

Por, disa nga treguesit nuk janë të paraqitura për shkak të mungesës së të dhënave statistikore. Lista e treguesve për të cilët mungojnë të dhënat është paraqitur në (shtojcën 5).

Tabela 2: Treguesit kryesorë të nivelit të nën-objektivit, duke përfshirë vlerat bazë dhe ato objektive

Objektivat	Nën-objektivat	Treguesit	Baza	Caqet 2026	Caqet 2030
I. Zgjerimi (shtrirja)e prodhimit industrial	1. Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor	Kreditë e brendshme nga bankat për sektorin privat (% e BPV-së)	47.8% (2020)	60.4%	66.2%
		Përqindja e prodhimit në totalin e kredive tregtare	17.3% (2021)	23.4%	28.2%
		Përqindja e IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve (%)	-0.1% (2021)	10.2%	18.4%

	2. Rritja e investimeve në prodhim	Përqindja e mallrave kapitale të importuara në VShP	41.7% (2020)	48.3%	52.7%
	3. Përsheptimi i transformimit dixhital në prodhim	Përdorimi i mjeteve të dixhitalizimit në proceset e përgjithshme të prodhimit/punës në prodhim (%)	19.3% (2019)	35%	45%
	4. Rritja e cilësisë dhe certifikimi i njohur ndërkombëtarisht i produkteve	Numri i produkteve industriale të eksportuara në BE (të paktën 10,000 EUR në vit)	296 (2021)	630	895
Objektivat	Nën-objektivat	Treguesit	Baza	Caqet 2026	Caqet 2030
II. Reduktimi i deficitit tregtar industrial	1. Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit	Numri i firmave prodhuese që eksportojnë rregullisht (të paktën 10,000 euro në vit)	733 (2021)	1,239	2,478
	2. Mbështetja e diversifikimit të tregjeve të eksportit	Diversiteti gjeografik i eksporteve (numri i vendeve që përbëjnë 80% të eksporteve të prodhimit)	10 (2021)	14	18
	3. Zëvendësimi i importit të produkteve të ndërmjetme dhe finale me prodhime vendor dhe promovimi i produkteve vendore	Pjesa e importeve të mallrave të ndërmjetme të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve	31.6% (2020)	27%	22%
		Pjesa e importeve të mallrave të konsumit të zëvendësueshme (sipas klasifikimit BEC) në totalin e importeve	23.2% (2020)	20%	16%
		Përqindja e mallrave vendase në tregun e prodhimit	30.2% (2020)	40%	50%
Objektivat	Nën-objektivat	Treguesit	Baza	Caqet 2026	Caqet 2030
III. Gjenerimi i punësimit më të mirë	1. Përmirësimi i kualifikimit dhe	Numri i institucioneve të akredituara të trajnimit në prodhim	11 (2021)	20	35

dhe gjithëpërfshirës	certifikimit të fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të kompanive	Numri i standardeve të miratuara të profesionit në prodhim	24 (2021)	40	60
		Përqindja e punëtorëve që marrin trajnim formal në prodhim (%)	26.4% (2019)	35%	42%
		Numri i certifikatave ISO	n/a	Mesatarja e PB	Mesatarja e PB
	2. Promovimi i krijimit të vendeve të denja të punës në industri	Punëtorët e prodhimit të deklaruar në ATK/punësim zyrtar në prodhimtari	75.6% (Avg. 2018-2020)	80%	87%
		Varfëria në punë në procesin e prodhimit	26.6% (2020)	15%	10%
		Numri i aksidenteve në punë në procesin e prodhimit	49 (2021)	0	0
	3. Integrimi i grave dhe të rinjve në tregun e punës dhe në biznes	Përqindja e të rinjve të punësuar në prodhim në punësimin total të të rinjve	10.2% (2021)	13.7%	16.5%
		Pjesa e grave në punësimin në prodhim	15.9% (2020)	20.7%	23.9%
Objektivat	Nën-objektivat	Treguesit	Baza	Caqet 2026	Caqet 2030
IV. Lehtësimi i industrisë së gjelbër	1. Mbështetja e ndërmarrjeve për të rritur riciklimin dhe qarkullimin në prodhim	Vlera e shtuar bruto në sektorët e lidhur me ekonominë qarkore (% e BPV-së totale)	0.8% (2020)	1.0%	1.3%
		Përdorimi i materialit të ricikluar (%)	n/a	Mesatarja e PB	Mesatarja e PB
	2. Mbështetja e prodhimit dhe konsumit të produkteve të gjelbra	Përqindja e tregut nga produktet miqësore për mjedisin	n/a	Mesatarja e PB	Mesatarja e PB
		Përqindja e qytetarëve që shpesh blejnë produkte miqësore për mjedisin	n/a	Mesatarja e PB	Mesatarja e PB
	3. Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve	Intensiteti i energjisë në prodhim (Toe/€M)	339 (Avg. 2018-2020)	250	150
Objektivat	Nën-objektivat	Treguesit	Baza	Caqet 2026	Caqet 2030
V. Maksimizimi i rritjes të	1. Rritja e përqindjes së inputeve	Vlera e importit të produkteve të ndërmjetme (klasifikimi BEC) si pjesë e VShP	169.1% (2020)	133.1%	109.1%

vlerës së brendshme	vendore në prodhim				
	2. Përmirësimi i inovacionit të produktit drejt produkteve me vlerë më të lartë të shtuar	Përqindja e firmave që kanë prezantuar një produkt/shërbim të ri	26.9% (2019)	32%	40%
	3. Forcimi i lidhjeve me ofruesit e shërbimeve vendore të industrisë	Shërbimet e brendshme të blera nga industritë	n/a	Mesatarja e PB	Mesatarja e PB

6. SEKTORËT ME PRIORITET

Që politika Industriale të jetë efektive, QK duhet të jetë selektive se ku t'i drejtojnë burimet e pamjaftueshme. Synimi i grupeve të veçanta dhe përshtatja e veprimeve të politikave është çelësi për arritjen e efekteve të dëshiruara. Kriteri më i rëndësishëm i përzgjedhjes është se cilin nën-sektor dëshiron të mbështesë një politikë me një masë të caktuar politike.

Është kryer një analizë gjithëpërfshirëse e nënsektorëve kryesorë brenda sektorit të prodhimit për të vlerësuar kontributin e mundshëm të nënsektorëve në arritjen e pesë objektivave kryesore të politikës industriale në Kosovë (për detaje të analizës shih (shtojcën 4). Për secilin objektiv të politikës, analiza dallon dy grupe industrish përkatëse: (i) ato industri që tashmë janë rritur dhe kontribuojnë ndjeshëm në objektivin dhe ende rriten pozitivisht (të quajtura "sektorë të pjekur"); dhe (ii) ato industri që janë ende të vogla ose të mesme, por rriten më shpejt se mesatarja (të ashtuquajturat "yje në rritje") dhe kanë potencialin për t'u bërë një sektor i ri i pjekur.

Bazuar në analizën e përgjithshme të nënsektorëve, nënsektorët ose industritë e mëposhtme të prodhimit vlerësohen si performuesit më të mirë, prej pesë objektivave të politikës industriale:

Prodhimi i gomës dhe plastikës konsiderohet një yll në rritje me një rritje të lartë në VShP (5.5%), me një pjesë të konsiderueshme të punësimit në sektorin e prodhimit (9% e sektorit të prodhimit, i referuar edhe si "Sektori C") dhe një rritje pozitive. shkalla e punësimit (5.8%), si dhe një kontribut pozitiv në bilancin tregtar (€800K+). Mungojnë të dhënat e ASK-së se si dhe nëse nënsektori ka përmirësuar efikasitetin e tij në konsumin e energjisë, edhe pse dëshmitë anekdotike sugjerojnë një gjë të tillë. Në përgjithësi, nënsektori ka potencial për t'u bërë shtytës i zhvillimit të prodhimit me efekte të vazhdueshme pozitive në punësim. Nënsektori ka gjithashtu një potencial të rëndësishëm për të rritur qarkullimin në industri, duke përfshirë

rritjen e potencialit të riciklimit. Në përgjithësi, qasja nga vendimmarrësit mund të jetë për përmirësimin e dinamizmit të nënsektorit nëpërmjet rritjes së specializimit të produktit.

Prodhimi i Mobiljeve konsiderohet gjithashtu një yll në rritje me një normë të lartë rritjeje në VShP (10%), me një efekt pak negativ në gjenerimin e punësimit (-0.4%), megjithëse punëson një fuqi të konsiderueshme punëtore (12% të punësimit total në Sektorin C), por ka efektin më pozitiv të rëndësishëm të çdo nënsektori të prodhimit në bilancin tregtar (12%), ndërsa nënsektori ka përmirësuar përdorimin e tij të konsumit të energjisë në vitet e fundit (norma e rritjes së konsumit të energjisë ka rënë me 3.8% nga 2015 – 2020). Në përgjithësi, nënsektori është një shtytës i zhvillimit të prodhimit dhe politika industriale duhet të synojë të mbajë rrugën e saj të rritjes. Nënsektori ka gjithashtu potencial të rëndësishëm për të rritur përfitimet e brendshme nga përdorimi i më shumë burimeve lokale, me thellimin e lidhjeve me tekstilin, produktet metalike dhe shërbimet që lidhen me industrinë.

Vlerësimi i performancës së nënsektorëve ofron gjithashtu njohuri *se cilët nënsektorë janë pozicionuar më mirë për të mbështetur arritjen e pesë objektivave të politikës industriale:*

- *Objektivi 1: Zgjerimi (shtrirja) e Prodhimit Industrial*

Sektorët e pjekur/maturuar si ushqimi, pijet dhe mineralet jometalike kanë përqindje të larta të VShP për kokë banori, gjë që tregon aftësitë e tyre industriale relativisht të konsoliduara, pavarësisht mundësive për shumë përmirësime. Si e tillë, mbështetja e industrive të tilla ndihmon Kosovën për të arritur objektivin 1 për zgjerimin e prodhimit industrial. Për më tepër, nënsektorët me yje në rritje si mobiljet dhe goma e plastika kanë ritme të larta rritjeje të VShP, duke treguar një potencial ende të pashfrytëzuar për rritje në të ardhmen, duke patur kështu një ndikim edhe më të madh në zgjerimin e prodhimit industrial.

- *Objektivi 2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial*

Sektorët, si ai i mobiljeve dhe ai i gomës/plastikës kanë aktualisht një ndikim pozitiv në bilancin tregtar, gjë që vendos përgjegjësinë mbi politikëbërësit që të vazhdojnë të mbështesin thellimin e një kontributi të tillë në të ardhmen. Megjithatë, pavarësisht nga kontributi negativ, dhe ndonjëherë i konsiderueshëm, kontributi negativ në bilancin tregtar i nënsektorëve si ushqimi, pijet, mineralet jometalike dhe metalet bazë dhe produktet metalike, të gjithë këta nënsektorë, me një mbështetje të synuar, mund të pozicionohen për të përmbysur trendin dhe të zgjerojnë/shtrijnë konkurrencën e eksporteve të Kosovës, të zëvendësojnë importet, duke mbështetur kështu zvogëlimin e deficitit tregtar industrial.

- *Objektivi 3: Gjenerimi i punësimit më të mirë dhe gjithëpërfshirës*

Sektorë të tillë si ai i pijeve, përpunimt të drurit, goma dhe plastika, mineralet jometalike dhe metalet bazë dhe produktet metalike janë burime të rëndësishme punësimi, duke pasur në disa raste rritje dinamike. Për më tepër, duke marrë parasysh rolin e tyre në sigurimin e mjeteve të

jetesës për gratë, nënsektorët e tekstilit, veshjeve dhe lëkurës janë gjithashtu një burim punësimi gjithëpërfshirës.

- *Objektivi 4: Lehtësimi i industrisë së gjelbër*

Të dhënat e ASK-së për shumë nënsektorë ofrojnë një pasqyrë e cila tregon se shumë nënsektorë janë duke përmirësuar efikasitetin e energjisë. Sektori i mobiljeve, ushqimit, pijeve kanë demonstruar reduktim të dukshëm në përdorimin e konsumit të energjisë në të njëjtën kohë kur ato kanë zgjeruar rritjen e tyre të VShP. Megjithatë, potenciali për qarkullim është jashtëzakonisht i pashfrytëzuar në të gjithë sektorin e prodhimit. Industria jo-minerale dhe e gomës/plastikës mendohet se ka biznese operative ku qarkullimi është në rritje, por përpjekje të tilla duhet të mbështeten dhe thellohen më tej, duke përfshirë edhe nënsektorët e tjerë.

- *Objektivi 5: Maksimizimi i rritjes së vlerës së brendshme*

Analiza e nënsektorëve tregon gjithashtu nivelin e konsiderueshëm të mos-shfrytëzimit të inputeve vendore, veçanërisht në nënsektorë si përpunimi i drurit dhe mobiljet, ushqimi dhe pijet, mineralet jometalike dhe metalet bazë. Politika Industriale duhet të mbështesë rritjen e pjesës së inputeve të brendshme në këta nënsektorë, duke eksploruar gjithashtu sinergjinë e politikave me sektorët e pylltarisë dhe minierave. Ekziston gjithashtu një potencial thelbësor për të eksploruar një integrim më të thellë brenda dhe përgjatë zinxhirëve të vlerës së brendshme, veçanërisht integrimin e tekstilit, veshjeve dhe lëkurës me nënsektorin e mobiljeve, si dhe integrimin më të mirë të metaleve bazë dhe produkteve metalike me sektorin më të gjerë të minierave.

7. VEPRIMET E POLITIKAVE PRIORITARE TË POLITIKËS INDUSTRIALE

Politika Industriale 2030 është një strategji zhvillimore gjithëpërfshirëse për sektorin e prodhimit të Kosovës. Ajo siguron orientim strategjik për veprimin e politikave dhe vendos arsyetimin për ndërhyrjet e QK-së në këtë sektor.

Politika Industriale 2030 përbëhet nga 5 objektiva politikash, 16 nën-objektiva dhe drejtime bazë për veprimet e politikave. Çdo Plan Veprimi i Politikës Industriale duhet të formulojë një sërë veprimesh dhe aktiviteteve politikash të qarta dhe konsistente se si do të arrihen këto (nën) objektiva.

Për të siguruar zbatimin e veprimeve kryesore të rëndësishme të politikave, QK ka përcaktuar 10 veprime prioritare që do të zbatohen me Planin e parë të Veprimit 2023 – 2025. Këto veprime prioritare të politikave janë përzgjedhur në bazë të rëndësisë së tyre strategjike për arritjen e objektivave të Politikës Industriale.

1) Veprimi prioritar 1: Mbështetja e krijimit të parqeve moderne industriale me karakteristika miqësore me mjedisin

QK do të mbështesë krijimin e katër parqeve të reja industriale në katër rajone të ndryshme të Kosovës me infrastrukturë dhe shërbime të tjera të nevojshme. Ndërsa tre parqe industriale do të udhëhiqen me funksione miqësore me mjedisin, njëri pritet të jetë plotësisht i gjelbër, me qasje në energji të ripërtrishme, objekte të menaxhimit të mbeturinave dhe të ngjashme - të gjitha të domosdoshme për prodhimin e produkteve neutrale ndaj karbonit. Një tipar tjetër dallues i këtyre parqeve do të jetë se ato do të specializohen në tërheqjen e investimeve në aktivitete që përkthehen në përfitime më të larta të brendshme. Ato do të kenë gjithashtu njësi të menaxhimit të brendshëm që do të administrojnë me to çdo ditë.

Kjo masë pritet të inkurajojë investimet e brendshme dhe të IHD-ve (Objektivi 1) dhe të krijojë efekte përcjellëse te furnitorët vendor (Objektivi 5).

2) Veprimi prioritar 2: Themelimi i një institucioni kombëtar për certifikimin e produkteve

Kjo skemë granti do të ndihmojë kompanitë prodhuese me potencial eksporti për të marrë certifikimin e produkteve të njohura ndërkombëtarisht. Qeveria do të mbulojë 60% të kostos me një shumë maksimale deri në 15 mijë euro, ndërsa kompania përfituese do të mbulojë 40%. Duke qenë se kostoja e certifikimit për produktet metalike është përgjithësisht më e lartë, shumata maksimale e parashikuar për atë kategori do të jetë deri në 50 mijë euro. Pëqindja e ndarjes së kostos do të jetë e njëjtë, 60%-40%. Kostot e pranueshme për certifikimin e produktit përfshijnë testimin, verifikimin, certifikimin dhe inspektimin. Granti do të jetë i hapur çdo vit dhe kompanitë përfituese do të kenë 12 muaj kohë për zbatim.

Kjo skemë do të ndihmojë kompanitë përfituese të sigurojnë cilësinë dhe sigurinë e duhur të produkteve (objektivi 1). Për më tepër, do t'i ndihmojë ata të jenë në përputhje me kërkesat e tregjeve të eksportit dhe të rrisin perspektivat e tyre të eksportit (objektivi 2).

3) Veprimi prioritar 3: Bashkëfinancimi me organet e vlerësimit të konformitetit

Ky është një instrument me dy komponentë që synon të ofrojë mbështetje financiare për organet e vlerësimit të konformitetit. Komponenti i parë do të jetë të ndihmojë laboratorët vendas të përmirësojnë pajisjet e tyre dhe të ndërtojnë kapacitete operationale. Qeveria do të mbulojë 50% të kostos me një shumë maksimale deri në 50 mijë euro. Komponenti i dytë do të jetë mbështetja e krijimit të organizmave të rinj certifikues me pajisje dhe kapacitete operationale për t'i bërë ato gati për akreditim ndërkombëtar. Qeveria do të mbulojë 70% të kostos me një shumë maksimale deri në 75 mijë euro. Ky instrument pritet të krijojë akses më të mirë për prodhuesit në raportet e testimit vendas dhe certifikatat e produkteve të njohura nga tregjet e eksportit me vlerë të lartë me çmime më të arsyeshme (objektivi 2).

4) Veprimi prioritar 4: Rritja e Lehtësisë Financiare të Eksportit nga Fondi Kosovar për Garanci të Kredive

Lehtësia Financiare i Eksportit është një dritare e re në kuadër të FKGGK-së që ofron garanci specifike kreditore për institucionet financiare për kreditë për kompanitë prodhuese të orientuara nga eksporti që përballen me vështirësi në përmbushjen e kërkesave për kolateral. Qeveria planifikon të plotësojë fondin fillestar të kësaj dritareje, e cila mund të zgjerojë si vëllimin e përgjithshëm të garancive të lëshuara ashtu edhe kufijtë e kredisë, të cilat nga ana e tyre mund të lehtësojnë investimet kapitale në shkallë më të madhe dhe zgjerimin e kapacitetit të furnizimit të prodhimit. Dritarja ka si synim ndërmarrjet me më pak se 250 punëtorë dhe të paktën një aksioner rezident; shuma maksimale e kredisë aktualisht është 3 milion euro, ndërsa kufiri aktual maksimal i garancisë është 500 mijë euro, por me mbështetjen e re të QK-së, të dy këto kufij mund të rriten. Ndërkohë, afati i maturimit të kredisë është deri në 120 muaj. Nga totali i shumës së qeverisë, 20% do të ndahet anash për të garantuar produkte të reja financiare të fokusuara në eksport (p.sh. faktoring) që pritet të zhvillohen nga institucionet financiare.

Kjo masë pritet të përmirësojë qasjen në financa për firmat prodhuese dhe të rrisë investimet në prodhim (objektivi 1), të përmirësojë kapacitetin për eksport (objektivi 2) dhe të përmirësojë adoptimin e teknologjisë së gjelbër (objektivi 4).

5) Veprimi prioritar 5: Përmirësimi i regjimit tarifor të importit

Regjimi tarifor do të përmirësohet për të prezantuar një nivel të nevojshëm mbrojtjeje për mallrat e përzgjedhura të prodhimit, veçanërisht në nën-sektorët si ushqimi dhe pijet. Përveç ndryshimit të tarifës ad-valorem (i vetmi lloj i tarifës në fuqi aktualisht), do të merren parasysh tarifat e tjera, si tarifat specifike, tarifat e përbëra dhe kuotat e tarifave. Ky regjim i ri nuk do të prekë mallrat e liberalizuara sipas MTL-ve aktuale. Vendet që ofrojnë trajtim preferencial të njëanshëm do të përjashtohen gjithashtu. Përpara se të ndodhë ndryshimi i regjimit, do të bëhet një analizë e thellë për të identifikuar mallrat e prodhimit të varura shumë nga furnitorët e huaj, por me potencial zëvendësimi.

Kjo masë pritet të zvogëlojë varësinë e madhe nga furnizuesit e huaj të mallrave prodhuese (objektivi 5) dhe të lejojë prodhuesit vendor të rriten (objektivi 1) dhe të konkurrojnë në baza të barabarta (objektivi 2).

6) Veprimi prioritar 6: Nisja e një Programi të Punës në Prodhim

Ky program do të hartohet nën kuadër të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP). Ai do të përfshijë dy veprime kryesore: praktikën në vendin e punës dhe subvencionimin e pagave. Veprimi i parë ka për synim të diplomuarit e papunë nga institucionet e arsimit të lartë, QAP dhe institucione të tjera të aftësimit profesional të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Kohëzgjatja e praktikës për çdo praktikant do të jetë gjashtë muaj, dhe kompensimi do të jetë i barabartë me pagën minimale. Veprimi i dytë synon gjithashtu të papunët. Kontrata për çdo përfitues do të jetë së paku 12 muaj. Subvencioni do të mbulojë 50% të pagës. Në të dyja rastet, punëdhënësi duhet të jetë një kompani prodhuese.

Veprimi pritet të rrisë mundësitë e punësimit në prodhimtari për të papunët, veçanërisht në mesin e grave dhe të rinjve (objektivi 3).

7) Veprimi prioritar 7: Prezantimi i një skeme kreditimi për aftësim

Skema do të jetë e hapur për individët nga 18 deri në 35 vjeç të interesuar për t'u pajisur me aftësi dhe njohuri të rëndësishme për industrinë. Përmes portalit të QK-së e-Kosova, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për një kupon që mbulon deri në 50% (në maksimum deri 500 euro) të tarifës së regjistrimit në një program trajnimi industrial kualitativ jo-publik të akredituar, sipas zgjedhjes së kandidatit. Kuponi do të vërtetohet pasi përfituesit të kenë përfunduar programin dhe të dorëzojnë certifikatën e fituar. Përparësi do të kenë aplikantët femra.

Kjo masë pritet të krijojë kapital njerëzor të rëndësishëm për industrinë i cili do të kontribuojë në mundësitë e punësimit me vlerë të shtuar (objektivi 3) dhe rritjen e konkurrencës industriale (objektivat 1 dhe 3). Trajtimi preferencial për gratë do t'i ndihmojë ato të integrohen në tregun e punës në prodhim.

8) Veprimi prioritar 8: Avancimi i programit të BERZH-it për të mbështetur investime të mëtejshme në teknologjinë e gjelbër

Përmes bankave komerciale, BERZH në Kosovë aktualisht lëshon kredi deri në 1 milion euro për kompanitë që kërkojnë të investojnë në teknologjitë e gjelbra me performancë më të mirë dhe të përmirësojnë standardet dhe proceset e tyre të punës. Kompanitë përfituese përfitojnë gjithashtu nga stimuj granti me vlerë deri në 15% të shumës së kredisë për t'i bërë investimet e tyre më të përballueshme. Disa donatorë mbështesin komponentin e grantit të instrumentit financiar. Me këtë masë, QK do të rrisë pjesën e grantit të programit dhe do të synojë kompanitë prodhuese me 50 punonjës ose më shumë.

Kjo masë pritet të mbështesë më tej kompanitë prodhuese në përmirësimin e teknologjisë së tyre (të gjelbër) (objektivat 1 dhe 3). Investimi në teknologji pritet të ndihmojë kompanitë të përmirësojnë produktivitetin, të rrisin prodhimin dhe të prezantojnë produkte të reja cilësore (objektivat 1 dhe 2).

9) Veprimi prioritar 9: Përmirësimi i prokurimit për të krijuar avantazhe për kompanitë prodhuese vendore dhe për të mbështetur Tranzicionin e Gjelbër

Ligji i prokurimit do të ndryshohet për të prezantuar një preferencë kalimtare çmimi deri në 15% për produktet e prodhimit vendas dhe do ta eliminojë gradualisht atë brenda një periudhe shtatëvjeçare. Preferenca nuk do të zbatohet për vendet e BE, CEFTA, SHBA dhe EFTA. Ligji i prokurimit do të ndryshohet gjithashtu për të inkuorporuar kriteret përkatëse të Prokurimit Publik të Gjelbër të BE-së (PPGj) për kategoritë e mëposhtme të kontratave publike: ushqime, tekstile dhe mobilje.

Kjo masë pritet të ndihmojë kompanitë vendore që të rriten dhe të arrijnë ekonomitë e shkallës (objektivi 1) dhe të jenë më konkurruese kundrejt importuesve (objektivi 2). Nga ana tjetër, prokurimi i gjelbër pritet të krijojë stimuj realë për zhvillimin e teknologjive dhe produkteve të gjelbra (objektivi 4).

10) Veprimi prioritar 10: Ofrimi i stimujve tatimorë për investime në inovacionin e produktit

Së pari, do të zhvillohet një regjistër i subjekteve të inovacionit të produkteve. Për t'u kualifikuar për këtë regjistër, njësia ekonomike duhet të jetë një start-up me jo më shumë se pesë vjet operim, të ketë të paktën një projekt inovativ produkti për prodhim me vlerë të paktën 25 mijë euro, të ketë dëshmi të kostove Kërkim dhe Zhvillim dhe të ketë të paktën një punonjës që merret me inovacionin. Kompanitë prodhuese me të paktën 100 punonjës do të marrin stimuj në formën e uljes së taksës së korporatës nëse investojnë në një nga subjektet e inovacionit të produktit. Shuma totale kumulative e reduktimit të taksave të korporatave nuk mund të kalojë 300 mijë euro.

Kjo masë pritet të inkurajojë inovacionin drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar dhe të kontribuojë në shkallëzimin e këtyre produkteve (objektivi 5).

8. MARRËVESHJET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e Politikës Industriale i takon Ministrisë përgjegjëse për Industrinë. Varësisht nga objektivat dhe aktivitetet, do të përfshihen ministrinë e linjës, agjencitë dhe institucionet tjera relevante në Kosovë. Ministri përgjegjës për Industrinë do të krijojë Komitetin Zbatues për Strategjinë e PI për të siguruar një bashkërendim të shëndoshë dhe efektiv ndërmjet institucioneve. Ky Komitet do të përbëhet nga institucionet që kanë marrë pjesë në grupin punues të strategjisë. Ministria përgjegjëse për Industrinë, si institucioni udhëheqës, do të organizojë funksionimin e Komitetit, do të përcaktojë planin e tij të punës dhe do të thërrasë mbledhjet e Komitetit. Ai gjithashtu mund të krijojë nëngrupe për detyra specifike.

Ministria përgjegjëse për Industrinë ka për detyrë të përgatisë një Raport të Progresit çdo vit. Ky raport synon të monitorojë arritjet vjetore të aktiviteteve të ndryshme dhe performancën në kohë reale të objektivave. Raporti vjetor me arritjet kryesore do të bëhet publike.

Strategjia e PI do t'i nënshtrohet një vlerësimi të ndërmjetëm në vitin 2026 për të vlerësuar progresin kundrejt objektivave afatmesme dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e objektivave strategjike dhe specifike. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet në vitin 2030. Të dy vlerësimet do të jenë të pavarura dhe Ministria përgjegjëse për Industrinë do të kërkojë mbështetje të jashtme.

9. NDIKIMI BUXHETOR

Në këtë pjesë paraqiten të dhënat që kanë të bëjnë me zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Bizneseve për periudhën e mbuluar nga Plani i Veprimit 2023-2025. Rishikimi i ndërmjetëm i SZHIMB 2030 duhet të përfshijë koston e veprimeve për periudhën në fjalë.

9.1. Vlerësimi i Përgjithshëm

Vlerësimi i ndikimit buxhetor (VNB) i strategjisë bazohet në përlogaritjen e koston së zbatimit të Planit të Veprimit 2023-2025 të SZHIMB 2030. Qajsa e VNB-së është përdorur për të siguruar lidhje të ngushtë ndërmjet planifikimit të nevojave dhe projeksionit të resurseve për planifikim afatmesëm të buxhetit. Për kostimin e strategjisë është përdorur qasja «poshtë-lartë» dhe produktet e definuara në plan të veprimit kanë pasur rëndësi të veçantë për të përlogaritur koston e zbatimit.

Objektivat Strategjike të SZHIMB	Kostoja e përafërt 2023-2025 (në euro)
OS1: zgjerimi i Prodhimit në Industri	26,571,495
OS2: Reduktimi i deficitit tregtar industrial	16,031,854
OS3: Gjenerimi i punësimit të mirë dhe gjithpërfshirës	12,508,500
OS4: Lehtësimi i industrisë qarkore dhe të gjelbër	13,082,000
OS5: Maksimizimi i përfitimit të brendshëm	927,000
Gjithsej	69,102,849

Tabela më lartë tregon se Zgjerimi i Prodhimit në Industri është objektiva strategjike me koston më të lartë, 38.33% të koston totale, që pason nga objektivi strategjik «Reduktimi i deficitit tregtar industria» me 23.06%. Objektivat strategjik janë të zbërthyer në 15 (nën)objektiva specifik, ndërsa ata me koston më të lartë janë si në vijim:

- Objektivi Specifik 1.2: Ritja e investimeve në prodhim që përmbanë dy projekte kapitale me kosto totale të vlerësuar në rreth 17 milion, ku njëri ka të bëjë me finalizimin e parqeve, ndërsa tjetri me ndërtimin e parkut industrial të gjelbër me gjithsej 25.45% të totalit të koston së përlogaritur të strategjisë.
- Objektivi Specifik 2.1: Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre të eksportit i cili përmban veprimin për të kontribuar rreth 10 mil. euro në Fondin e Garancisë Kreditore të Kosovës me synim për të mbështetur rreth 300 kompani duke iu mundësuar qasje në produkte financiare për eksportim, si dhe veprimet tjera mbështetëse për promovimin e eksportit të produkteve me rreth 5.41 mil. euro apo gjithsej 22.16% të totalit të koston së përlogaritur të strategjisë për periudhën 2023-2025.

- **Objektivi Specifik 4.3:** Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe materialeve ku parashihet financim prej 10 mil. euro për mbështetjen programit për investime në teknologji të gjelbër, ku parashihet të përfitojnë së paku 80 kompani.

Sa i përket ndikimit buxhetor në aspektin kategorive ekonomike, zbatimi i strategjisë përfshinë resurse të natyrës njerëzore nga lista e pagave, trajnime, mbledhje pune dhe konferenca kur përfshihen panairët, ekspertizë profesionale nga kompanitë vendase, furnizime dhe pajisje, si dhe asistencë teknike dhe grantet e huaja. Gjithashtu, për arritjen e objektivave strategjike është paraparë edhe mbështetja financiare përmes subvencionimit dhe shpenzimet kapitale që janë konsumuesit më të lartë të resurseve financiare. Në vijim është tabela që përmbanë kostot për secilën objektivë specifike sipas klasifikimit ekonomik.


Objektivi Specifik	Paga	Trajnime / Konferenca	Shërbime profesionale	Furnizime dhe pajisje	Grante dhe asistencë teknike	Mbështetje finan. / subvencion	Shpenz. Kapitale	Gjithsej
Lehtësimi i qasjes në financa për prodhuesit vendor	57,600	-	100,000	6,400	-	-	-	164,000
Rritja e Investimeve në Prodhim	-	-	60,000	30,000	25,000	-	18,961,895	19,076,895
Përsheptimi i transformimit digital në prodhim	-		-	-	-	4,080,000	-	4,080,000
Rritja e cilësisë dhe certifikimi me njohje ndërkombëtare të produkteve		12,600			58,000	3,180,000	-	3,250,600
Mbështetja e ndërmarrjeve për të shfrytëzuar potencialin e tyre	69,854	6,000	294,000	90,000	54,000	14,900,000	-	15,413,854
Diversifikimi i tregut të eksportit	-	-	-	-	30,000	300,000	-	330,000
Reduktimi i importeve përmes zëvendësimit të produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare me produkte vendore	-	-	224,000	-	44,000	20,000	-	288,000
Kualifikimi dhe certifikimi i fuqisë punëtore teknike dhe menaxherëve të ndërmarrjeve	-	-	150,000	-	455,500	11,510,000	-	12,115,500
Promovimi i krijimit të vendeve të punës të denja në industri	-	-	-	-	-	-	-	-
Integrimi i grave dhe të rinjëve në tregun e punës dhe biznes	-	75,000	-	-	300,000		-	375,000
Mbështetja e ndërmarrjeve për rritjen e riklimit dhe qarkullimit në prodhim	-	32,000	-	-	50,000	3,000,000	-	3,082,000
Prodhimi dhe konsumi i produkteve të gjelbra	-	-	-	-	-	-	-	-
Mbështetja e përmirësimit teknologjik me fokus në rritje efikasitetit të energjisë dhe materialeve	-	-	-	-	-	10,000,000	-	10,000,000
Rritja e pjesëmarrjes së inputeve vendore në prodhim	-	-	100,000	-	-	-	-	100,000
Inovacioni drejt produkteve me vlerë më të lartë të shtuar	-	-	-	30,000	157,000	-	-	187,000
Forcimi i lidhjeve me ofruesit vendor të shërbimeve që lidhen me industrinë	180,000	-		-	.	460,000	-	640,000
Gjithsej	307,454	125,600	928,000	156,400	1,173,500	47,450,000	18,961,895	69,102,849

9.2. Burimet e financimit

Kostoja e vlerësuar e strategjisë është përlogaritur për një periudhë afatmesme 2022-2024, mirëpo nevojat për financim mund të kalojnë këtë periudhë. Kjo duke pasur parasysh trendin e zbatimit të projekteve kapitale të cilat përbëjnë rreth 27.27% të totalit të kostonë së kësaj strategjie. Ndërsa pjesa tjetër e veprimeve që kanë kosto të natyrës tjetër nuk paraqet rreziqe të përmasave të tilla si kategoria e shpenzimeve kapitale.

Duke pasur parasysh kornizën aktuale buxhetore 2023- 2025, nevoja financiare për periudhën 2023 – 2025 sipas viteve është si në vijim:

Figura 1: Nevoja financiare



Strukturat përkatëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet organizatave buxhetore, programeve dhe linjave buxhetore përkatëse në kuadër të procesit të planifikimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe buxhetit vjetor.

Figura 2: Burimet e Financimit




Figura më lartë paraqet burimet e planifikuara të financimit të Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Bizneseve 2030. Sipas kësaj, në periudhën 2023-2025, 122 mil. euro janë në kuadër të buxhetit aktual, ndërsa 10 mil. euro parashihet të financohen përmes kredisë, ndërsa 4.23 mil. euro pritet financohen nga donatorët. Në bazë të kësaj, boshllëku financiar për këtë periudhë është rreth 42.68 mil. euro ose 62% e totalit të kostos së SZHIMB 2030 për periudhën 2023-2025.

10. SHTOJCAT


Shtojca 1

Kjo shtojcë ofron një analizë të problemit mbi performancën e sektorit prodhues të Kosovës gjatë 10 viteve të fundit në tri dimensione kryesore, në dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor, që nga ana tjetër ofron udhëzime të rëndësishme se si të orientohet strategjikisht politika industriale e Kosovës.

Përpunimi dhe analiza e këtyre grafeve është bërë sipas metodës EQuIP, duke krahasuar Kosovën me vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe Estoninë dhe Slloveninë si shtete model. Kalkulimi i indikatorve në grafet e paraqitura janë: BPV-Bruto Produkti Vendor, bilanci tregtar, punësimi, pagat dhe shfrytëzimi i energjise elektrike, me vendet krahasuese nga disa këndvështrime.

Dimensioni ekonomik

Figura 1, BPV, për kokë banori kundrejt vendeve krahasuese, 2011-2020




Kosova ka nivelin më të ulët të BPV për kokë banori, krahasuar me 6 vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) me 3,500 euro në vitin 2020, që është 1,100 euro, më e ulët se mesatarja e BP6.

Hendeku nuk është mbyllur, pasi Kosova ka shënuar rritje të normës vjetore në terma të BPV/për kokë banori pak më të shpejt për (5%), krahasuar me BP6 që kjo normë është për (4%).

Burimi: WDI (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)


Figura 2: Struktura ekonomike në Kosovë, e matur me Vlerën e Shtuar sipas sektorëve



Burimi: WDI (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Pjesa e Vlerës së Shtuar të Prodhimit (VShP), si pjesë e BPV, mbeti e qëndrueshme në 13%; Sektori i shërbimeve u rrit në mënyrë graduale gjatë kësaj periudhe dhe ende përbën pjesën më të madhe të BPV në vitin 2020 (48%). Pesha e vlerës së shtuar në Industri, duke mos llogaritur ndërtimtarinë përbënte mesatarisht 14% të BPV gjatë së njëjtës periudhë.


Figura 3: Vlera e Shtuar në % e BPV, në Kosovë dhe vendet krahasuese.



Burimi: WITS, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Në vitin 2020, niveli i industrializimit të Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VShP në BPV ishte (13.6%), derisa mesatarja e BP6 prej (10.7%), me përjashtim të Serbisë për (14.2%). Megjithatë, me të njëjtin tregues dhe për të njëjtin vit, Kosova kishte performancë të konsiderueshëm më të ulët në krahasim me Slloveninë (22%), por ishte pak më e lartë se Estonia prej (13.2%).

Figura 4: Vlera e Shtuar e Prodhimit për kokë banori në BPV, Kosova krahasuar me vendet tjera




Kapaciteti prodhues i Kosovës (338/euro në 2020) ishte nën mesataren e BP6 (365/euro, në kokë banori).

Vetëm Shqipëria dhe Mali i Zi kanë kapacitet më të ulët se Kosova. Sllovenia, si vend model në krahasim me Kosovën, ka kapacitet prodhues afërsisht 10 herë më të lartë sesa Kosova.

Burimi: WITS, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 5: Pjesëmarrja e kapitalit fiks bruto si % në BPV



Kosova arrin shifër të lartë të pjesëmarrjes së kapitalit fiks bruto në BPV prej 30%, në vitin 2020, krahasuar me 24% të mesatares rajonale të BP6 në vitin 2020.

Burimi: WDI, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)


Tabela 1: Produktiviteti i punës

Vendet	BPV për punëtor, 2015	BPV për punëtor, 2020	VSHP për punëtor, 2015	VSHP për punëtor, 2020
SHQ	8,943	7,760	7,911	7,159
BH	14,077	12,292	13,573	12,964
MZ	15,553	14,409	13,303	11,553
MV	11,651	10,589	8,756	8,141
SER	11,001	9,860	14,214	11,240
SLV	41,757	37,393	43,199	45,759
KOS	16,379	13,399	23,949	22,721
EST	29,309	26,857	26,628	28,842
BP6	11,621	10,308	12,875	10,990

Produktiviteti i punës në sektorin e prodhimit të Kosovës ka shënuar rënie, por sipas të dhënave shifet se është dukshëm më mirë se sa vendet krahasuese rajonale, në terma relative.

Burimi: WDI, UNIDO, ASK, (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 6: Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV), 2011-2020




Kosova vazhdon të ketë deficit të lartë tregtar: raporti mes eksportit dhe importit është (1.6 : 8.4).

Kosova ka nivelin më të ulët të eksporteve në raport me BP6.

Pjesa më e madhe e eksporteve janë nga prodhimtaria.

Burimi: WDI (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 7: Pjesëmarrja e eksporteve totale në % të BPV




Sipas të dhënave të vitit 2020, tregjet më të synuara për produktet e Kosovës kanë qenë kryesisht në BP6 dhe vendet e BE-së.

Sipas këtyre të dhënave, tregu i Kosovës është kryesisht i diversifikuar në afërsisht 10 vende, që konsiderohen tregje të mëdha.

Burimi: ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 8: Bilanci tregtar i Kosovës në Euro



Bilanci tregtar paraqet raportin ndërmjet importeve për periudhë njëvjeçare. Kosova, në vitin 2020, shprehur në vlera financiare, eksportoi 474 milionë euro, dhe 3.3 miliardë euro import. Të dhënat kryesore janë evidente se Kosova nga viti 2011-2020 asnjëherë nuk ka pasur bilanc tregtar pozitiv, ndërkaq niveli i rritjes së eksporteve ndaj importeve ka treguar rritje të lehtë, prej 14.4% të mbulimit të importeve me eksporte nga viti 2020, në 16.1% në vitin 2021.

Burimi: Vjetari Statistikor i Kosovës 2021 (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Dimensioni Social

Tabela 2: Elasticiteti i punësimit krhasuar me vendet tjera

Vendet	Norma vjetore e rritjes së punësimit	Norma vjetore e rritjes së VSHP	EE	Klasifikimi
Shqipëria	4.7%	3.7%	1.29	Drejtuar nga punësimiti
Bosnja dhe Hercegovina	2.0%	1.7%	1.18	Drejtuar nga punësimiti
Mali i Zi	2.4%	0.6%	3.84	Drejtuar nga punësimiti
Maqedonia e Veriut	0.9%	-0.5%	(2.04)	Drejtuar nga rritja e pa punësisë
Serbia	4.9%	1.5%	3.25	Drejtuar nga punësimiti
Kosova	2.8%	2.5%	1.11	Drejtuar nga punësimiti
BP6	3.7%	1.5%	2.39	Drejtuar nga punësimiti
Estonia	-0.4%	1.5%	(0.30)	Drejtuar nga rritja e pa punësisë
Sllovenia	2.0%	3.6%	0.55	Drejtuar nga Produktiviteti


Modeli i rritjes së sektorit të prodhimit i drejtuar nga punësimiti.

Krijimi indirekt i vendeve të punës nuk merret parasysh këtu.

Analiza tregon se ndërmjet viteve 2015-2020, sektori i prodhimit të Kosovës u rrit çdo vit me një normë të përbërë prej 2.5%, ndërsa punësimiti në industri u rrit me 2.8%, gjatë të njëjtës periudhë.

Burimi: WDI, UNIDO, ILO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 9: Elasticiteti i punësimit



Burimi: WDI, UNIDO, ILO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)


Tabela 3: Pagat

Vendet	Norma e rritjes së pagave	Norma e rritjes së produktivitetit
Shqipëria	10.10%	-1.01%
Bosnja dhe Hercegovina	3.81%	-0.30%
Estonia	3.96%	-1.74%
Mali i Zi	5.17%	-1.38%
Maqedonia e Veriut	9.54%	-3.26%
Serbia	11.10%	-0.28%
Sllovenia	5.21%	-0.15%
Kosova	5.65%	1.57%

Rritja e produktivitetit të punës përkthehet pozitivisht në rritje të pagave në prodhim. Derisa produktiviteti u rrit në vitin krahasues me 1.6%, pagat u rritën me 5.6%, po në atë vit.

Burimi: WDI, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)


Figura 10: Intensiteti relativ i pagave në industrializim



Intensiteti relativ i pagave është rritur nga 21% në 2015, në 35% në vitin 2020. Fatura totale e pagave të prodhimit u rrit me më shumë se 10%, gjatë periudhës së analizës.

Burimi: WDI, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 11: Punësimi gjithëpërfshirës (sipas gjinisë)




Burimi: ILO, ASK (përpunuar nga DI/DPI-së)

Deri tani pjesëmarrja e punësimit të grave sipas të dhënave për vitet 2015-2020, është tejet e ulët sidomos në sektorin e prodhimit, me 16% në vitin 2020. Trendi i ngadalshëm i punësimit të grave është përcjell vazhdimisht në vend, krahasuar me BP6.

Dimensioni mjedisor


Figura 12: Eficienca e energjisë në sektorin e prodhimit



Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Në krahasim me BP6, Kosova gjeneroi vlerë më të lartë ekonomike prej (2.1 milion euro) në prodhim për njësi të KTOE (kilo ton për njësi ekuivalente të naftës), përjashtuar vetëm Serbinë, që gjeneroi më shumë për (2.3 milion euro në ktoe).


Figura 13: Emetimet e CO₂, për 1 milion euro në Vlerën e Shtuar të Prodhimit



Emetimet e CO₂ të Kosovës në sektorin e prodhimit janë nga më të ulëtat në krahasim me BP6, për (1.1 milion ktoe për 1 milion EUR në VSHP), përjashtuar Slloveninë, që ka emetim më të ulët (0.6 milion ton në 1 milion euro në VSHP).

Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 14: Intensiteti i energjisë



Intensiteti energjetik në Kosovë (sasia e energjisë së përdorur për të prodhuar një njësi të BPV), është përmirësuar ndjeshëm me kalimin e kohës. Por mbetet shumë nën mesataren e vendeve të BE-së

Burimi: International Energy Agency (IEA)

Shtojca 2


Kjo shtojcë ofron një analizë të problemit mbi performancën e nën sektorëve prodhues të Kosovës në tri dimensione kryesore, dimensionit ekonomik, social dhe mjedisor të sektorit të prodhimit të Kosovës gjatë 10 viteve të fundit, e cila ndihmon në identifikimin e nën sektorëve prodhues që kanë potencialin më të lartë për zhvillim ekonomik.

Përpunimi dhe analiza e këtyre grafeve është bërë sipas metodës EQuIP, duke krahasuar Kosovën me vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe Estoninë dhe Slloveninë si shtete modele. Kalkulimi i indikatorëve në grafet e paraqitura janë: vlera e shtuar e prodhimit, bilanci tregtar, punësimi, pagat dhe konsumi i energjisë me vendet krahasuse nga disa këndvështrime.

Bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të nën sektorëve, për të vlerësuar kontributin e mundshëm të tyre në arritjen e pesë objektivave të politikës industriale, sipas grafeve, janë paraqitur nën sektorët e prodhimit të cilët vlerësohen si përformuesit më të mirë: Prodhimi i Produkteve Ushqimore, Prodhimi i Pijeve, Prodhimi i Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, Prodhimi i Drurit dhe Mobileve, Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe Plastikes, Prodhimi i Produkteve Minerale jo Metalike, Prodhimi i Metaleve dhe Prodhimi i Produkteve të Fabrikuar Metalike.


Dimensioni Ekonomik






Figura 1: Vlera e Shtuar e Prodhimit (VSHP) / për kokë banori



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës – ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)





Figura 2-13: VSHP/për kokë banori, sipas nënsektorëve me vendet krahasuese









Burimi: UNIDO (INDSTAT 4 2022, ISIC Revision 4 (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së


Figurat 14-22: Punësimi sipas nënsektorëve, krahasimi me BP6, Estonia, dhe Sllovenia, për kokë banori






Burimi: UNIDO, Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 23: Vlera e shtuar e prodhimit (VSHP)/për kokë banori, shprehur sipas normës vjetore të rritjes (NVRR)




Burimi: UNIDO (INDSTAT 4 2022, ISIC Revision 4)

Figura 24: Bilanci tregtar i Kosovës, sipas nënsektorëve




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 25: Norma vjetore e rritjes (NVR) së vlerës së shtuar të prodhimit (VSHP) në raport me bilancin tregtar




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 26: Vlera e Shtuar e Prodhimit (VSHP) në raport me normën e rritjes vjetore, sipas nënsektorëve




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 27: Vlera e shtuar e prodhimit (VPSH), në raport me punësimin, sipas nënsektorëve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)


Figura 28: Kontributi i nënsektoreve në bilancin tregtar të Kosovës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)


Dimensioni Social

Figura 29: Elasticiteti i punësimit për nënsektorë




Burimi: WDI ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 30: Pagat për nënsektorë – mesatarja e pagës/punëtor dhe norma e rritjes vjetore (NVRR)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Figura 31: Fatura e pagave në raport me vlerën e shtuar, shprehur në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

